



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 5 shtator 2023
Nr. ref.: AGJ 2250/23

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO134/21

Parashtrues

Ramush Haradinaj dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-036 të 8 korrikut 2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ramush Haradinaj, Time Kadriaj, Bekë Berisha, Albana Bytyqi, Pal Lekaj, Shemsedin Dreshaj, Besnik Tahiri, Fadil Nura, Mergim Lushtaku, dhe Florentë Zejnullahu (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi). Parashtruesit e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), i përfaqëson deputeti Besnik Tahiri.

Akti i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Vendimin [nr. 08-V-036] e 8 korrikut 2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Akti i kontestuar), për shkarkimin e tetë (8) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Bordi i RTK-së).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është nxjerrë në kundërshtim me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] 54 [Mbroyta Gjyqësore e të Drejtave] dhe paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesit e kërkesës, në lidhje me këtë kërkesë kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e zbatimit të Aktit të kontestuar, deri në vendosjen përfundimtare të kërkesës.

Bazë juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës së Gjykatës nr. 01/2018. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatë

7. Më 16 korrik 2021, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
8. Më 26 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, caktoi gjyqtarin Radomir Laban, gjyqtar raportues për rastin KO134/21 dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 29 korrik 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KO134/21 dhe nga përfaqësuesi i tyre kërkoi dokumentacion shtesë. Po të njëjtën datë u njoftuan: (i) Presidentja e Republikës së Kosovës; (ii) Kryetari i Kuvendit, të cilit iu kërkua që nga një kopje të kërkesës t'ju dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; (iii)

Kryeministri i Republikës së Kosovës; (iv) Avokati i Popullit; (v) Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, nga i cili u kërkuar dosja e lëndës, si dhe (vi) RTK-ja. Po të njëjtën datë, palët e interesuara u njoftuan se komentet e tyre përkitazi me kërkesën mund t'i dorëzonin në Gjykatë, jo më vonë se më 12 gusht 2021.

10. Më 29 korrik 2021, Besnik Tahiri, në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të parashtruesve të kërkesës, dorëzoi në Gjykatë një kopje të Aktit të kontestuar dhe Ligjin nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për RTK-në).
11. Më 4 gusht 2021, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dorëzoi në Gjykatë dokumentacionin relevant lidhur me ecurinë e procedurës deri në miratimin e Aktit të kontestuar.
12. Më 5 gusht 2021, RTK dorëzoi në Gjykatë komente përkitazi me kërkesën KO134/21.
13. Më 12 gusht 2021, Doarsa Kica-Xhelili, në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejshëm: LVV), dorëzoi në Gjykatë komente lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës.
14. Më 1 shtator 2021, gjyqtarja Remzije Istrefi-Peci kërkoj nga Kryetarja e Gjykatës përjashtimin e saj nga vendimmarrja.
15. Më 8 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës, nëpërmjet Vendimit [KK226/21], miratoi kërkesën e gjyqtarës Remzije Istrefi-Peci, duke konstatuar se janë përmbushur kushtet e përcaktuara përmes nënparagrafit 2, paragrafi 1, të nenit 18 (Përjashtimi i gjyqtarit) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 10 (Detyrat e Kryetarit/es) të Rregullores së punës nr. 01/2018, për të miratuar kërkesën e gjyqtarës Remzije Istrefi-Peci. Si rrjedhojë dhe në përputhje me paragrafin 2 të nenit 19 (Marrja e vendimeve) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Gjykata mbeti pa kuorum vendimmarrjeje.
16. Nga 8 shtatori 2021, Gjykata mbeti pa kuorum për të shqyrtuar dhe vendosur për kërkesën. Përkitazi me mungesën e kuorumit, Gjykata njoftoi të gjitha palët e interesuara. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë. Me këtë rast, u formua kuorumi vendimmarrës prej shtatë (7) gjyqtarësh në përputhje me paragrafin 2 të nenit 19 (Marrja e vendimeve) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
17. Më 17 maj 2023, Gjykata, për rastin në fjalë, i është drejtuar shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, me pyetjet, si në vijim:
 - 1) *Si menaxhohet transmetuesi publik dhe cili është roli i Parlamentit lidhur me mbikëqyrjen dhe menaxhimin e transmetuesit publik në vendin tuaj?*
 - 2) *Nëse transmetuesi publik menaxhohet nga një Bord apo organ i ngjashëm kolektiv:*
 - a. *kush i zgjedh dhe kujt i raportojnë anëtarët e Bordit apo organit kolektiv?*
 - b. *kush ka të drejtë të shkarkojë anëtarët e Bordit, cila është baza juridike dhe shkaqet që mund të përbëjnë arsye për shkarkim?*
 - c. *a mund të shkarkohen të gjithë anëtarët e Bordit për të njëjtat arsye apo vetëm bazuar në përgjegjësinë e tyre individuale?*
 - 3) *Sipas legjislacionit të vendit tuaj, a është e mundur që, paaftësia profesionale si dhe/ose mos aprovimi i raportit vjetor i transmetuesit publik, të përbëjë bazë për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit apo organit menaxhues të transmetuesit publik?*
 - 4) *Cilat janë garancitë juridike përkatëse në vendin tuaj lidhur me pavarësinë e transmetuesit publik dhe anëtarët e bordeve përkatëse menaxhuese? dhe*

5) Gjithashtu, a ka gjykata juaj, praktikë relevante gjyqësore sa i përket çështjeve të lartcekura?

18. Në mes datave 23 maj dhe 26 qershor 2023, Gjkata ka pranuar përgjigje nga Gjykatat Kushtetuese dhe/ose ekuivalentet e tyre të shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, si në vijim: Lihtenshtajni, Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Çekia, Sllovakia, Suedia, Meksika dhe Afrika e Jugut.
19. Më 6 korrik 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën datë, me shumicë votash, Gjykata konstatoi që Akti i kontestuar i Kuvendit nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën.
20. Të njëjtën datë, gjyqtari raportues Radomir Laban, në bazë të paragrafit (6) të rregullit 53 (Votimi) të Rregullores së punës, kërkoi nga Kryetarja të caktojë një gjyqtar tjetër, nga shumica, për të përgatitur Aktgjykimin në përputhje me kërkesat e shumicës së gjyqtarëve. Me këtë rast, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi, si njërin nga gjyqtarët që ishte pjesë e Kolegjit shqyrtues, për të përgatitur Aktgjykimin, sipas kërkesës së shumicës.
21. Më 1 gusht 2023, gjyqtari Nexhmi Rexhepi e prezantoi Aktgjykimin para përbërjes së plotë të Gjykatës.
22. Në të njëjtën datë, Gjykata vendosi (i) njëzëri që të deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) me pesë (5) vota “për” dhe dy (2) “kundër” që Vendimi [nr. 08-V-036] i 8 korrikut 2021 i Kuvendit nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] dhe paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës; (iii) njëzëri të refuzojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme; dhe (iv) njëzëri të konstatojë që Aktgjykimin nuk ka efekt prapaveprues dhe nuk afekton të drejtat e fituara të palëve të treta.
23. Në përputhje me rregullin 56 (Mendimet mospajtues) të Rregullores së punës të Gjykatës, gjyqtari Radomir Laban ka përgatitur mendim mospajtues, i cili do të publikohet së bashku me këtë Aktgjykim.

Përmbledhja e fakteve

24. Më 15 tetor 2018, Kuvendi, emëroi me mandat trevjeçar Sali Bashotën, Lirim Gecin dhe Agron Gashin, në cilësi të anëtarëve të Bordit të RTK-së. Më 13 gusht 2020, nga Kuvendi po ashtu me mandat trevjeçar u emëruan anëtarë të Bordit të RTK-së edhe Petrit Musolli, Fadil Gashi, Bajram Mjeku, Albinot Maloku, Ilir Bytyqi dhe Fadil Miftari.
25. Më 25 maj 2021, Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal (në tekstin e mëtejme: Komisioni për Administratë Publike), mbajti mbledhjen e tij për rishqyrtimin e pesë (5) pikave të rendit të ditës, ku ndër të tjera, pika e katërt (4) e rendit të ditës ishte shqyrtimi i Raportit Vjetor të RTK-së për vitin 2020. Pas raportimit të kryetarit të Bordit të RTK-së, Komisioni doli me rekomandim nr. 08/215/Ra-13 për Kuvendin, duke i propozuar këtij të fundit që të mos e miratojë raportin vjetor të RTK-së për vitin 2020. Arsyetimi i rekomandimit në fjalë thekson: *“Në bazë të nenit 21, paragrafi 6, pika 1 dhe nenit 38.4 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Radiotelevizioni i Kosovës ia dorëzon Kuvendit raportin vjetor të aktiviteteve jo më vonë se 31 mars, si dhe raportin vjetor për debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së për qëllime orientuese. Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, në mbledhjen e mbajtur më 25.05.2021, shqyrtoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës dhe*

ulerësoi se i njëjti nuk i përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon mosmiratimin e tij”.

26. Më 21 qershor 2021, Komisioni i Kuvendit për Buxhet, Punë dhe Transfere (në tekstin e mëtejme: Komisioni për Buxhet), nëpërmjet rekomandimit nr. 08/331/Do-222, i propozoi Kuvendit shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së.
27. Më 22 qershor 2021, Komisioni për Administratë Publike, mbajti mbledhjen nr. 7, ku pika e tretë (3) e rendit të ditës ishte: “3. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere në lidhje me shkarkimin e anëtarëve të bordit të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK)”. Komisioni në fjalë, pasi debatoi për pikën e tretë (3) të rendit të ditës, doli me rekomandim Nr. 08/358/Do-238, përmes të cilit i propozoi Kuvendit shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së.
28. Komisioni për Administratë Publike, ndër tjerash, vlerësoi që (i) Raporti Vjetor nuk reflekton “asnjë strategji apo vizion afatshkurtër apo afatgjatë lidhur me shfrytëzimin optimal të kapaciteteve të RTK-së, apo përgjithësisht iniciativa për reformim të RTK-së që të rrisë zbatueshmërinë e dispozitave ligjore”; (ii) në referim të “Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2020”, ndër tjerash, theksoi mangësitë e RTK-së që duhet të adresohen, duke përfshirë “rekrutimin jo të bazuar në merita dhe me shpërblime” dhe se “evitimi i çfarëdo emërimi politik, mungesë të meritokracisë në procese të brendshme apo shpërblime jotransparente, është pikërisht nën kompetencën e Bordit të RTK-së në përputhje me nenin 29, paragrafi 6, 7, 12, 14, 15 dhe 16, dhe dështimi i zbatimit të këtyre dispozitave, flet ndër të tjera edhe për jo kompetencën e Bordit aktual”; (iii) Bordi aktual, ndër tjerash, ka dështuar të respektoj vendimin e Inspektorit të Punës lidhur me “përzgjedhjen e Drejtorit për Shërbime të Përbashkëta”; (iv) në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për RTK-në, “tre nga anëtarët e Bordit të tanishëm, kanë qenë anëtarë të Bordit edhe në vitin 2019 kur punëmarrës të RTK-së kanë bërë deklarime politike, dhe ndaj të cilëve asnjëherë nuk është ngritur procedurë disiplinore”, ndërsa në vitin në vitin 2020, ky Bord “ka emëruar në personelin e tij, si zv. Drejtor, pikërisht persona që kanë shkelur Kodin e Mirësjelljes së RTK-së më parë”; dhe (v) Bordi, ka dështuar të “sigurojë rrjetin e mbulueshmërisë, dëgjueshmërisë dhe shikueshmërisë në tërë territorin e Kosovës”, sidomos “gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 ku siguri i një mbulueshmërie të tillë ka qenë esencial për të siguruar të drejtën kushtetuese të shkollimit të detyrueshëm, në rastet kur mundësitë lejonin vetëm mësimin virtual”.
29. Sipas vlerësimit të Komisionit të lartcekur, (i) Kuvendi ka kompetencën për të shkarkuar të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së bazuar në paragrafin 2 të nenit 28 (Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit) të Ligjit për RTK-në, ndër tjerash, sepse (ii) “Ligji për RTK-në nuk bën referencë në emërtimin njëjës si kufizim të mundësisë për shkarkim të më shumë se një anëtarit njëherësh”. Gjithashtu, Komisioni përkatës iu referua praktikës së shkarkimit të “dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media në vitin 2013”. Për më tepër, sipas Komisionit, baza ligjore për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së është “paafëzia profesionale”, e cila në Ligjin për RTK-në, është e definuar si në vijim: “nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t’i përmbushë detyrat e anëtarit të Bordit”.
30. Në anën tjetër, arsyetimi i Komisionit për Buxhet, fokusohet në dështimin e Bordit të RTK-së për (i) “të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në lidhje me punën e RTK-së”; (ii) “të përpiluar një strategji afatgjatë për zhvillimin dhe financimin e RTK-së”; dhe (iii) të vepruarit në “shkelje të nenit 12 të RTK-së mbi Produksionet e Pavarura dhe Ligjin e Prokurimit Publik”.

31. Përkitazi me çështjen e parë, Komisioni për Buxhet, ndër tjerash, vlerëson që (i) në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] të Kushtetutës, “anëtarët e Bordit Drejtues në vazhdimësi kanë dështuar të sigurojnë qasje të papenguar dhe pakontestuar Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, në inicim dhe kompletim të auditimit të rregullsisë dhe performancës” dhe se “Opinion i Ligjor i Drejtorisë së përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i datës 04.06.2021, specifikon se asnjëherë nuk kishte ndonjë provizion në kuadër të Ligjit të RTK-së që konteston autoritetin e Zyrës Kombëtare të Auditimit” dhe se në këtë kontekst, Bordi i RTK-së gjithashtu “ka dështuar të luaj rol in vendimmarrës dhe mbikëqyrës, siç përcaktohet në nenin 37 të Ligjit të RTK-së” dhe duke iu “nënshtruar udhëzimeve të Drejtorit të Përgjithshëm”, gjithashtu ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 7 të nenit 25 (Përbërja e Bordit) të Ligjit mbi RTK-në.
32. Përkitazi me çështjen e dytë, Komisioni për Buxhet, ndër tjerash, vlerësoi që, (i) bazuar në nenin 21 (Burimet e financimit) të Ligjit për RTK-në, “televizioni publik ishte paraparë të përfitonte financim direkt nga buxheti shtetëror për një periudhë tranzitore trevjeçare, deri në sigurimin e financimit nga parapagimi” dhe se “themeluesi me propozimin e Bordit të RTK-së duhej të kishte vendosur për nivelin e taksës për transmetuesin publik por kjo nuk ka ndodhur” sepse “Bordi aktual nuk ka propozuar ndonjë strategji për të siguruar financim adekuat, të qëndrueshëm dhe transparent ndaj publikut”; dhe (ii) “bazuar në raportet financiare të ekzekutuar, shpenzimet e RTK-së për paga për vitin 2008 ishin € 3,698,982 e totalit të shpenzimeve. Numri i punonjësve për vitin 2008 ishte 424 plus 99 bashkëpunëtorë të pavarur. Në vitin 2020, shpenzimet për paga dhe mëditje janë rritur në € 8,625,000 nga totali i shpenzimeve prej € 12,591,000 apo 68.5%. Në vitin 2020 janë raportuar 1,024 të punësuar, nga të cilët 806 me kontrata të rregullta dhe 218 të tjerë me orare të pjesshme si gazetarë, aktorë apo korrespondentë jashtë vendit. Kjo tendencë e shpenzimeve dhe rritje e pakontrolluar e numrit të punëtorëve ka shkaktuar gjendje të rëndë financiare tek televizioni publik, e shprehur përmes borxhit që varion ndërmjet 2.6 - 5.2 milion euro, ndërmjet 2018-2020”.
33. Ndërsa, përkitazi me çështjen e tretë, Komisioni për Buxhet, ndër tjerash, vlerësoi që (i) “Bordi ka dështuar të sigurojë zbatimin e provizioneve të nenit 12.2 të Ligjit të RTK-së, i cili parasheh që televizioni publik për çdo vit do të shpall konkurs publik për blerjen e veprave audiovizuale të produksioneve të pavarura, dhe t’i transmetojë në programin e vet, në pajtim me Ligjin dhe Statutin e RTK-së; dhe që (ii) “nuk është evidente zbatimi i tenderimit të hapur me qëllim të realizimit të misionit dhe përmbushjes së shijeve, kërkesave dhe interesave diverse të shikuesve dhe dëgjuesve të Kosovës. Nga mostrat e vështruara në platformën e prokurimit të hapur rezulton që ato janë bërë kryesisht përmes negociimit direkt”. Në fund, Komisioni përkatës, ndër tjerash, rekomandoi që “të iniciohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për RTK-në për të inkuorporuar praktikën më të mirë të operimit dhe financimit të televizioneve publike, përfshirë Parimet e Financimit të Televizioneve Publike në Ballkanin Perëndimor, të propozuara nga EBU në kuadër të projektit të mbështetur nga BE dhe Standardet e Financimit të Televizioneve Publike, të propozuara nga Këshilli i Evropës”.
34. Më 25 qershor 2021, Komisioni për Administratë Publike, i dorëzoi Kuvendit rekomandimin për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së.
35. Më 7 korrik 2021, Kuvendi njoftoi deputetët për mbajtjen e seancës plenare të radhës, ku ndër të tjera, pikë e rendit të ditës ishte edhe “shqyrtimi i rekomandimit nr. 08/358/Do-238 të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal”, për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së.

36. Më 8 korrik 2021, Kuvendi nëpërmjet Vendimit [nr. 08-V-035] refuzoi miratimin e Raportit Vjetor me nr. 08/215/Ra-13 të RTK-së për vitin 2020.
37. Po të njëjtën datë, Kuvendi zhvilloi tetë (8) raunde votimi lidhur me shkarkimin e secilit anëtar të Bordit të RTK-së, si dhe miratoi Aktin e kontestuar, nëpërmjet të cilit u konfirmua shkarkimi i të gjithë, përkatësisht 8 (tetë) anëtarëve të Bordit të RTK-së. Përmbajtja e Aktit të kontestuar, thekson:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (9) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 67 të Rregullores së Kuvendit, si dhe nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 7 dhe 8 korrik 2021, me rekomandim të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, me votim të veçantë për secilin anëtar, mori këtë

VENDIM

- Për shkarkimin e tetë (8) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës*
- I. *Shkarkohen tetë (8) anëtarët e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, si në vijim:*

1. *Sali Bashota,*
2. *Agron Gashi,*
3. *Lirim Geci,*
4. *Ilir Bytyqi,*
5. *Albinot Maloku,*
6. *Bajram Mjeku,*
7. *Petrit Musolli dhe*
8. *Fadil Miftari.*

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

Nr. 08-V-036

Prishtinë, 08.07.2021

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës.

(i) lidhur me shkeljen neneve 4 dhe 7 të Kushtetutës

39. Parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash, theksojnë se siguria juridike është parim themelor në secilin rend juridik, i cili promovohet nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe nga Gjykata Kushtetuese. Në veçanti, parashtruesit e kërkesës, i janë referuar rastit të Gjykatës KO219/19, ku, ndër tjerash, theksohet se *“Parimi i sigurisë juridike dhe ai i parashikueshmërisë janë tipare të qenësishme të një ligji dhe pjesë përbërëse të parimit kushtetues të sundimit të ligjit”*. Tutje, sipas parashtruesve të kërkesës, theksohet se siguria juridike është një nga shtyllat kryesore të sundimit të ligjit dhe kërkon, mes tjerash, që rregullat të jenë *“të qarta dhe të sakta”* dhe të synojnë të sigurojnë *“që situatat dhe marrëdhëniet juridike të mbeten të parashikueshme”*.
40. Në kontekstin e lartcekur, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se lidhur me shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së është vepruar në kundërshtim *“me parimin e parashikueshmërisë”*, pasi që as me Ligjin për RTK-në dhe me asnjë ligj tjetër, *“nuk parashihet dhe nuk lejohet shkarkimi i të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së”* dhe se

në rastin konkret është ndërmarrë një veprim që nuk është i përcaktuar fare me Ligjin për RTK-në. Përveç tjerash, një procedurë e tillë e ndjekur për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, *“shkel të gjitha parimet procedurale që përcaktohen me ligjet në fuqi”*.

41. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se shkarkimi i anëtarëve të Bordit të RTK-së *“nuk mund të jetë prerogativë e mbikëqyrjes që përbën një veprim ekzekutiv që bie ndesh me fizionominë kushtetuese të Kuvendit si organ përfaqësues dhe ligjvënës”*. Sipas tyre, një qasje e tillë, është në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushtetit nga neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës, që në të njëjtën kohë, përbën një vlerë kushtetuese në kuptim të paragrafit 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës.

(ii) *lidhur me shkeljen e paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës*

42. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Akti i kontestuar është nxjerrë në bazë të (i) paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës; (ii) nenit 28 [Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit] të Ligjit për RTK-në; dhe nenit 67 të Rregullores së punës së Kuvendit. Mbi këtë bazë, të njëjtit pretendojnë se Akti i kontestuar është në kundërshtim me *“nenin 65 (9) të Kushtetutës, për shkak të ushtrimit arbitrar të kompetencës së Kuvendit për mbikëqyrjen e punëve të institucioneve publike, gjë që cenon të drejtat e anëtarëve të shkarkuar të Bordit të RTK-së, të drejta këto të cilat burojnë nga Kushtetuta (Kapitulli II), si dhe dokumentet e instrumentet ndërkombëtare të cilat zbatohen drejtpërsëdrejti në rendin juridik të Republikës së Kosovës, sipas nenit 22 të Kushtetutës”*.
43. Parashtruesit e kërkesës tutje pretendojnë se Akti i kontestuar *“nuk tregon se për cilat arsye ligjore janë shkarkuar anëtarët e Bordit të RTK-së”*. Sipas parashtruesve të kërkesës, fakti që Akti i kontestuar *“nuk përmend arsyet nga neni 28 i Ligjit nr. 04/L-046 për RTK-në, për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, nënkupton që Kuvendi ka ushtruar kompetencën kushtetuese, të përcaktuar me paragrafin 9, të nenit 65 të Kushtetutës në mënyrë arbitrare dhe jashtë kushteve të përcaktuara me nenin 28 të Ligjit për RTK-në”*. Kjo, sepse, sipas tyre, në bazë të Ligjit për RTK-në, Kuvendi ushtron kompetenca mbikëqyrëse ndaj RTK-së, përkthazi me buxhetin, përmes dorëzimit të raportit vjetor, përkatësisht sipas paragrafit 6.1 të nenit 21, nenit 37 (Mbikëqyrja e funksionimit të RTK-së) dhe nenit 38 (Karakter i publik i veprimtarisë) të Ligjit për RTK-në dhe në asnjë mënyrë Kuvendi nuk mund të ushtrojë kompetenca mbikëqyrëse jashtë mekanizmave që përcaktohen me Ligjin për RTK-në.
44. Në vazhdim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ushtrimi i kompetencave kushtetuese të Kuvendit, sipas paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës, duke mos respektuar kriteret e përcaktuara me nenin 28 të Ligjit për RTK-në, përbën *“një vendim arbitrar dhe rrjedhimisht të paarsyetuar edhe për faktin se shkarkimi i të gjithë anëtarëve të Bordit është bërë në bllok”*. Sipas tyre, Ligji për RTK-në prezumohet si kushtetues sepse asnjëherë nuk është sfiduar kushtetutshmëria e tij nga asnjë subjekt i autorizuar. Për pasojë, *“shkelja e tij nga ana e Kuvendit me rastin e shkarkimit kolektiv të anëtarëve të Bordit të RTK-së përbën shkelje të detyrimit kushtetues për respektim të sundimit të ligjit”*.
45. Tutje, parashtruesit e kërkesës shtojnë se Akti i kontestuar ka shkelur Kushtetutën në mënyrë të drejtpërdrejtë, (i) *“për shkak se në asnjë pjesë të tij nuk mund të subsumohet nën konceptin kushtetues të mbikëqyrjes, që paraqet kryefjalën e fjalisë së paragrafit 9, të nenit 65 të Kushtetutës”*; dhe sipas vlerësimit të tyre, (ii) *“çdo mbikëqyrje parlamentare, jo vetëm kjo nga paragrafi 9, i nenit 65 të Kushtetutës, ka të bëjë me vlerësimin nga ana e Kuvendit të raportimeve të bëra nga institucionet që i raportojnë*

Kuvendit për punën e tyre, sepse Kuvendi nuk mund të zëvendësojë institucionet që i raportojnë, për shkak se nuk është në natyrën kushtetuese të tij për të luajtur rolin e gjykatës së faktit”.

46. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës theksojnë që (i) “*kërkesa e tyre nuk ndërlidhet me “kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për RTK-në”*; por (ii) “*vlerësimin e veprimit arbitrar të Kuvendit, që nuk bazohet në asnjë pikë me parametrat ligjor që operacionalizojnë paragrafin 9, të nenit 65 të Kushtetutës*”.

(iii) lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara sipas kapitullit II të Kushtetutës

a) lidhur me paragrafin 1 të nenit 24 të Kushtetutës

47. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se Akti i kontestuar ka shkelur edhe të drejtat kushtetuese për barazi para ligjit të anëtarëve të Bordit të RTK-së, duke e ndërlidhur këtë pretendim “*me mënyrën e paprecedent të shkarkimit në bllok të të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së*”. Sipas parashtruesve të kërkesës, “*ky trajtim nga ana e Kuvendit i vendos të njëjtit në pozitë të pabarabartë me anëtarët e Bordit të RTK-së, të cilëve u ka përfunduar më herët mandati, siç përcakton ligji*”. Vendosja në pozitë të pabarabartë të anëtarëve aktualë të Bordit, me anëtarët e tjerë që u ka përfunduar mandati më herët, sipas parashtruesve të kërkesës, “*përbën shkelje të barazisë para ligjit për shkak të trajtimit të ndryshëm në situatë të njëjta*”. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës i janë referuar rasteve të (i) Gjykatës, përkatësisht KO203/19, me parashtrues: *Avokati i Popullit*, vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, paragrafëve 172 dhe 173 dhe KO157/18, me parashtrues: *Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës*, vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit nr. 031L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, paragrafi 77, si dhe *mutatis mutandis* rasteve të (ii) GJEDNJ-së *Igeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, kërkesat nr. 5095171, 5920172 dhe 5926172, të 7 dhjetorit 1976, paragrafi 56, dhe *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 42184/05, e 16 marsit 2010, paragrafi 61.

48. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në rrethanat e rastit konkret “*barazia para ligjit*” është shkelur edhe për faktin se anëtarët e shkarkuar të Bordit të RTK-së, në përbërjen e tyre aktuale kanë mandate të ndryshme sa i përket kohëzgjatjes. Andaj, sipas tyre, “*këto mandate të ndryshme i vendosin vet anëtarët e Bordit të RTK-së në pozita të pabarabarta meqë që të gjithë anëtarët kanë mandate të ndryshme dhe duke qenë kështu edhe proceduralisht dhe në aspektin faktik duhet të trajtohen ndryshe dhe me dallim nga njeri-tjetri*”. Sipas parashtruesve të kërkesës, në rastin konkret, “*duke pasur parasysh faktin se 5 (pesë) anëtarë të shkarkuar kanë mandat të ndryshëm, nga 3 (tre) të tjerë po ashtu të shkarkuar, nënkuptohet se edhe situata e pesë (5) anëtarëve të sapo zgjedhur, me më pak se një vit mandat të kaluar, është e ndryshme nga tre (3) të tjerët, të cilët janë në vitin e fundit të mandatit*”. Parashtruesit, ndër tjerash, argumentojnë se një qasje e tillë e Kuvendit, përmes shkarkimit “*në bllok të anëtarëve të Bordit të RTK-së*”, pa dalluar situatat konkrete, rezulton në cenimin e parimit të barazisë para ligjit, si një e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

b) lidhur me nenin 31 të Kushtetutës

49. Parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash, argumentojnë se e drejta për t’u dëgjuar është parim themelor i sistemit juridik, i cili prek në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Ky parim si i tillë është promovuar edhe nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe i njëjti është jetësuar edhe në praktikën e Gjykatës. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës thirren në rastet

e Gjykatës KI186/19, KI187/19, KI200/19 dhe KI208/19, duke pretenduar se këto raste janë të aplikueshme në rrethanat e këtij rasti.

50. Parashtruesit e kërkesës, në këtë kontekst, gjithashtu pretendojnë se: *“Kuvendi nuk i ka dhënë mundësi anëtarëve të Bordit të RTK-së, për t’u dëgjuar për arsyet e shkarkimit të tyre, para nxjerrjes së vendimit për shkarkim, më 8 korrik 2021. Përmes pamundësisë për t’u dëgjuar, anëtarët e Bordit të RTK-së, nuk kanë pasur mundësi që të shprehin kundërshtimet dhe kundërgargumentet e tyre, lidhur me shkarkimin e tyre nga ana e Kuvendit. Me këtë rast, përmes pamundësisë për t’u dëgjuar, Kuvendi ua ka shkelur të gjithë anëtarëve të bordit të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, nga neni 31 i Kushtetutës. Pamundësinë për argumentim e kishte vlerësuar si arbitrare edhe GJRDNJ-së në rastin TAHIROV v. AZERBAIJAN, viti 2015”.*

c) lidhur me nenin 32 në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës

51. Parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash, pretendojnë, që shkarkimi i anëtarëve të Bordit të RTK-së, *“në mënyrë të paparashikuar dhe arbitrare”* u ka pamundësuar atyre të kenë mjete efektive juridike për t’u mbrojtur, *“pasi që rendi juridik i Republikës së Kosovës nuk ofron një mjet efektiv juridik që anëtarët e shkarkuar të Bordit të RTK-së t’i mbrojnë të drejtat e tyre”.* Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *“anëtarëve të Bordit të RTK-së u është shkelur e drejta për mjete efektive juridike nga neni 32 i Kushtetutës”* dhe që Ligji për RTK-në *“nuk parasheh ndonjë mundësi të ankesës kundër Aktit të kontestuar, për shkarkim të anëtarit të Bordit të RTK-së”.* Në këtë kuptim, parashtruesit e kërkesës mëtojnë se mungesa e mjeteve efektive juridike shkel edhe nenin 54 të Kushtetutës, sepse në rastin konkret nuk ka mjete efektive juridike dhe në këtë mënyrë, anëtarëve të shkarkuar të Bordit të RTK-së, u pamundësohet mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut që u garantohet me Kapitullin II të Kushtetutës.
52. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksojnë që në kontekstin e mjetit juridik efektiv, anëtarët e shkarkuar të Bordit të RTK-së do të mund të hapnin konflikt administrativ, vetëm sipas ligjit në fuqi për konfliktin administrativ. Ky ligj, në nenin 9 të tij, përcakton, ndër të tjera, që: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”.* Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës, pretendojnë që *“vendimi i Kuvendit nuk është një akt administrativ, por një akt i organit kushtetues që i nënshtrohet kontrollit të kushtetutshmërisë”.* Prandaj, sipas parashtruesve të kërkesës, *“një aspekt i tillë do t’i pamundësonte anëtarëve të shkarkuar të Bordit të RTK-së që të krijonin rast në Gjykatën Themelore, për shkak të natyrës së aktit juridik dhe kjo do ta bënte mjetin juridik të rregullt joefektiv, për të gjithë të shkarkuarit”.*

d) lidhur me nenin 45 të Kushtetutës

53. Parashtruesit e kërkesës, fillimisht referohen në (i) paragrafin 3 të nenit 45 të Kushtetutës; dhe (ii) paragrafin 3 të nenit 25 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, duke theksuar, ndër tjerash, që ky i fundit përcakton që *“çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: (c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij”.* Sipas parashtruesve të kërkesës, *“anëtarët e Bordit të RTK-së nuk janë duke u pranuar në kushte të përgjithshme barazie për ushtrimin e funksionit, pasi që shkarkimi i tyre është bërë jashtë kushteve të përcaktuara me Ligjin për RTK-në, respektivisht me nenin 28, të cilin e merr për bazë Akti i kontestuar, duke mos ofruar kushte barazie, në krahasim me mënyrën se si i ka*

trajtuar Kuvendi anëtarët e Bordit të RTK-së, që nga themelimi e deri tani, respektivisht përgjatë kohës sa është në fuqi Ligji aktual për RTK-në”.

54. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se (i) ndërprerja e mandatit të anëtarëve të Bordit të RTK-së jashtë kushteve të përcaktuara me ligj, ua shkel atyre të drejtën për të ushtruar poste publike në mënyrë të barabartë, e drejtë kjo që buro nga paragrafi 3 i nenit 45 të Kushtetutës dhe paragrafi 3 i nenit 25 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, që zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, sipas nenit 22 të Kushtetutës; dhe theksojnë që (ii) *“standardi i shkeljes së nenit 45 (të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes), në kuptimin e shkeljes arbitrare të një mandati, ishte trajtuar po ashtu në praktikën e Gjykatës në rastin KO29/12 dhe KO48/12, ku ishte konstatuar që shkelja arbitrare e mandatit të Presidentes qon në shkelje të të drejtave që burojnë nga neni 45 i Kushtetutës”*. Në të njëjtën mënyrë, edhe në dritën e rrethanave të rastit konkret, sipas parashtruesve të kërkesës, Kuvendi *“ka vendosur që të bëjë shkeljen e mandatit të tetë (8) anëtarëve të Bordit të RTK-së, në bllok jashtë kushteve të përcaktuara me nenin 28 të Ligjit për RTK-në dhe pa dhënë asnjë arsytim se për cilën arsye që e përcakton Ligji (neni 28) janë shkarkuar anëtarët e Bordit të RTK-së”*.

Pretendimet përkitazi me kërkesën për masë të përkohshme

55. Përkitazi me kërkesën e tyre për nevojën e caktimit të masës së përkohshme, parashtruesit e kërkesës janë bazuar në nenin 27 (Masa e përkohshme) të Ligjit për Gjykatën, duke pretenduar (i) parandalimin e rreziqeve apo dëmeve të pariparueshme; dhe (ii) interesin publik në caktimin e kësaj mase. Parashtruesit e kërkesës argumentojnë se kërkesa e tyre është *prima facie* e themeltë dhe ka merita të rastit, ashtu që *“mosvënja e masës së përkohshme mund të shkaktojë dëm të pariparueshëm dhe është në interes publik”*.
56. Përkitazi me (i) themelësinë *prima facie* të meritave të rastit, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se Akti i kontestuar është qartazi në shpërputhje me Kushtetutën sepse cenon parimet dhe normat kushtetuese të përshkruara si më sipër dhe se Akti i kontestuar *“qartazi prek të drejtat e anëtarëve të shkarkuar të Bordit të RTK-së, për arsye se Kuvendi me rastin e shkarkimit e ka ushtruar kompetencën në mënyrë krejtësisht arbitrare dhe jashtë ligjit për RTK-në, kushtetutshmëria e të cilit prozumohet”*; ndërsa, përkitazi me (ii) shkaktimin e dëmit të pariparueshëm dhe interesin publik, parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash, theksojnë se shkarkimi i anëtarëve të Bordit të RTK-së *“do t'i shkaktojë transmetuesit publik dëm të pariparueshëm dhe do t'ia pamundësojë funksionalitetin e tij”*, ndër tjerash sepse sipas *“Ligjit për RTK-në, respektivisht sipas nenit 4.2, Kuvendi është institucioni kompetent i cili mbron autonominë e RTK-së”* dhe se *“në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës mëtojnë se me rastin e shkarkimit të anëtarëve të Bordit, Kuvendi nuk ka siguruar autonominë e RTK-së, por e ka rrezikuar atë”*.
57. Në fund, parashtruesit e kërkesës arsyetojnë se vendosja e masës së përkohshme ndaj Aktit të kontestuar është po ashtu në interes publik, pasi që një masë e tillë do të ruante funksionalitetin e RTK-së, si dhe do të mbronte autonominë e tij. Një gjë e tillë është në përputhje me interesin publik, duke pasur parasysh misionin informues dhe edukues të cilin e ka RTK-ja, si transmetues i pavarur. Kjo përbën cenim të lirisë së shprehjes nga paragrafi i parë i nenit 40 të Kushtetutës, fjalia e dytë, që thotë se *“liria e shprehjes përfshin të drejtën për t'u shprehur”*. Kjo e drejtë mohohet me vetë faktin që RTK-ja më nuk ka organ autonom që mbikëqyrë ligjshmërinë e punës së tij dhe, për pasojë, është bërë jofunksional në realizimin e këtij funksioni ligjor që garantohet me Kushtetutë si një përbërës i qartë i lirisë së shprehjes.

Komentet e RTK-së

58. Më 5 gusht 2021, RTK dorëzoi komentet e saj në Gjykatë, duke argumentuar që (i) shkarkimi i anëtarëve të Bordit të RTK-së është bërë nga Kuvendi në mënyrë arbitrare dhe jashtë kushteve të përcaktuara në nenin 28 (Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit) të Ligjit për RTK-në; dhe (ii) Kuvendi nuk ka arritur të argumentojë dhe të tregojë se mbi cilën bazë të nenit 28 të Ligjit për RTK-në, janë shkarkuar anëtarët e Bordit, duke ushtruar në mënyrë të padrejtë dhe arbitrare kompetencat që burojnë nga paragrafi 9 i nenit 65 të Kushtetutës.
59. Më tej, RTK argumenton se paragrafi 9 i nenit 65 të Kushtetutës përcakton se Kuvendi mbikëqyrë punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit, dhe sipas pretendimit, *“mbikëqyrja mund të bëhet vetëm përmes mekanizmave që përcaktohen me Ligjin për RTK-në”*. Sipas vlerësimit të RTK-së, *“nëse mbikëqyrja e organeve publike është bërë nga Kuvendi, në bazë të kësaj kompetence kushtetuese, dhe kjo mbikëqyrje ka ndodhur jashtë mekanizmave që i përcakton Ligji për RTK-në, atëherë vendimi është kundërkushtetues, për shkak se Kuvendi në këtë rast ka shfrytëzuar një kompetencë kushtetuese, jashtë asaj që e përcakton ligji, edhe pse vetë neni 65.9 përcakton se mbikëqyrja mund të bëhet në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, në rastin konkret në bazë të Ligjit për RTK-në”*.
60. Sipas RTK-së, *“shkarkimi nuk nënkupton mbikëqyrje”*, sepse (i) bazuar në nënparagrafin 6.1 të paragrafit 6 të nenit 21 (Burimet e financimit), paragrafët 1 dhe 3 të nenit 37 (Mbikëqyrja e funksionimit të RTK-së) dhe paragrafi 4 i nenit 38 (Karakter i veprimtarisë) të Ligjit për RTK-në, RTK mbikëqyret nga Kuvendi përmes dorëzimit të raportit vjetor të aktiviteteve, përmes raportit të debatit publik si dhe përmes auditimit, i cili mund të kërkohej nga Kuvendi; dhe se (ii) në asnjë rast, *“mbikëqyrja nuk bëhet përmes shkarkimit të tërë Bordit edhe pse me procedurë të ndarë të votimit, në asnjë nen të Ligjit për RTK-në nuk përcaktohet kompetenca e Kuvendit për shkarkimin e gjithë Bordit të RTK-së apo shpërbërjen e gjithë Bordit”*.
61. Për më tepër, RTK thekson se (i) *“anëtarët e Bordit të RTK-së asnjëherë nuk janë ftuar nga Komisioni funksional ose nga Kuvendi për të dhënë arsyetimet dhe kundërgargumentet e tyre për shkarkimin e tyre”*; (ii) *“në rastin kur është votuar rekomandimi i Komisionit funksional për shkarkimin e anëtarëve të Bordit, i ftuar për t'u dëgjuar në atë takim nuk ka qenë asnjë anëtar i Bordit të RTK-së”*; dhe (iii) për pasojë, *“pamundësia për t'u dëgjuar, me rastin e shkarkimit, si veprimi i fundit i Kuvendit, përbën shkelje po ashtu të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, nga neni 31 i Kushtetutës”*.
62. Përveç kësaj, RTK pretendon se në rastin konkret është shkelur edhe barazia para ligjit që garantohet me nenin 3 dhe 24 të Kushtetutës, sepse *“Kuvendi ka abuzuar me një kompetencë kushtetuese, dhe duke e operacionalizuar atë kompetencë jashtë kushteve që i përcakton Ligji për RTK-në dhe për shkak se anëtarët e Bordit janë vendosur në pozitë të pabarabartë, edhe pse në situatë të njëjtë, sidomos anëtarët të cilët kanë ushtruar mandatin e tyre më pak se një vit, pasi që ishin zgjedhur nga legjislatura e kaluar, respektivisht në vitin 2020”*.
63. Tutje, RTK pretendon se anëtarëve të Bordit, po ashtu iu është shkelur e drejta për mjete efektive juridike e garantuar me nenin 32 në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës, sepse *“Ligji për RTK-në nuk përcakton një mjet real dhe të qasshëm dhe efektiv, përmes së cilit anëtarët e Bordit do të mund ta atakonin Aktin e kontestuar të Kuvendit për shkarkimin e tyre”*. Sipas RTK-së, *“anëtarët e Bordit nuk kanë mundur të ushtrojnë*

mjetin juridik në gjykatat e rregullta sepse në vitin 2020 Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, e ka shpallur të papranueshëm një rast ku objekt i goditjes ishte Dekreti i Presidentit dhe me këtë rast gjykata ka vlerësuar se Dekreti i Presidentit duhet t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues".

64. Po ashtu, RTK thekson se asnjëri nga rekomandimet e Komisionit funksional për shkarkimin e anëtarëve të Bordit nuk ka të bëjë me kompetencat dhe përgjegjësitë e Bordit. Sipas RTK-së, arsyet e propozimit për shkarkim të anëtarëve të Bordit janë bazuar në: 1) dështimin për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në lidhje me punën e RTK-së; 2) dështimin për të përpiluar një strategji afatgjate për zhvillimin dhe financimin e RTK-së; dhe 3) shkeljen e nenit 12 (Produksionet e pavarura) të Ligjit për RTK-në mbi produksionet e pavarura dhe Ligjin e Prokurimit Publik. Për më tepër, në nenin 29 (Kompetencat e Bordit të RTK-së) të Ligjit për RTK-në, janë të përcaktuara qartësisht detyrat e Bordit të RTK-së dhe se asnjëra nga çështjet që i janë atribuuar Bordit si shkelje nga Komisioni funksional, në rastin konkret nuk janë arsye për shkarkim dhe as që lidhen me nenin 28 (Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit) të Ligjit për RTK-në.
65. Në fund të komenteve, RTK informon Gjykatën që konkursi për vendet e tetë (8) anëtarëve të shkarkuar të Bordit është mbyllur më 2 gusht 2021, andaj sipas tyre, *"do të ishte e mirëseardhur që ky rast të vendosej sa më shpejtë sepse vonesa eventuale e vendosjes do e komplikonte situatën dhe do të cenonte edhe parimin e sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit për anëtarët e shkarkuar të Bordit".*

Komentet e dorëzuara nga Doarsa Kica-Xhelili, në emër të grupit parlamentar të LVV-së

66. Komentet përkatëse, duke komentuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës, theksojnë që kërkesa e parashtruesve të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar, nuk ngërthen çështje kushtetuese dhe për rrjedhojë, nuk mund të jetë objekt vlerësimi pranë Gjykatës Kushtetuese, sepse, sipas komenteve, është e qartë që kërkesat që mund të dorëzohen pranë Gjykatës Kushtetuese, duhet të ndërlihen me vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe jo të ligjshmërisë së vendimeve të Kuvendit. Sipas komenteve, Gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së shkarkimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së edhe në këtë rast nëse kjo lëndë do të trajtohej në procedurë administrative, nga përmbajtja e vendimit të Kuvendit, shihet qartë se bëhet fjalë për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, që vetë Kuvendi i ka zgjedhur, plotësisht në përputhje me Ligjin për RTK-në.
67. Sipas komenteve, Gjykata Kushtetuese ka në juridiksion që të kontrollojë aktet e autoriteteve publike që nxirren në raste individuale për përputhjen e tyre me katalogun kushtetues të të drejtave të njeriut, por ky rast nuk shpërfaq ngjashmëri me kërkesën në fjalë. Në këtë kontekst, sipas komenteve, Kushtetuta, derisa përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në paragrafin 7 të nenit 113, thekson që individët janë të autorizuar të ngrenë në Gjykatën Kushtetuese shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
68. Tutje, komentet theksojnë që parashtruesit e kërkesës përpiqen të vënë theksin në çështje kushtetuese, duke pretenduar se Akti i kontestuar është kundërkushtetues, ndërsa *"ky vendim nuk ka bazë në Kushtetutë, përveç bazës kushtetuese të akteve që i miraton Kuvendi, kërkesa në asnjë mënyrë nuk ngërthen në vete aspektin përmbajtësor të shkarkimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së".*

69. Në vazhdim të komenteve përkatëse, gjithashtu thuhet se “(...) në kërkesën e parashtruar, nuk gjejmë asnjë argument kushtetues që konfirmon se në një formë apo tjetrën ky rast ka të bëjë me një shkelje kushtetuese. Referencat që parashtruesit e kërkesës bëjnë në një sasi dërmuese të neneve, janë të paqarta në kuptimin e mungesës se relevancës me rastin konkret. Pra, në kërkesë aludohet në një mori shkeljesh, sikurse vijon: shkelje e nenit 65. 9 e Kushtetutës, si dhe neneve 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe neni 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe është shkelur siguria juridike. Vlerësojmë se për Gjykatën Kushtetuese mungesa e kësaj relevance bëhet e qartë me një lexim të thjeshtë të objektit të trajtimit. Sidoqoftë ... marrim shembuj vetëm nenet 4, 31 dhe 45. Nisur nga neni 4, të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është shkelur me vendimin e Kuvendit, nuk ka të bëjë asgjë me këtë vendim, sepse neni 4 flet për formën e qeverisjes në Kosovë dhe ndarjen e pushteteve. Sipas nenit 4, paragrafi 1 të Kushtetutës, Kosova është Republikë e bazuar në parimet demokratike, organizimi i pushtetit të së cilës ushtrohet sipas parimit të ndarjes së pushtetit. Në mënyrë që të përcaktohet nga afër natyra e formës së qeverisjes në Republikën e Kosovës, është e domosdoshme të shqyrtohen detajisht pozita kushtetuese, të drejtat e përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të institucionit të Presidentit të Republikës. Parimi i ndarjes së pushtetit është mënyrë e rregullimit të marrëdhënieve mes pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, në të cilën secili nga këto tri pushtete ushtron pushtetin e vet pavarësisht nga dy të tjerat”.
70. Tutje, sipas komenteve përkatëse thuhet se, përderisa neni 45 i Kushtetutës, flet për të drejtën civile dhe politike për të votuar dhe për t'u votuar, e njëjta, sipas komenteve, është vënë absolutisht jashtë kontekstit, sepse është plotësisht e qartë që kjo në asnjë formë nuk i referohet emërimeve dhe shkarkimeve të Bordit të RTK-së. Njësoj, nuk mund të pretendohet se është shkelur e drejta për gjykim të drejtë në shpërputhje me nenin 31 të Kushtetutës, për sa kohë që nuk është iniciuar një procedurë e tillë, sikurse që nuk mund të pretendosh se është cenuar e drejta për mjete juridike apo për mbrojtje gjyqësore përderisa nuk ka asnjë veprim juridik të iniciuar nga individët.
71. Sipas komenteve në fjalë, anëtarët e Bordit të RTK-së, nëse e kanë vlerësuar se Akti i kontestuar i Kuvendit është i kundërligjshëm, do të duhej t'i drejtoheshin gjykatave të rregullta për ta kontestuar kundërligjshmërinë e tij. Në ndërkohë, deputetët e Kuvendit, sipas saj, nuk kanë legjitimitet t'i drejtohen gjykatave të rregullta në emër të tanimë ish-anëtarëve të Bordit të RTK-së. Në komentet e dorëzuara theksohet se “Qëndrimin e kufizimit të rolit të Gjykatës Kushtetuese, në vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe jo të ligjshmërisë, e mban edhe kjo Gjykatë dhe për këtë flet edhe praktika e saj (KI79/19), në Aktvendimin për papranueshmëri të kësaj Gjykate, të 10 gushtit 2020, në paragrafin 56”.
72. Për më tepër, komentet në fjalë theksojnë se Gjykata Kushtetuese ka për detyrë interpretimin përfundimtar të dispozitave të Kushtetutës. Ndërsa, juridiksioni që bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nënkupton vlerësimin e kushtetutshmërisë së çfarëdo ligji apo vendimi. Sipas komenteve, vendimet e Kuvendit mund të jenë objekt i vlerësimit kushtetues për sa i përket procedurës së ndjekur edhe përmbajtjes së tyre, por vetëm në kuptim të kushtetutshmërisë. Për më tepër, sipas komenteve, parashtruesit e kërkesës nuk e kanë të qartë ose qëllimisht e ngatërrojnë procesin ligjvënës dhe funksionin mbikëqyrës të Kuvendit. Sipas komenteve (i) parashtruesit e kërkesës qëllimisht nuk precizojnë (saktësojnë kërkesën) nëse e kontestojnë procedurën apo e kontestojnë përmbajtjen e aktit, sepse kështu shmangin argumentimin, ngase për t'u vlerësuar një akt i Kuvendit në aspektin kushtetues do të duhej që Kushtetuta të përcaktojë shprehimisht të paktën se cila është procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit të RTK-së, madje edhe procedurën e shkarkimit; dhe

(ii) në rastin konkret, përbërja, funksionimi, përgjegjësitë, mënyra e zgjedhjes dhe mënyra e shkarkimit janë përcaktuar me ligj të veçantë. Kësisoj, sipas komenteve në fjalë, Akti i kontestuar i Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve, edhe pse akt i një organi publik, nuk përbën objekt të vlerësimit të kushtetutshmërisë.

73. Në kuptim të mundësisë së shkarkimit të anëtarëve një nga një apo më shumë se një anëtar të Bordit, sipas komenteve përkatëse (i) Ligji për RTK-në nuk bën referencë në emërtimin njëjës si kufizim të mundësisë për shkarkim të më shumë se një anëtar njëherësh; (ii) si referencë, ka edhe nene të tjera përbrenda Ligjit për RTK-në që bën referim njëjës, por aplikohet në shumicë (shih nenin 27); dhe (iii) arsyetimi i dhënë në rekomandim shumë qartë ka sqaruar në pjesë të ndryshme të tij se i njëjti vlen për të gjithë anëtarët e Bordit për arsyet e ofruara aty.
74. Rrjedhimisht, sipas komenteve përkatëse, jo vetëm që kërkesa e parashtruesve të kërkesës nuk ka të bëjë me një shkelje kushtetuese, por edhe sikur të trajtohej ligjshmëria e kësaj kërkesë, do të konstatohet se nuk ka asnjë shkelje të vetme të Ligjit për RTK-në. Marrë parasysh të mësipërmet, komentet theksojnë që Gjykata duhet ta hedh poshtë si të papranueshme kërkesën e parashtruesve.

Kontributi i Shteteve Anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias

Austria

75. Në Austri, Korporata e Transmetimit Publik (ORF), është fondacion i themeluar sipas të drejtës publike. E njëjta menaxhohet nga drejtori i përgjithshëm, i emëruar nga Këshilli i Fondacionit, Stiftungsrat, për një periudhë pesëvjeçare. Këshilli i Fondacionit ka tridhjetepesë (35) anëtarë, të cilët emërohen nga Qeveria (me propozim të partive politike parlamentare), nga Landet, nga Këshilli i Audiencës, Publikumsrat, dhe nga Këshilli i Punës. Përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm përcaktohen me ligj. Përveç përgjegjësisë që rrjedhin nga ligji, drejtori i përgjithshëm mund të ngarkohet me përgjegjësi shtesë të cilat dalin nga miratimi i rezolutave nga Këshilli i Fondacionit.
76. Drejtori mund të shkarkohet nga Këshilli i Fondacionit, me votat e shumicës prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve. Ligji përkatës nuk saktëson bazat e shkarkimit. Austria nuk ka praktikë gjyqësore për raste të kësaj natyre.

Afrika e Jugut

77. Në Afrikën e Jugut, transmetuesi publik, SABC, është organ shtetëror, bazuar në Kushtetutë dhe Ligj, i cili drejtohet dhe mbikëqyret nga një Bord prej pesëmbëdhjetë (15) anëtarësh, dymbëdhjetë (12) prej të cilëve janë anëtarë jo-ekzekutivë, që i zgjedh Asambleja Kombëtare, bazuar në kualifikimet adekuate profesionale në fushën informative dhe i emëron Presidenti, roli i të cilit është thjesht formal. Ndërsa tre (3) anëtarët ekzekutivë përbëhen nga Drejtori i përgjithshëm, Zyrtari kryesor operativ dhe Zyrtari kryesor financiar. Bazuar në legjislacionin e këtij shteti, ka dy skenarë për shkarkimin e anëtarëve të Bordit. I pari inicohet nga vet Bordi, i cili i rekomandon Asamblesë Kombëtare shkarkimin e anëtarit të Bordit, për shkak: të mungesës për tre (3) muaj rresht në mbledhje të Bordit, të sjelljes së keqe, ose pamundësisë për t'i kryer detyrat në mënyrë efikase. Së dyti, të gjithë anëtarët e Bordit, mund të shkarkohen për të njëjtat arsye sipas nenit 15A (2) të Ligjit. Respektivisht shpërbërja e gjithë Bordit, rrjedh nga proceset e shkarkimit të anëtarëve individual të Bordit, sipas nenit 15 (1) dhe 15A (1) të Ligjit. Në rrethana të tilla, Asambleja Kombëtare, pas një hetimi të duhur, miraton një rezolutë me të cilën rekomandon shpërbërjen e tërësishme të Bordit, nëse ai dështon të kryejë detyrat e tij fiduciare, nëse nuk respekton Ligjin/Kartën e SABC dhe nëse nuk i përmbush detyrat e përcaktuara me Ligj. Largimi i anëtarit të Bordit të SABC për shkak të *"paafësisë profesionale"* dhe/ose mosmiratimi i raportit vjetor të SABC

është i barabartë me “*pamundësinë për të kryer detyrat në mënyrë efikase*” ose “*sjelljen e keqe*” në kuptim të nenit 15A. Për arsye të njëjta mund të shpërbëhet i tërë Bordi. Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Bordit të SABC, është trajtuar në gjykatat më të ulëta, pranë të cilave u parashtrua një kërkesë për mospërmbyllje të detyrimeve kushtetuese nga ana e Presidentit, për të caktuar listën e kandidatëve për emërimin e anëtarëve joekzekutivë të Bordit, e cila iu dërgua atij nga Asambleja Kombëtare, në kuptim të nenit 13 të Ligjit. Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut, në këtë rast nxori një urdhër, meqë ishte kërkuar të shqyrtohej juridiksioni ekskluziv, dhe për këtë arsye çështja u konsiderua e diskutueshme dhe interesat e drejtësisë nuk garantonin shqyrtim të mëtejshëm të çështjes.

Bosnja dhe Hercegovina

78. Në Bosnje dhe Hercegovinë, transmetuesit publik mbikëqyren nga Bordi i Guvernatorëve. Ligji përkatës përcakton se Asambleja parlamentare e Bosnje dhe Hercegovinës, emëron anëtarët e Bordit. Ligji më tutje përcakton tri (3) baza mbi të cilat anëtari i Bordit të Guvernatorëve, mund të shkarkohet nga Asambleja parlamentare e Bosnje dhe Hercegovinës, me rekomandim të Agjencisë Rregullatore për Komunikime. Këto baza janë: nëse anëtari kërkon vet të shkarkohet, nëse anëtari dështon të marr pjesë tri herë në mbledhje të Bordit dhe nuk arsyeton mospjesëmarrjen, si dhe nëse ai/ajo nuk merr pjesë në punën e Bordit për tre (3) muaj. Gjithashtu, Agjencia Rregullatore e Komunikimeve mund t'i rekomandojë Asamblesë parlamentare shkarkimin e anëtarit të caktuar nëse i njëjti nuk u përmbahet kërkesave të licencës së Sistemit dhe ose/ licencës së Radiotelevizionit të Bosnje dhe Hercegovinës.
79. Ligji përkatës përcakton po ashtu rrethanat që e bëjnë një person të papërshtatshëm për emërim si anëtar të Bordit të Guvernatorëve, e që janë: mbajtja e posteve në struktura legjislative, ekzekutive ose gjyqësore, në cilindo nivel të qeverisë; anëtarësia në parti politike; të qenit i punësuar në televizionet dhe radiot e caktuara publike të Bosnje dhe Hercegovinës; të qenit i punësuar në kompani tjetër që vepron në industrinë e transmetimit radio dhe televiziv, duke përfshirë personat juridikë me të cilët mund të ketë konflikt interesi. Bosnja dhe Hercegovina nuk ka një praktikë gjyqësore për raste të kësaj natyre.

Çekia

80. Në Republikën Çeke, rolin e Bordit të RTK-së siç e ka Republika e Kosovës, e luan Bordi i Televizionit Çek (sipas, Ligjit nr. [No. 483/1991](#), për Televizionin Çek) dhe Bordi i Radios Çeke (Akti nënligjor nr. [No. 484/1991](#), për Radion Çeke). Anëtarët e Bordit të Televizionit dhe Radios së Republikës Çeke, zgjedhën nga Dhoma e Deputetëve e Parlamentit. Këtij të fundit, që të dyja bordet ia paraqesin raportet e tyre vjetore për punën e tyre. Anëtarët e Bordit të Televizionit Çek, shkarkohen sipas dispozitave të nenit 6 të ligjit: (i) nëse ai/ajo nuk i plotëson më kërkesat për kryerjen e detyrave të një anëtari të Bordit të përcaktuara në nenin 5; (ii) nëse ai/ajo ka cenuar rëndë dinjitetin e detyrës së një anëtari tjetër të Bordit ose nëse ai/ajo ka kryer sjellje që vë në pikëpyetje pavarësinë ose paanësinë e tij/saj në kryerjen e detyrave të tij/saj si anëtar/e i/e Bordit; dhe (iii) nëse ai/ajo nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Bordit për më shumë se tre muaj. Anëtarët e të dyja bordeve mund të shkarkohen kolektivisht nga Dhoma e Deputetëve e Parlamentit të Republikës së Çekisë, sipas dispozitave të akteve të tyre përkatëse, nëse bordet në mënyrë të përsëritur dështojnë në përmbushjen e detyrimeve të tyre, sipas ligjit, ose nëse Dhoma e Deputetëve nuk e miraton raportin vjetor mbi aktivitetet e Televizionit Çek ose Radios Çeke, ose raportin vjetor mbi menaxhimin e Televizionit Çek ose Radios Çeke dy herë në një vit rresht. Ligji gjithashtu përcakton shprehimisht kriteret e papërshtatshmërisë, përkatësisht pozitat që një person nuk mund të mbajë për t'u zgjedhur anëtar i Bordit, me qëllim që të sigurohet dhe ruhet pavarësia e Bordit. Gjykata Kushtetuese e Çekisë nuk ka praktikë gjyqësore lidhur me rrethanat e rastit.

Kroacia

81. Në Kroaci, transmetues publik është Radiotelevizioni Kroat (CRT), themeluesi i të cilit është shteti, përkatësisht qeveria. CRT është i pavarur në ushtrimin e aktivitetit të vet nga çfarëdo ndikimi politik apo presioni nga grupet e interesave ekonomike. Ligji përkatës përcakton që CRT duhet të ndjek standardet më të larta profesionale dhe etike të gazetarisë së pavarur.
82. Organet drejtuese të CRT-së janë Drejtori i Përgjithshëm, Bordi drejtues, Bordi mbikëqyrës dhe Këshilli programor. Bordi mbikëqyrës ka pesë (5) anëtarë, katër (4) prej të cilëve emërohen dhe shkarkohen nga Parlamenti kroat, me shumicë votash të të gjithë deputetëve, pas një konkursi të hapur dhe sipas rekomandimit të Komitetit Parlamentar për Informacion, Kompjuterizim dhe Media. Anëtari i pestë emërohet nga radhët e punonjëseve të CRT-së dhe shkarkohet në përputhje me kriteret e përcaktuara me ligj. Anëtarët e Bordit mbikëqyrës mund të shkarkohen para skadimit të mandatit të tyre për arsye të listuara në nenin 22.8 të Ligjit, e që numëron rrethanat kur veprimet e tij/saj shkelin ligjin dhe rregulloret tjera që rregullojnë kryerjen e aktiviteteve të CRT-së, ose nëse ai/ajo në mënyrë të paarsyetur nuk merr pjesë në më shumë se dy seanca radhazi të Bordit mbikëqyrës ose brenda një periudhe njëvjeçare, si dhe nëse sjellja e tij/saj dëmton reputacionin e CRT-së.
83. Sipas legjislacionit kroat, Parlamenti mbikëqyrë ligjshmërinë e veprimeve të Këshillit programor dhe të Bordit mbikëqyrës të CRT-së. Shumica e anëtarëve të bordeve dhe këshillave (organeve kolektive) të lartpërmendura, emërohen dhe mund të shkarkohen nga Parlamenti kroat, përpara përfundimit të mandatit të tyre, përkitazi me një numër të kufizuar bazash, që parashihen në ligjet përkatëse. Dispozitat përkatëse i referohen vetëm shkarkimit individual.
84. Bordi mbikëqyrës është i detyruar të dorëzojë raport vjetor në Parlamentin kroat për punën e tij dhe mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës dhe të funksionimit financiar të CRT-së. Legjislacioni përkatës kroat në fuqi nuk parasheh shprehimisht nëse mosmiratimi i raportit vjetor të transmetuesit publik përbën bazë për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit. Nga ana tjetër, sa i përket aspektit të *"paqftësisë profesionale"* të anëtarit të Bordit ose Këshillit, ekzistojnë disa dispozita me të njëjtin kuptim, sikurse janë cekur më sipër, të cilat flasin vetëm për shkarkime individuale. Kroacia nuk ka praktikë gjyqësore për raste të kësaj natyre.

Lihtenshtajni

85. Sipas komenteve të dorëzuara përmes Forumit, në shtetin e Lihtenshtajnit, transmetuesi publik themelohet me Ligjin për Transmetuesit Publik, mbikëqyrjen e të cilit në përgjithësi e bën Qeveria. Qeveria e Lihtenshtajnit gjithashtu zgjedh kryetarin dhe anëtarët e Bordit të drejtorëve (neni 46 (2) (a) LRFG).
86. Qeveria e Lihtenshtajnit mund t'i shkarkojë në çdo kohë anëtarët e Bordit, pavarësisht mandatit të tyre, për arsye të ndryshme, pasi ta ketë njoftuar Komisionin Parlamentar për Auditim të Bizneseve. Si arsye për shkarkim, ligji përkatës përcakton sidomos rrethanat që e bëjnë të papranueshëm vazhdimin e ushtrimit të detyrës nga anëtari i caktuar i Bordit (neni 8 (1) i Ligjit për Qeverisjen e Ndërmarrjeve Publike). Megjithatë, meqenëse shkarkimi i një anëtarit të nivelit menaxherial të një kompanie publike mund të sjellë prishje të imazhit të personit në fjalë, shkarkimi duhet të bëhet vetëm për arsye të rëndësishme. Meqenëse një listë shteruese me arsye për shkarkim nuk mund të jetë e kompletuar asnjëherë, në Lihtenshtajn është preferuar të ndiqet një arsyetim i përgjithshëm, që përmend kriterin kryesor, se shteti, nga pikëpamja e trupit përzgjedhës, nuk mund të pranojë të mbajë personin në fjalë si anëtar të nivelit

strategjik menaxherial. Si arsye të tjera për shkarkim sipas ligjit përkatës, përmenden gjithashtu: shkeljet e vazhdueshme ose serioze të dispozitave ligjore, dëmtimi serioz i interesit të kompanisë ose të vendit, mospërbushja e kriterëve për emërim dhe paaftësia e përhershme për të ushtruar detyrën. Meqenëse baza për shkarkim sipas ligjit “arsye të rëndësishme” nuk është shteruese, në përgjigjen e pranuar nga shteti i Lihtenshtajnit, mes tjerash, thuhet se bazuar në ligjin e aplikueshëm, “*paafësia profesionale*” dhe “*mosmiratimi i raportit vjetor*” të transmetuesit publik mund të përbëjnë bazë për shkarkimin e anëtarit të Bordit.

87. Kuvendi, bazuar në gjetjet vjetore dhe raportin vjetor, mund t'i paraqesë mocion Komisionit për Media për shkelje të LTP (neni 45 i LRFG). Anëtarët e Bordit mund të shkarkohen vetëm individualisht, megjithëse mund të ndodhë që disa anëtarë të shkarkohen njëkohësisht.
88. Në përbushjen e mandatit të vet, transmetuesi publik në Lihtenshtajn duhet të priret nga parimet e sistemit juridik, sidomos nga parimi i lirisë së shprehjes dhe duhet të sigurojë objektivitet dhe paanshmëri në raportim, duke pasur konsideratë në shumësinë e mendimeve dhe balancimin e programit, si dhe pavarësinë e personave dhe organeve të LTP-së (Neni 5 i LRFG).

Meksika

89. Në Meksikë, Sistemi i Transmetuesve Publikë është entitet publik i ndarë nga Administrata Publike Federale, që gëzon personalitet juridik dhe pasuri. Sipas këtij statusi, Sistemi i Transmetuesve Publikë ka autonomi teknike, operacionale, vendimmarrëse dhe menaxheriale, objektivi parësor i të cilëve është ofrimi i një shërbimi transmetimi jo-fitimprurës.
90. Transmetuesi publik në Meksikë menaxhohet nga Bordi drejtues, i udhëhequr nga Kryetari dhe që përbëhet prej shtatë (7) anëtarësh, tre (3) prej të cilëve i emëron Ekzekutivi dhe tre (3) të tjerë Këshilli qytetar. Përbërja e Bordit sipas Kushtetutës dhe Ligjit Meksikan duhet të marrë parasysh parimin e barazisë gjinore.
91. Sipas Ligjit për Transmetuesit Publikë të Meksikës, anëtarët e Bordit drejtues që përcaktojnë Këshillin qytetar, mund të shkarkohen nëse nuk marrin pjesë në tri (3) seanca të njëpasnjëshme ose gjashtë (6) seanca brenda një periudhe dy (2) vjeçare, nëse shkelin objektivat e transmetuesit publik ose nëse japin dorëheqje vullnetare. Sa i përket tre përfaqësuesve që emërohen nga Ekzekutivi, as Kushtetuta dhe as Ligji i Meksikës nuk përcaktojnë se kush duhet t'i emërojë ata, se cili autoritet mund t'i shkarkojë, e as për cilat arsye. Ligji i Transmetuesve Publikë nuk përmban dispozita specifike, qoftë për shkarkime individuale apo shkarkime kolektive. Megjithatë, neni 26 i Ligjit për Transmetuesit Publikë, parashikon rrethanat në të cilat mund të zëvendësohen tre (3) anëtarë të Këshillit qytetar.

Suedia

92. Në Suedi, janë tre (3) transmetues publikë, një televizion dhe dy radio. Transmetuesit publikë janë të organizuar si kompani me përgjegjësi të kufizuar (aktiebolag), të cilat janë në pronësi të plotë të një fondacioni (Förvaltningsstiftelsen). Secili transmetues menaxhohet nga një Bord i drejtorëve, nga një Drejtor ekzekutiv i emëruar nga Bordi i drejtorëve dhe nga menaxhmenti. Përmes kësaj strukture organizative, synohet të sigurohet pavarësia e transmetuesve publikë, duke vepruar si nivel i ndërmjetëm në mes të transmetuesve publik dhe shtetit. Pavarësia e transmetuesve publikë sigurohet përmes kësaj strukture organizative dhe statusit si kompani me përgjegjësi të kufizuar që janë në pronësi të plotë të fondacionit.

93. Roli i Kuvendit në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e transmetuesve publikë është i kufizuar sipas Ligjit për Radion dhe Televizionin dhe sipas Ligjit për Lirinë e Shprehjes. Licencimin e transmetuesve publikë në Suedi e bën Qeveria, e cila gjithashtu vendos lidhur me kushtet për ndarjen e fondeve që ndërlidhen me menaxhimin ekonomik dhe kontabilitetin. Transmetuesit publikë mbikëqyren nga Komisioni Suedezi i Transmetuesve (Granskningsnämnden), i cili vlerëson dhe shqyrton kushtet nëse transmetuesit publikë përmbushin kriteret për licencim dhe financim. Anëtarët dhe kryetari i Bordit të secilit transmetues publik emërohen nga fondacioni (Förvaltningsstiftelsen), si aksionar i vetëm, me përjashtim të anëtarëve që zgjedhen nga radhët e punëtorëve të transmetuesve publikë. Duke qenë aksionar i vetëm, Fondacioni mund të shkarkojë anëtarët e Bordit të drejtorëve në përputhje me Ligjin përkatës për Kompanitë, pa dhënë arsyetim. Bordet e secilit transmetues i raportojnë fondacionit (Förvaltningsstiftelsen), në mbledhjet e përgjithshme vjetore. Për shkak të mënyrës, se si organizohen dhe menaxhohen transmetuesit publikë në Suedi, Gjykata Supreme Administrative e Suedisë nuk ka ndonjë praktikë gjyqësore në lidhje me natyrën e rastit.

Sllovakia

94. Në Sllovaki, transmetuesit publikë themelohen nga shteti dhe menaxhohen nga Drejtori i përgjithshëm dhe Bordi mbikëqyrës prej nëntë (9) anëtarësh, të cilët zgjedhen nga Parlamenti Sllovak me shumicë të thjeshtë të votave.
95. Ligji për Transmetuesit Publikë i Sllovakisë përcakton saktësisht kriteret të ndryshme në rastin e shkarkimit individual të një anëtari të Bordit dhe të Bordit si tërësi (neni 12, paragrafi 1, pika c) dhe d)). Anëtari i Bordit mund të shkarkohet individualisht nga Parlamenti Sllovak për shkak të papajtueshmërisë me funksionin, për shkak të dënimit penal, humbjes së aftësisë juridike ose mos ushtrimit të detyrave për së paku tre (3) muaj (neni 12, paragrafi 2). Ndërsa, shkarkimi i Bordit si trup, sipas LTP bëhet në dy raste, i pari: (i) kur Parlamenti Sllovak miraton dy (2) rezoluta brenda gjashtë (6) muajve, me të cilat shprehet se Bordi nuk është duke i ushtruar detyrat sipas ligjit; dhe (ii) kur Bordi refuzon tri (3) herë radhazi të miratojë projektbuxhetin për transmetuesin publik të prezantuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe ka iniciuar para komitetit përkatës parlamentar shkarkimin e Drejtorit, mirëpo Parlamenti ka vendosur që të mos e shkarkojë atë. Ligji përkatës përcakton saktësisht bazat për shkarkimin e Drejtorit të përgjithshëm, ndërsa paaftësia profesionale nuk parashihet shprehimisht me ligj. Megjithatë, disa nga bazat që ligji parasheh për shkarkimin e Drejtorit të përgjithshëm, lënë të nënkuptohet se “paaftësia profesionale” mund të jetë bazë për shkarkim. Nuk ka ndonjë praktikë gjyqësore në lidhje me natyrën e rastit.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

- 1. Republika e Kosovës është shoqëri shumëetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.*
- 2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.*

Neni 4
[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
[...]
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
[...]
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.

Neni 7
[Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.
[...]

Neni 40
[Liria e Shprehjes]

1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.
2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësisë në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Neni 42
[Liria e Medieve]

1. Garantohej liria dhe pluralizmi i medieve.
2. Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësisë në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.
3. Çdokush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.

Neni 63
[Parimet e Përgjithshme]

Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli

Neni 65
[Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:
[...]

- 9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;

LIGJI NR. 04/L-046 PËR RADIOTELEVIZIONIN E KOSOVËS

Neni 3 Radiotelevizioni i Kosovës

1. Radiotelevizioni i Kosovës (në tekstin e mëtejme RTK) është transmetues publik i Kosovës.
2. RTK është person juridik jo profitabil me status të institucionit të pavarur publik me rëndësi të posaçme i cili ofron shërbim publikut në fushën e veprimtarisë mediale, të përcaktuar me këtë ligj dhe aktet tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore.
3. RTK ka mision informues, edukues, kulturor dhe argëtues.

Neni 4 Themeluesi i Radiotelevizionit të Kosovës

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës është themelues i Radiotelevizionit të Kosovës.
2. Kuvendi mbron autonominë institucionale dhe siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-së të përcaktuar me këtë ligj.

Neni 24 Organet drejtuese dhe të udhëheqjes të RTK-së

1. Organet drejtuese dhe udhëheqëse të RTK-së janë:
 - 1.1. Bordi i RTK-së;
 - 1.2. Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 25 Përbërja e Bordit

1. Bordi i RTK-së është organ kolegjal-drejtues i RTK-së.
2. Bordi i RTK-së përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë.
3. Anëtarët e bordit të RTK-së janë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, kinematografia, gazetaria, drejtësia, biznesi dhe menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, universiteti, media dhe teknikës.
4. Anëtarët e bordit duhet të jenë individë me kredibilitet dhe autoritet të lartë njerëzor, profesional dhe moral. Gjatë punës së tyre, anëtarët e bordit duhet të jenë plotësisht të përkushtuar, objektiv dhe të paanshëm.
5. Anëtarët e Bordit emërohen dhe veprojnë në kapacitetin e tyre personal dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes jashtë RTK-së përveç interesit të publikut. Ata nuk lejohet të kërkojnë apo pranojnë asnjë instruksion në lidhje me aktivitetet e Bordit nga asnjë interes jashtë RTK-së.
6. Përbërja e Bordit të RTK-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku dy (2) anëtarë të Bordit të RTK-së emërohen nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar emërohet nga komunitetet tjera jo shumicë dhe së paku dy (2) anëtarë të jenë të gjinisë femërore. Të paktën dy (2) anëtarë të Bordit do të kenë kualifikime profesionale në fushën e financimit, menaxhimit biznesor dhe të drejtësisë.
7. Anëtarët e Bordit duhet t'i përmbahen ligjit të aplikueshëm në Kosovë dhe e kanë të ndaluar që të kërkojnë dhe pranojnë udhëzime gjatë përmbushjes së detyrave të tyre prej cilitdo autoritet tjetër. 8. Anëtarëve të Bordit u ndalohet keqpërdorimi i pozitës së tyre për përfitim personal apo të familjes së tij të ngushtë, të ndonjë pale tjetër apo entiteti.

Neni 26

Zgjedhja e anëtarëve të Bordit

1. Anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente.
2. Kandidatët për Bordin të RTK-së propozohen sipas procedurave të mëposhtme:
 - 2.1. brenda nëntëdhjetë (90) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të Bordit apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, RTK bënë shpallje publike brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj.
 - 2.2. pesë (5) ditë pas mbylljes së shpalljes publike, të gjitha aplikacionet RTK ia dorëzon Kuvendit të Kosovës i cili themelon Komisionin ad – hoc për shqyrtimin e tyre.
 - 2.3. brenda periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo pozitë në Bord, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, integritetit dhe përkushtimit të tyre për zhvillimin dhe përparimin e RTK-së.
 - 2.4. bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit, Kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.
3. Mandati i anëtarëve të Bordit do të jetë si në vijim: Katër (4) anëtarë të Bordit të RTK-së do të emërohen me mandat dy (2) vjeçar, katër (4) anëtarë me mandat tre (3) vjeçar dhe tre (3) anëtarë me mandat katër (4) vjeçar, dhe përcaktimi i kohëzgjatjes së mandatit nga secili grup do të bëhet me short.
4. Mandati i kryetarit dhe nënkryetarit të Bordit të RTK-së është dy (2) vite, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.
5. Anëtarët e Bordit, mund të ri-emërohen vetëm edhe për një mandat tjetër tre (3) vjeçar.

Neni 28

Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit

1. Shkarkimi i anëtarit nga Bordi i RTK-së bëhet kur vërtetohet se ka ndonjë bazë për largim që parashihet me nënparagrafët 3.3, 3.4 dhe 3.5 të paragrafit 3. të këtij neni dhe që mund të zbatohet për anëtarin.
2. Shkarkimi i një anëtari nga Bordi do të bëhet sipas procedurës në vijim:
 - 2.1. propozimi për shkarkim vije nga Bordi i RTK-së me kërkesën e shumicës së thjeshtë të numrit të anëtarëve të Bordit ose të ndonjë iniciative tjetër nga jashtë sipas kushteve të përcaktuara nga paragrafi 3 i këtij neni.
 - 2.2. Kuvendi i Kosovës me shumicë të thjeshtë do të vendosë për shkarkimin ose jo të anëtarit të Bordit.
3. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit mund të bëhet sipas këtyre kushteve:
 - 3.1. paaftësisë profesionale - nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t'i përmbushë detyrat e anëtarit të Bordit;
 - 3.2. paaftësisë mentale apo fizike për të kryer detyrat e anëtarit;
 - 3.3. nëse anëtari nuk i përmbush kushtet sipas nenit 26 të këtij ligji;
 - 3.4. ka dështuar në realizimin e detyrave të tij/saj për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se tre (3) muajve pa aprovim nga Bordi;
 - 3.5. nëse anëtari është dënues për vepër penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg;
 - 3.6. nëse anëtari nuk i përmbush kushtet sipas nën-paragrafëve 1.3, 1.4 dhe 1.5 të paragrafit 1. të nenit 27 të këtij ligji.
 - 3.7. mungesës në punë mbi një (1) muaj pa arsye;
 - 3.8. ka marrë pjesë aktive në aktivitete politike pasi që është emëruar si anëtar i Bordit.

4. Anëtarët e Bordit mund të japin dorëheqje duke njoftuar me shkrim Bordin të paktën tre (3) muaj përpara.

Neni 29

Kompetencat e Bordit të RTK-së

1. Bordi i RTK-së, punon dhe vepron në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të statutit të RTK-së.

2. Kompetencat e Bordit të RTK-së janë:

- 2.1. e aprovon statutin e RTK-së;
- 2.2. e aprovon rregulloren e punës së bordit si dhe rregulloret tjera të përcaktuara me statut;
- 2.3. shqyrton dhe miraton programet, bazat dhe standardet programore në përputhje me politikën programore, ligjin dhe standardet ndërkombëtare të informimit publik sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm;
- 2.4. shqyrton dhe miraton projekt-programin e produksionit të RTK-së i cili duhet të jetë në përputhje me mundësitë financiare të RTK-së;
- 2.5. shqyrton dhe miraton skemën e përgjithshme programore;
- 2.6. Emëron dhe shkarkon, Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së,
- 2.7. emëron dhe shkarkon zëvendës drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e Radiove dhe Televizioneve dhe udhëheqësin e shërbimeve të përbashkëta me shumicë të thjeshtë votash, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm;
- 2.8. miraton strukturën organizative dhe konceptin programor të RTK-së;
- 2.9. e shqyrton dhe e miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe të personelit tjetër dhe siguron që shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare. Buxheti i RTK-së, është dokument publik i cili pas shqyrtimit në bord i adresohet themeluesit për shqyrtim dhe miratim;
- 2.10. shqyrton dhe publikon më së largu deri më 31 mars të çdo viti raportin financiar vjetor të të hyrave dhe të shpenzimeve për vitin paraprak të përgatitur nga menaxhmenti i RTK-së i cili i nënshtrohet një auditimi të jashtëm të pavarur. Raporti në fjalë më pas i dërgohet Themeluesit për trajtim dhe veprim;
- 2.11. miraton plan programin vjetor, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, në përputhshmëri me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe mandatin e RTK-së siç është përcaktuar me këtë ligj;
- 2.12. miraton kodin e mirësjelljes për RTK-në dhe siguron zbatimin efektiv të saj;
- 2.13. mbikëqyrë paanshmërinë, objektivitetin dhe saktësinë e informacionit në programin e RTK-së;
- 2.14. miraton kriteret kryesore profesionale për punësimin e personelit, politikave dhe procedurave të vlerësimit të përmbushjes së detyrave;
- 2.15. siguron që janë ndërmarrë masat korrigjuese pas konstatimit nga ana e tij ose KPM-së se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme;
- 2.16. vendos edhe për çështje të tjera të rëndësishme në përputhje me autorizimet dhe kompetencat që ka me ligj dhe statut.

Neni 37

Mbikëqyrja e funksionimit të RTK-së

1. Mbikëqyrja e veprimtarisë së RTK-së kryhet nga organet e autorizuar për një gjë të tillë nga ligji dhe Statuti.

2. Një trup i auditorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e rregullsisë dhe përputhshmërisë së veprimeve dhe auditimin e akteve për veprimet dhe akteve për

veprimet e planifikuara të RTK-së në kuadër të kornizës së kompetencave që i ushtron mbi subjektet që kryejnë veprimtari publike.

3. Përveç personave të autorizuar për të kërkuar përgjegjësi në emër të anëtarëve të organeve menaxhuese dhe mbikëqyrëse të përcaktuara nga ligji, Kuvendi i Kosovës gjithashtu është i autorizuar të kërkojë një përgjegjësi të tillë.

4. Bordi i RTK-së e merr një raport auditimi nga një ekspert i pavarur i auditimit për çdo vit deri më 1 qershor. Ekspert i auditimit nuk mund të jetë një person i cili, gjatë dy (2) viteve para marrjes së detyrës nga Drejtori i Përgjithshëm ose nga Bordi i RTK-së, ka bashkëpunuar në gfarëdo mënyrë në cilësi komerciale me RTK-në ose me subjektet e lidhura me të. RTK-ja dhe subjektet e lidhura me të nuk mund të bashkëpunojnë në cilësi komerciale me ekspertin e përzgjedhur të auditimit për dy (2) vite pas dorëzimit të raportit të auditimit.

Neni 38

Karakteristikë publike e veprimtarisë

1. Veprimtaria e RTK-së do të jetë publike. Raporti vjetor duhet të publikohet në mënyrën e përcaktuar me Statut. Raporti vjetor duhet të përmbajë një ndarje të shpenzimeve të ofrimit të shërbimeve, përmbajtjes ose kanaleve nga grupet individuale apo përmbajtjes programore dhe të raportit të Bordit të RTK-së.

2. Raporti vjetor duhet të publikohet në faqen e internetit të RTK-së. 3. RTK-ja, një herë në vit, organizon një debat publik mbi përmbajtjen e raportit vjetor dhe përpilon një raport mbi debatin, i cili do t'ia dorëzojë Bordit të RTK-së. 4. RTK do t'ia dërgojë raportin vjetor, raportin mbi debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së në raportin e debatit publik për qëllime orientuese, Kuvendit të Republikës së Kosovës.

RREGULLORE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS **(miratuar më 29 prill 2010; në fuqi deri më 9 gusht 2022)**

Neni 72

Procedurat e veçanta për raportet e organeve të pavarura

1. Raportin vjetor të punës së organit të pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi, e shqyrton komisioni funksional, që e mbulon fushën e përgjegjësisë së organit të pavarur.
2. Komisioni duhet ta shqyrtojë raportin vjetor të organit të pavarur dhe t'i paraqesë Kuvendit raport me rekomandime brenda tri javë pune, nga data që e ka marrë.
3. Shqyrtimi i raportit vjetor në mbledhjen e Kuvendit fillon me paraqitjen e raportit nga raportuesi i komisionit funksional. Pas paraqitjes së raportit, të drejtë për të diskutuar, sipas radhës, kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe deputetët, ndërsa përmbillet me votimin për miratim.
4. Përgjithësisht nga pika 3 e këtij neni, me kërkesën e Kuvendit, në mbledhje mund t'i jepet fjala edhe përgjegjësit të organit të pavarur.

SHTOJCA: 10. Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, është komision funksional. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësisë, i shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me funksionimin e shërbimeve civile, të administratës lokale dhe të mediave.

Fushëveprimi i këtij Komisioni përfshin:

[...]

- Shqyrtimin e listës së anëtarëve për Komisionin e Pavarur për Media dhe për Bordin e Mediave Publike;

[...]

Për ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni bashkëpunon me Ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministratë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohej nga Komisioni.

Parimet dhe standardet relevante që burojnë nga Rekomandimet dhe aktet e Asamblesë Parlamentare dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, Opinionet e Komisionit të Venecias dhe raporteve e akteve të organizatave profesionale ndërkombëtare

96. Gjykata më poshtë do të paraqesë pjesë të shkëputura, relevante për rrethanat e rastit konkret, nga instrumentet e ligjit të butë të Asamblesë Parlamentare dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, Opinionet e Komisionit të Venecias dhe raporteve e akteve të organizatave profesionale ndërkombëtare. Gjykata do të paraqesë si vijon: (i) Rekomandimi nr. R (96) 10 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Garantimin e pavarësisë së transmetuesve publikë, Shtojca dhe Memorandumi shpjegues i tij; (ii) Deklarata e Komitetit të Ministrave mbi Garantimin e pavarësisë së transmetuesve publikë në Shtetet Anëtare; (iii) Rekomandimi CM/Rec (2012) 1 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Qeverisjen e shërbimeve të mediave publike; (iv) Rezoluta e Asamblesë Parlamentare 1636 (2008): Indikatorët për median në një demokraci (miratuar nga Asambleja Parlamentare më 3 tetor 2008); (v) Opinioni i Komisionit të Venecias CDL-AD(2005)017 mbi Përputhshmërinë e ligjeve “Gasparri” dhe “Frattini” të Italisë me standardet e Komisionit të Venecias në fushën e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit të medias; (vi) Opinioni i Komisionit të Venecias CDL-AD (2015)015 mbi Legjislacionin për media të Hungarisë; (vii) Raporti i Unionit Evropian të Transmetuesve “Shërbimi i medias publike sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”; (viii) Raporti i Unionit Evropian të Transmetuesve “Fokusi juridik: Parimet e qeverisjes së shërbimit publik të medias”; dhe (ix) Raporti IRIS Plus i Observatorit Audiovizual Evropian “Qeverisja dhe pavarësia e shërbimit publik të medias”.

- (i) *Rekomandimi nr. R (96) 10 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Garantimin e Pavarësisë së Transmetuesve Publikë, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 shtator 1996, Shtojca dhe Memorandumi shpjegues i tij*

“Rregullat që rregullojnë statusin e bordeve të menaxhimit të organizatave të shërbimit publik të transmetimit, veçanërisht anëtarësinë e tyre, duhet të përcaktohen në një mënyrë që të shmangin vendosjen e bordeve në rrezik nga çdo ndërhyrje politike ose ndërhyrje tjetër. Këto rregulla duhet, në veçanti, të përcaktojnë që anëtarët e bordeve drejtuese ose personat që marrin këto funksione në cilësi individuale: ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë rigorozë në interes të organizatës së shërbimit publik të transmetimit që ata përfaqësojnë dhe menaxhojnë; nuk munden, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, të ushtrojnë funksione, të marrin pagesë ose të mbajnë interesa në ndërmarrje ose organizata të tjera në media ose sektorë të lidhur me media, kur kjo do të çonte në konflikt të interesit me funksionet drejtuese që ata ushtrojnë në organizatën e tyre të shërbimit publik të transmetimit; të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë rigorozë në interes të organizatës së shërbimit publik të transmetimit që përfaqësojnë dhe menaxhojnë; nuk munden, direkt ose indirekt, të ushtrojnë funksione, të marrin pagesa ose të kenë interesa në ndërmarrje ose organizata të tjera në media ose sektorë të lidhur me median, kur kjo do të çonte në konflikt interesi me funksionet drejtuese që ata ushtrojnë në organizatën e tyre të transmetimit publik”. (Shtojca e Rekomandimit nr. R (96) 10 – Udhëzuesi mbi garancitë për pavarësinë e transmetuesve publikë, II. Bordet menaxhuese të organizatave të transmetuesve publikë, 2. Statusi, fq. 51).

“Rregullat që rregullojnë statusin e organeve mbikëqyrëse të organizatave të shërbimit publik të transmetimit, veçanërisht anëtarësinë e tyre, duhet të përcaktohen në një mënyrë që të shmangin vendosjen e organeve në rrezik nga ndërhyrjet politike ose të tjera. Këto rregulla duhet, në veçanti, të garantojnë që anëtarët e organeve mbikëqyrëse: të emërohen në mënyrë të hapur dhe pluraliste; të përfaqësojnë kolektivisht interesat e shoqërisë në përgjithësi; nuk mund të marrin asnjë mandat ose udhëzime nga asnjë person ose organ tjetër përveç atij që i ka emëruar, duke iu nënshtruar çdo dispozite të kundërt të përcaktuar me ligj në raste të jashtëzakonshme; nuk mund të shkarkohen, pezullohen ose zëvendësohen gjatë mandatit të tyre nga asnjë person ose organ i ndryshëm nga ai që i ka emëruar, përveç rasteve kur organi mbikëqyrës ka vërtetuar në mënyrë të rregullt se ata janë të paaftë ose janë penguar të ushtrorjnë funksionet e tyre; nuk mundën, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, të ushtrorjnë funksione, të marrin pagesa ose të mbajnë interesa në ndërmarrje ose organizata të tjera në media ose sektorë të lidhur me media, kur kjo do të çonte në konflikt interesi me funksionet e tyre brenda organit mbikëqyrës”. (Shtojca e Rekomandimit nr. R (96) 10 – Udhëzuesi mbi garancitë për pavarësinë e transmetuesve publikë, III. Trupat mbikëqyrës të organizatave të transmetuesve publikë, 2. Statusi, fq. 52).

“Siç u përmend më parë, pavarësia redaksionale dhe autonomia administrative e organizatave të shërbimit publik të transmetimit nuk do të thotë se këto organizata nuk duhet të përgjigjen për mënyrën se si i përmbushin misionet e tyre dhe si përdorin burimet që mund t’iu ndahen nga komuniteti për këtë qëllim. Kështu, bordet drejtuese të organizatave të shërbimit publik të transmetimit, të cilat sipas udhëzimit nr. 4 duhet të jenë vetëm përgjegjëse për funksionimin e përditshëm të këtyre organizatave, të jenë përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të tyre para organeve të tyre mbikëqyrëse, siç parashikohen me Udhëzimin nr. 7” (Udhëzimi nr. 2, Memorandumi shpjegues i Rekomandimit nr. R (96) 10 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Garantimin e Pavarësisë së Transmetuesve Publikë).

“Organet mbikëqyrëse të shërbimit publik të transmetimit mund të ndryshojnë për nga natyra e tyre, qofshin të jashtme (komisionet parlamentare, agjencitë rregulluese të sektorit të transmetimit), të brendshme (bordet mbikëqyrëse të organizatave të shërbimit publik të transmetimit, etj.) ose një kombinim i të dyjave. Përbërja aktuale e organeve mbikëqyrëse duhet të përcaktohet në mënyrë që të shmanget që ato t’i nënshtrohen ndonjë ndërhyrjeje politike apo ndërhyrjeje tjetër. Në lidhje me këtë i është kushtuar vëmendje përcaktimit në Rezolutën për të ardhmen e transmetimit publik të miratuar në Konferencën Ministrorë të Pragës: “pavarësia e transmetuesve të shërbimit publik duhet të garantohet nga struktura të përshtatshme si bordet e brendshme pluraliste ose organe të tjera të pavarura”. (Udhëzimi nr. 11, Memorandumi shpjegues i Rekomandimi nr. R (96) 10 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Garantimin e Pavarësisë së Transmetuesve Publikë).

(ii) *Deklarata e Komitetit të Ministrave mbi garantimin e pavarësisë së transmetuesve publikë në Shtetet Anëtare, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 27 shtator 2006*

“4. Sipas Rekomandimit nr. R (96) 10, korniza ligjore që rregullon organizatat e shërbimit publik të transmetimit duhet të përcaktojë qartë pavarësinë e tyre. (...)” (paragrafi 4).

“6. (...) Me raste, dispozitat në lidhje me organet qeverisëse ose mbikëqyrëse (si, për shembull, në lidhje me përzgjedhjen, emërimin dhe përfundimin e emërimit të anëtarëve) sjellin një rrezik të ndërhyrjes.. (...)” (paragrafi 6).

“24. Për shkak të vetë natyrës së tij, shërbimi publik i transmetimit duhet t’i përgjigjet shoqërisë në përgjithësi, sepse ekziston për t’i shërbyer publikut në përgjithësi, dhe

sepse, në shumicën e rasteve, financohet të paktën pjesërisht nga burimet publike (për shembull, kontributet shtetërore). ose nga tarifat e transmetimit, të paguara nga përfituesit e synuar të shërbimit. Sipas Rezolutës nr. 1 të miratuar në Konferencën e 4-të Ministrove Evropiane për Masmedian dhe Politika, "transmetuesit e shërbimit publik duhet të jenë drejtpërdrejt përgjegjës ndaj publikut. Për këtë qëllim, transmetuesit e shërbimit publik duhet të publikojnë rregullisht aktivitetet e tyre dhe të zhvillojnë procedura për t'u mundësuar shikuesve dhe dëgjuesve të komentojnë mënyrën në të cilën ata e kryejnë misionin e tyre. Vetëkuptohet që llogaridhënia është gjithashtu e dëshirueshme për sa i përket menaxhimit të shëndoshë të burimeve në dispozicion të organizatave të shërbimit publik të transmetimit." (paragrafi 24).

"25. (...) Shumë transmetues të shërbimit publik publikojnë informata përkatëse në baza të rregullta, disa i nënshtrohen detyrimeve ligjore për të publikuar raporte vjetore ose për t'i dorëzuar raporte të tilla parlamentit. Kjo mundëson një shqyrtim të dëshirueshëm publik." (paragrafi 25).

(iii) Rekomandimi CM/Rec (2012) 1 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Qeverisjen e shërbimeve të mediave publike, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 15 shkurt 2012

"2. Prioriteti i parë për mediat e shërbimit publik duhet të jetë siguri që kultura, politikat, proceset dhe programet e tyre të reflektojnë dhe sigurojnë pavarësinë redaksionale dhe operacionale. (...) 4. Megjithatë, edhe në vendet me sisteme më të zhvilluara dhe më të rrënjësura të shërbimit publik të transmetimit, marrëdhënia ndërmjet medias së shërbimit publik dhe qeverisë, e cila përcakton përgjegjësinë e tyre të përgjithshme dhe siguron financimin e tyre, është një marrëdhënie që ka nevojë për vigjilencë të vazhdueshme. Ndryshimet e fundit në disa shtete anëtare në marrëveshjet e financimit ose vendimet për të përdorur tarifën e licencës për financimin e shërbimeve të ofruara nga mediat komerciale kanë përqendruar edhe një herë vëmendjen në marrëdhëniet midis mediave të shërbimit publik dhe Shtetit." (paragrafi 2, 4).

"14. Përkufizimet tradicionale të qeverisjes janë të pamjaftueshme për të marrë parasysh plotësisht mjedisin e ri dhe më kompleks mediatik. Përkufizimet e ngushta zakonisht fokusohen në hapat e saktë ligjor dhe administrativ të ndërmarrë për të siguruar përbërjen e duhur të bordeve dhe strukturave drejtuese. Ato priren të përqendrohen në detajet e procedurave të emërimit, afatet e mandatit dhe arsyet e lejueshme për shkarkim, konflikte të interesit dhe metodat me të cilat organizata do të mbahet përgjegjëse. Ndërsa këto çështje janë të gjitha të një rëndësie themelore në një sistem qeverisjeje të duhur dhe mirë-funksionale, ato duhet të vendosen në një kontekst më të gjerë." (paragrafi 14).

"17. Propozohet një grup i ndërlidhur kriteresh që organizatat e mediave të shërbimit publik mund të përdorin për të vlerësuar sistemin e tyre të qeverisjes në parimet udhëzuese aktuale. Kriteret janë krijuar për të funksionuar në çdo nivel brenda organizatës: ato lidhen me nivelin më të lartë të vendimmarrjes të organizatës mediatike, por gjithashtu lidhen drejtpërdrejt me strukturat, proceset dhe sjelljet që veprojnë në tërë organizatën. Ato lidhen respektivisht me parimet e pavarësisë, llogaridhënies, menaxhimit efektiv, transparencës dhe hapjes, si dhe përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë." (paragrafi 17).

"18. Modeli funksionon në tri nivele: A. Niveli i parë ka të bëjë me strukturat dhe proceset formale që, ndërmjet tyre, përbëjnë tiparet thelbësore të kuadrit të qeverisjes: (a) hapat e ndërmarrë për të siguruar pavarësinë - qëllimi kryesor i çdo kornize të qeverisjes së medias së shërbimit publik, pasi pa pavarësi, media e shërbimit publik nuk mund të garantohet të funksionojë në mënyrë efektive ose të ofrojë kundër grupit të gjerë të qëllimeve të saj publike dhe të ruajë fokusin e saj thjesht për t'i shërbyer

interesit publik; (b) korniza e llogaridhënies – mënyra në të cilën një organizatë mediatike e shërbimit publik identifikon palët e saj të interesuara dhe mekanizmat përmes të cilëve kërkohet llogari, dhe që siguron që pavarësia e organizatës të fokusohet në plotësimin e nevojave të palëve të saj të interesuara. Këto dy aspekte të organizatës balancojnë në mënyrë efektive njëra-tjetrën: pavarësia e dhënë medias së shërbimit publik për t'i mbrojtur ato nga ndikimi i panevojshëm nga shteti ose nga ndonjë palë tjetër, balancohet nga detyrimi i organizatave të medias së shërbimit publik për të qenë plotësisht përgjegjës ndaj shtetit dhe ndaj aktorëve të shumtë të saj.” (paragrafi 18).

“21. Pavarësia është kërkesa thelbësore për çdo organizatë mediatike të shërbimit publik. Pa pavarësinë e dukshme të veprimit dhe iniciativës, nga qeveria, si dhe nga çdo interes apo institucion tjetër, organizatat e mediave të shërbimit publik nuk mund të ruajnë besueshmërinë e tyre dhe do të humbasin (ose kurrë nuk do të fitojnë) mbështetjen popullore si një forum për të çuar përpara debatin dhe zhvillimin kombëtar dhe të mbajnë fuqinë për llogari.” (paragrafi 21).

“22. Sigurimi dhe ruajtja e pavarësisë është pra një rol parësor i çdo kornize të qeverisjes së medias së shërbimit publik, dhe kjo është arsyeja pse pavarësia ka qenë në qendër të të gjitha standardeve përkatëse të Këshillit të Evropës.” (paragrafi 22)

“27. Si institucione publike, është legjitime që Shteti të përfshihet në emërimin e autoritetit më të lartë mbikëqyrës ose vendimmarrës brenda medias së shërbimit publik. Për të shmangur dyshimin, kjo përfshirje normalisht nuk duhet të shtrihet në emërimet në nivel drejtues ekzekutiv ose editorial. Për më tepër, çdo proces i tillë i emërimit duhet të hartohet në mënyrë që: të ketë kritere të qarta për emërimet që janë të kufizuara dhe të lidhura drejtpërdrejt me rolin dhe përgjegjësinë e medias së shërbimit publik; emërimet nuk mund të përdoren për të ushtruar ndikim politik ose ndikim tjetër mbi funksionimin e mediave të shërbimit publik; emërimet bëhen për një mandat të caktuar që mund të shkurtohet vetëm në rrethana të kufizuara dhe të përcaktuara ligjërisht – të cilat nuk duhet të përfshijnë dallime mbi pozicionet ose vendimet redaksionale; në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, përfaqësimi i burrave dhe grave në organet vendimmarrëse duhet të jetë i balancuar.” (paragrafi 27).

“28. Mediat e shërbimit publik në fund të fundit, dhe në thelb, janë përgjegjëse ndaj publikut. Megjithatë, publiku përbëhet nga një gamë gjithnjë e më komplekse aktorësh institucionale dhe të tjerë: publiku i përfaqësuar nga Shteti – nëpërmjet qeverisë dhe parlamentit, si dhe organeve të tjera të pavarura rregullatore dhe mbikëqyrëse; publiku drejtpërdrejt si audiencë dhe si qytetarë dhe pjesëmarrës; publiku i përfaqësuar nga grupet e shoqërisë civile si dhe nga komunitetet më të gjera të interesit.” (paragrafi 28).

(iv) Rezoluta e Asamblesë Parlamentare 1636 (2008): Indikatorët për median në një demokraci, miratuar nga Asambleja Parlamentare më 3 tetor 2008

“3. Këshilli i Evropës ka vendosur standarde për Evropën në lidhje me lirinë e medias përmes nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ETS Nr. 5) dhe një sërë rekomandimesh përkatëse nga Komiteti i Ministrave, si dhe rezolutat dhe rekomandimet e Asamblesë Parlamentare.” (paragrafi 3).

“7. Kuvendi e konsideron të nevojshme që në një shoqëri demokratike të respektohen një sërë parimesh në lidhje me lirinë e medias. Një listë e parimeve të tilla do të lehtësonte analizat e mjediseve të mediave kombëtare në lidhje me lirinë e mediave, të cilat mund të identifikonin çështjet problematike dhe mangësitë e mundshme. Kjo do t'u mundësojë shteteve anëtare të diskutojnë, në nivel evropian, veprimet e mundshme

për të adresuar këto probleme. 8. Asambleja fton parlamentet kombëtare që të analizojnë rregullisht situatën e tyre mediatike në një mënyrë objektive dhe të krahasueshme, në mënyrë që të jenë në gjendje të identifikojnë mangësitë në legjislacionin dhe praktikën e tyre kombëtare të mediave dhe të marrin masat e duhura për t'i korrigjuar ato. Analiza të tilla duhet të bazohen në listën e mëposhtme të parimeve bazë: (...) 8.20. transmetuesit e shërbimit publik duhet të mbrohen nga ndërhyrjet politike në menaxhimin e tyre të përditshëm dhe në punën e tyre redaksionale. Pozicionet e larta drejtuese duhet t'u refuzohen njerëzve me përkatësi të qarta politike partiake; (...). (paragrafi 7, 8).

(v) Opinioni i Komisionit të Venecias CDL-AD(2005)017 mbi Përputhshmërinë e ligjeve "Gasparri" dhe "Frattini" të Italisë me standardet e Komisionit të Venecias në fushën e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit të medias, publikuar më 13 qershor 2005

"52. Transmetimi publik është një shërbim publik. Transmetuesit publikë kanë detyrime që variojnë nga ofrimi i një shërbimi universal, te një formë e përfaqësimit social, tek ofrimi i një game të gjerë programesh cilësore 31. Në këmbim, ata gëzojnë një qasje të privilegjuar në burime dhe objekte." (paragrafi 52).

"53. Prandaj, shërbimi publik i transmetimit pritet t'i shërbejë interesit publik, të kujdeset për tërë popullsinë në baza universale dhe jofitimprurëse; është detyrë publike dhe duhet t'i shërbejë nevojave demokratike të shoqërive bashkëkohore." (paragrafi 53).

"54. Transmetimi publik duhet të jetë i lirë nga forcat shtrënguese të shtetit dhe, nga ana tjetër, të gëzojë autonomi dhe pavarësi nga tregu. Detyra e tij specifike është në thelb të veprorë në mënyrë të pavarur nga ata që mbajnë pushtetin ekonomik dhe politik. (...)" (paragrafi 54).

"151. Në këtë drejtim, Komisioni dëshiron të theksojë se një rol mbikëqyrës i parlamentit në transmetuesin kombëtar është sigurisht i pranueshëm dhe i pajtueshëm me funksionet demokratike të parlamentit. Shpesh pasqyron kulturën politike që mbizotëron në shtetet në fjalë." (paragrafi 51).

"153. Megjithatë, ky rol parlamentar duhet të ketë të bëjë kryesisht me vendosjen e udhëzimeve dhe zgjidhjen e problemeve të caktuara të opinionit publik dhe nuk duhet të shtrihet për të ndërhyrë në punën redaksionale të transmetuesit apo edhe me emërimin dhe shkarkimin e gazetarëve." (paragrafi 153).

(vi) Opinioni i Komisionit të Venecias CDL-AD(2015)015 mbi Legjislacionin për media të Hungarisë (publikuar më 22 qershor 2015)

"80. Komisioni i Venecias thekson se kërkesa e pavarësisë, e cila është e zbatueshme për organet rregullatore të mediave në përgjithësi, vlen edhe për organet që mbikëqyrin sektorin publik të medias. Kështu, Shtojca e Rekomandimit të Komitetit të Ministrave Nr. R(96)10 rekomandon që anëtarët e organeve mbikëqyrëse të PSM të emërohen në mënyrë të hapur dhe pluraliste dhe të përfaqësojnë kolektivisht interesat e shoqërisë në përgjithësi." (paragrafi 80).

"81. Pavarësia e transmetuesve publikë është ngritur në statusin e një parimi të ligjit evropian për të drejtat e njeriut . (...)" (paragrafi 81).

"82. Në të vërtetë, gjetjet e Gjykatës duhet të lexohen në dritën e rrethanave të veçanta të rastit [Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë] Në atë rast nuk ishte detyra e Gjykatës të propozonte një model abstrakt që do të garantonte pavarësinë e një organi që

mbikëqyr një kompani kryesore televizive publike. Megjithatë, është e qartë se kur një shumicë dërrmuese e anëtarëve të këtij organi zgjidhet nga partia në pushtet, ky organ nuk mund të konsiderohet i pavarur. Në këtë rast, gazetarët e TRM-së, një stacion kryesor televiziv publik, u ankuan për censurën e fshehtë të ushtruar nga menaxhmenti i sapoemëruar i bindur ndaj shumicës qeverisëse. Prandaj, mungesa e pavarësisë së një organi mbikëqyrës do të çonte në shkeljen e nenit 10 të Konventës jo si i tillë, por vetëm kur rezultonte në një ndërhyrje specifike në lirinë e gazetarisë – siç është për shembull censura. (paragrafi 82, fusnota 66).

(vii) Raporti i Unionit Evropian të Transmetuesve “Shërbimi i medias publike sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, publikuar në dhjetor 2013

“Ekzistenca e transmetuesve publikë përfiton nga mbrojtja nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Kjo mbrojtje është pasojë e vendimit të qëllimshëm të një shteti për të krijuar një sistem transmetimi publik. Lloji i mbrojtjes dhe shtrirja e saj ndikohen nga standardet që janë zhvilluar nga Këshilli i Evropës dhe BE-ja në lidhje me rolin dhe kontributin thelbësor të transmetimit publik brenda një shoqërie demokratike. Ky kontribut përfshin të gjitha detyrat përmes të cilave një transmetues publik u shërben nevojave demokratike, sociale dhe kulturore të një shoqërie demokratike. (...) Për shkak të natyrës së tij subsidiare, sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut i KEDNj-së nuk synon të përshkruajë një model të caktuar se si duhet të organizohet transmetimi në një vend të caktuar. Megjithatë, neni 10 thotë më shumë për statusin e mediave të shërbimit publik sesa thjesht një Shtet “mund të vendosë” të krijojë një sistem të shërbimit publik të transmetimit ose jo. Ai i jep mbrojtje ligjore medias së shërbimit publik ekzistues kundër veprimeve të Shtetit që janë arbitrare ose joproporcionale, në lidhje me qëllimet legjitime që një shtet mund të ndjekë, dhe e detyron Shtetin të (ri)themelojë një sistem mediatik që plotëson kërkesat e përgjithshme të nenit 10 të KEDNj-së.” (fq. 3).

“Në aktgjykimin e cituar më parë Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë, të 17 dhjetorit 2009, GjEDNj iu referua në paragrafin 102 “standardeve në lidhje me transmetimin e shërbimit publik, për të cilat janë pajtuar Shtetet Kontraktuese nëpërmjet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës” duke ofruar “udhëzime sa i përket qasjes që duhet të merret për interpretimin e nenit 10 [KEDNj] në këtë fushë”. Kjo nënkupton që GjEDNj-ja njeh burime ligjore të ndryshme nga KEDNj, të cilat shprehin një kuptim të përbashkët të Shteteve Anëtare, kur interpreton të drejtat dhe liritë, si dhe kufizimet legjitime të Konventës.” (fq. 12).

“Sigurisht, në rastin Manole, vetë Gjykata e lidhi nocionin e shtetit si “garantues përfundimtar i pluralizmit” me detyrimet pozitive, përkatësisht detyrën e shtetit moldav për të siguruar garanci ligjore për mbrojtjen e një organizate transmetuese publike pluraliste dhe të pavarur.” (fq. 21).

“Megjithëse një trajtim gjithëpërfshirës i kësaj teme do të shkonte në detaje shumë të mëdha dhe do të ishte përtej qëllimit të këtij studimi, mund të arrijmë në përfundimin se neni 10 sjellë një detyrim pozitiv ligjor të detyrueshëm për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe për të parashikuar një sistem mediatik pluralist. i cili merr parasysh zhvillimet dhe standardet evropiane të manifestuara nga rekomandimet dhe raportet e Këshillit të Evropës si dhe studimet që krahasojnë ligjet përkatëse të shteteve anëtare të BE-së dhe KE-së. Megjithatë, mbetet e paqartë se çfarë do të sjellë kjo për statusin e mediave të shërbimit publik.” (fq. 22).

“Ajo që rrjedh mjaft qartë nga Manole është se “ku një Shtet vendos të krijojë një sistem transmetimi publik” ai duhet të respektojë të drejtat e tij sipas nenit 10. Kjo përfshin

pavarësinë e tij nga presionet ekonomike ose politike dhe aftësinë e tij për të transmetuar lajme të paanshme, të pavarura dhe të balancuara.” (fq. 24).

“Mund të themi se një transmetues publik ekzistues mbrohet nga neni 10. Mbrojtja e tij sipas Konventës është pasojë e vendimit të qëllimshëm nga Shteti për të krijuar një sistem transmetimi publik që ofron shërbime mediatike audiovizive pluraliste ose që jep kontribute të mëdha në të dhe ndikohet nga zhvillimi i standardeve nga KE dhe BE në lidhje me rolin dhe kontributin thelbësor të transmetimit publik brenda një shoqërie demokratike. Ky kontribut përfshin të gjitha detyrat përmes të cilave një transmetues publik u shërben nevojave demokratike, sociale dhe kulturore të një shoqërie demokratike, siç përcaktohet në përgjegjësinë e shërbimit publik të transmetuesit. Ai është më i rëndësishmi në fushën e informacionit dhe çështjeve aktuale, por jo i kufizuar në të.” (fq. 25).

(viii) Raporti i Unionit Evropian të Transmetuesve “Fokusi juridik: Parimet e qeverisjes së shërbimit publik të medias”, publikuar në dhjetor 2021

“Në të njëjtën kohë, PSM [mediat e shërbimit publik] janë të ngulitura në sistemin demokratik të një vendi, ato ekzistojnë për t'i shërbyer qytetarëve dhe shoqërisë, varen nga financimi publik dhe janë pjesë e një ekosistemi audiovizual ekonomik dhe kulturor. Prandaj, PSM nuk mund të veprojnë i izoluar, por vetëm në ndërveprim me palët e tjera të interesuara, ose me fjalë të tjera, ata duhet të jenë të 'lidhur'; prandaj, pavarësia 'absolute' nga palët e tjera të interesit nuk është një objektiv realist ose i justifikueshëm. Megjithatë, niveli i pavarësisë duhet të jetë mjaft i lartë në mënyrë që organizatat e PSM të jenë në gjendje të përmbushin detyrën e tyre në mënyrë objektive dhe të paanshme, të kontribuojnë në lirinë dhe pluralizmin e mediave dhe të përmbushin rolin e tyre demokratik, social dhe kulturor për shoqërinë, në përputhje me Preambulën e Protokollit të Amsterdemit. Për të reduktuar rrezikun e ndërhyrjeve të panevojshme, shumica e vendeve kanë futur masa mbrojtëse ligjore dhe sisteme mbikëqyrëse që e largojnë PSM-në nga institucionet politike, veçanërisht nga degët ekzekutive dhe legjislative, por edhe nga partitë politike. Këto masa mbrojtëse shpesh marrin formën e organeve të pavarura mbikëqyrëse, të cilat veprojnë në distancë nga forcat politike dhe mund të shërbejnë si tampon midis tyre dhe menaxhmentit dhe stafit redaktues të PSM.” (fq. 8).

“Një nivel i lartë i pavarësisë së PSM duhet të shkojë paralelisht me një nivel të lartë transparence dhe llogaridhënieje. Këto nuk duhet të shihen si objektiva kontradiktore, por si synime që mund të mbështesin njëri-tjetrin. Transparenca dhe llogaridhënia 'rilidh' PSM me shoqërinë të cilës i shërbejnë dhe me institucionet e legjitimuara në mënyrë demokratike.” (fq. 9).

“Transmetimi shtetëror, të cilit i mungojnë garancitë për pavarësinë dhe pluralizmin, nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me lirinë e shprehjes.” (fq. 10).

“Organet mbikëqyrëse të PSM-së kanë një rol kyç për të luajtur në respektimin dhe sigurimin e pavarësisë së PSM-së. Do të ishte joreale të pritet që një organ mbikëqyrës të përmbushë rolin e tij të garantuesit të pavarësisë nëse ai vetë nuk është i pavarur dhe i përbërë në mënyrë të balancuar ose pluraliste. Në veçanti, përfaqësuesit e shtetit apo politikanët duhet të pengohen nga fitimi i një ndikimi përcaktues në këto organe.” (fq. 11).

“Anëtarët e organit mbikëqyrës duhet të emërohen për një mandat të caktuar, por të ripërtëritshëm, me kohëzgjatje të arsyeshme (4-6 vjet). Mund të jetë e dobishme të parashikohet anëtarësimi me kushte 'të shkallëzuara'; për shembull, nëse një mandat gjatësivjeçar është rregull, çdo dy vjet një e treta e anëtarëve mund të ripërtërihet. Kjo

mund të forcojë pavarësinë dhe vazhdimësinë e punës dhe të shmangë një situatë ku pas çdo zgjedhjeje apo ndryshimi të qeverisë organi mbikëqyrës të rikompozohet plotësisht. Anëtarët e organit mbikëqyrës gjithashtu kanë nevojë për mbrojtje ligjore për ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre. Ata nuk duhet të jenë të detyruar nga udhëzimet, nuk duhet të kenë frikë nga revokimi nga ata që i kanë emëruar dhe duhet të mbrohen nga shkarkimi (përveç rasteve të justifikuara objektivisht të përcaktuara me ligj, siç është paaftësia për të përmbushur funksionet e tyre).” (fq. 13).

“Ndërsa duhet të ekzistojë mundësia për shkarkim nga organi mbikëqyrës nëse menaxhmenti ka dështuar në përmbushjen e detyrave të tij ose ka humbur besimin e organit mbikëqyrës, duhet të ketë masa mbrojtëse kundër shkarkimeve të motivuara politikisht. Në veçanti, shkarkimet duhet të kërkojnë një shumicë të kualifikuar (p.sh. dy të tretat) në organin mbikëqyrës. Disa vende parashikojnë që menaxhmenti shkarkohet nëse raporti vjetor refuzohet nga parlamenti, pas prezantimit të tij nga drejtuesit e PSM në një komision parlamentar. Një sistem i tillë hap derën e ndërhyrjeve të panevojshme politike, minon rolin e organit mbikëqyrës, mund të çojë në autocensurë në lidhje me përmbajtjen redaksionale dhe të shkaktojë destabilitet në nivel drejtues. Në fakt, vendet me sisteme të tilla shpesh kanë një nivel tepër të lartë të qarkullimit të drejtorëve të përgjithshëm të PSM.” (fq. 16).

“Shpesh organizatat PSM janë nën një detyrim formal për të publikuar raporte vjetore të cilat duhet të përfshijnë një grup minimal të informatave. Në praktikë, raportet vjetore përdoren gjithashtu për të paraqitur organizatën PSM dhe shërbimet dhe arritjet e saj në një mënyrë më të gjerë. Raportet vjetore janë shpesh bazë për një debat më të gjerë politik mbi rolin, përgjegjësinë dhe financimin e PSM, për shembull në parlament. Megjithatë, nuk duhet të ketë nevojë për miratimin e raportit vjetor nga parlamenti; në mënyrë të ngjashme, çdo refuzim i raportit nuk duhet të çojë automatikisht në shkarkimin e menaxhmentit (shih, paragrafin 2.4.3 më lart, fq. 25).

(ix) Raporti IRIS Plus i Obzervatorit Audiovizual Evropian “Qeverisja dhe pavarësia e shërbimit publik të medias”, publikuar më 22 shkurt 2022

“Sa i përket pavarësisë së organeve mbikëqyrëse, një pikënisje e mirë sipas EBU është parandalimi i anëtarësimit apo ndikimit të përfaqësuesve shtetërorë dhe politikanëve, si dhe ruajtja e një ndarje të rreptë ndërmjet organeve menaxheriale dhe mbikëqyrëse. Pavarësia e anëtarëve të tyre duhet të garantohet nëpërmjet emërimit për një kohëzgjatje të arsyeshme (katër deri në gjashtë vjet) me opsionin e ripërtëritjes - në mënyrë ideale me kushte të shkallëzuara, si dhe duke i mbrojtur ata kundër shkarkimit ose revokimit gjatë mandatit të tyre. Për më tepër, emërimet në këto borde duhet të jenë të hapura dhe transparente, ku raporti rekomandon një shumicë të kualifikuar (3/5, 2/3 ose 3/4) në parlament për zgjedhjen e anëtarëve të një organi mbikëqyrës.” (fq. 5).

“Për sa i përket llogaridhënies dhe transparencës, PSM duhet të vendosë korniza të qeverisjes për të përcaktuar se kujt dhe për çfarë janë përgjegjëse organizatat, dhe si arrihet në mënyrë efektive kjo llogaridhënie. PSM jo vetëm që duhet të informojë publikun për aktivitetet dhe organizatat e tyre, por edhe të kërkojë në mënyrë aktive komentet e tyre. Për më tepër, ata duhet të mbajnë një lidhje të përherëshme me komunitetet, organizatat dhe shoqërinë civile në mënyrë që të integrojnë sa më shumë që të jetë e mundur përdoruesit e shërbimeve si bashkëkrijues.” (fq. 6).

“E drejta e lirisë së shprehjes, e parashikuar në nenin 10 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është një e drejtë shumë-planëshe që shpaloset në lirinë për të mbajtur mendime, për të marrë dhe për të dhënë informata dhe ide, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Kjo e drejtë përfshin, si pjesë integrale, lirinë e mediave, duke përfshirë pavarësinë, pluralizmin dhe diversitetin e mediave, si dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave.”

(shih, fq. 102, citon fjalimin e Robert Spanos, President i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Konferencën Vjetore ERA të Ligjit Evropian të Medias, të 18 qershorit 2021).

Pranueshmëria e kërkesës

97. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
98. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 të Kushtetutës, që përcakton:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

99. Përkitazi me këto kritere, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e kanë ngritur kërkesën e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, që parasheh si në vijim:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”.

100. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është parashtruar nga dhjetë (10) deputetë të Kuvendit, që është minimumi i pragut të kërkuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht, ky kriter është plotësuar.
101. Gjykata gjithashtu në vlerësimin e kriterit të dytë *“brenda afatit prej 8 ditësh”*, vëren se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 16 korrik 2021, ndërkohë që Akti i kontestuar është miratuar nga Kuvendi, më 8 korrik 2021, çfarë nënkupton se kërkesa është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
102. Përveç kriterëve të mësipërme, Gjykata po ashtu duhet të vlerësojë nëse dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit, legjitimohen se janë “palë e autorizuar” në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të kontestuar kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji a akti të miratuar nga Kuvendi, si për nga përmbajtja, ashtu dhe procedura e ndjekur. Në rastin, konkret deputetët e Kuvendit, legjitimohen se janë palë e autorizuar, dhe rrjedhimisht në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, kanë të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së Aktit nr. 01-V-136, të miratuar nga Kuvendi, më 8 korrik 2021.
103. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit që rregullojnë parashtrimin e kërkesës në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili kërkon që të paraqiten informatat e mëposhtme:

Nenin 42
(Saktësimi i kërkesës)

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti”.

Neni 43
(Afati)

1. Një ligj apo vendim i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 i Kushtetutës”.

104. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës, që parasheh:

Rregulli 72
(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit.

(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli ka efekt suspenziv.

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme: (a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputeteve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës; (b) dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe (c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.

(4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputeteve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.

(5) Gjykata menjëherë pas regjistrimit të një kërkesë të parashtruar në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, e njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

(6) Në rast se kontestohet një ligj ose një vendim i Kuvendit që kërkon dekretimin nga Presidenti/ja, Gjykata menjëherë pas regjistrimit të kërkesës së parashtruar, në pajtim me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenet 42 (Efekti Suspenziv) dhe 43 (Afati) të Ligjit e njofton Presidentin/en dhe Kuvendin për efektin suspenziv të kërkesës ndaj hyrjes në fuqi të ligjit ose vendimit që kontestohet, derisa Gjykata të nxjerrë vendim përfundimtar lidhur me çështjen

para saj”.

(7) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të parashtrohet brenda tetë (8) ditësh nga data e miratimit të ligjit apo të vendimit të kontestuar.

105. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës: (i) shënuan emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesë; (ii) specifikuan Aktin e kontestuar të Kuvendit nr. 01-V-036, të 8 korrikut 2021, për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së dhe dorëzuan kopjen e tij; (iii) iu referuan dispozitave specifike kushtetuese, me të cilat ata pretendojnë se Akti i kontestuar nuk është në pajtueshmëri; (iv) paraqitën prova dhe dëshmi për të mbështetur pretendimet e tyre; si dhe dorëzuan kërkesën, brenda afatit prej tetë (8) ditësh, siç përcakton paragrafi 5 i nenit 113 të Kushtetutës.
106. Andaj, në vazhdim, Gjykata do të shqyrtojë meritat e kërkesës përkitazi me nenet respektive të Kushtetutës, sikurse janë cekur në paragrafin paraprak.

Meritat

107. Gjykata rikujton se, pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në vitin 2021, dhe pas konstituimit të legjislaturës së VIII-të (tetë) të Kuvendit, Komisioni për Administratë Publike dhe Komisioni për Buxhet, fillimisht (i) kishin rekomanduar refuzimin e miratimit të Raportit Vjetor për vitin 2020 të RTK-së, dhe më pas kishin propozuar shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së; pastaj (ii) më 8 korrik 2021, Kuvendi kishte votuar për të refuzuar miratimin e Raportit Vjetor të RTK-së për vitin 2020 dhe gjithashtu, kishte votuar për shkarkimin e të gjithë, përkatësisht të tetë (8) anëtarëve të Bordit të RTK-së, të cilët ishin zgjedhur nga Kuvendi në vitin 2018 dhe 2020, respektivisht, me mandat trevjeçar, për të ushtruar detyrën e anëtarëve të Bordit të RTK-së.
108. Propozimin e komisioneve përkatëse për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, Kuvendi e kishte pranuar më 22 qershor 2021. Në ndërkohë, ky i fundit kishte njoftuar të gjithë deputetët për mbajtjen e seancës plenare të radhës, ku njëra nga pikat e rendit të ditës ishte edhe shqyrtimi i rekomandimit [Nr. 08/358/Do-238], të Komisionit për Administratë Publike për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së. Më 8 korrik 2021, Kuvendi kishte shqyrtuar rekomandimin e këtij komisioni dhe pas përfundimit të diskutimeve, kishte ftuar deputetët për votim. Nga procesverbali i seancës plenare, rezulton se propozimet përkatëse për shkarkimin e secilit anëtar të Bordit morën nga gjashtëdhjetë e katër (64) vota “për”, asnjë votë “kundër” dhe nga një (1) abstenim. Pas përfundimit të votimit, më 8 korrik 2021, Kuvendi kishte miratuar Aktin e kontestuar [Nr. 08-V-036], i cili edhe zyrtarisht konfirmon shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së.
109. Gjykata, gjithashtu rikujton që dhjetë (10) deputetë të Kuvendit të Kosovës, kanë kontestuar kushtetutshmërinë e vendimit të Kuvendit nëpërmjet të cilit janë shkarkuar të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së, duke pretenduar, ndër tjerash, që (i) Kuvendi në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, me theks në autorizimet e Kuvendit për të ushtruar kompetencën e mbikëqyrjes, sipas përcaktimeve të paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, por edhe të neneve 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës, ka tejkaluar në mënyrë arbitrare kompetencën përkatëse, duke shkarkuar në mënyrë kolektive të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së, në kundërshtim me përcaktimet e vet Ligjit për RTK-në, të miratuar nga Kuvendi; dhe (ii) për pasojë, kanë cenuar dhe të drejtat dhe liritë themelore individuale të anëtarëve të Bordit të RTK-së, të garantuara me Kushtetutë. Gjykata, rikujton që pretendimet e parashtruesve të kërkesës, mbështeten nga komentet e dorëzuara në Gjykatë nga RTK-ja, ndërsa kundërshtohen nga grupi parlamentar i LVV-së.

110. Gjykata vë në pah se pretendimet e mësipërme në mënyrë specifike i referohen tejkalimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj RTK-së, si institucion i pavarur dhe autonom që ofron shërbime publike në sferën e transmetimit medial dhe organeve drejtuese të tij. Andaj, në këtë kontekst, Gjykata do t'i trajtojë dhe shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në kuadër të paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, pasi që në esencë kërkesa ngrenë çështje të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj institucioneve publike, përkatësisht ushtrimit të funksionit mbikëqyrës ndaj transmetuesit publik në kundërshtim me autorizimet përkatëse të mbikëqyrjes sipas përcaktimeve të vet Kuvendit, përmes miratimit të Ligjit për RTK-në.
111. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht vë theks në rolin e Kuvendit në ushtrimin e funksionit të tij thelbësor të mbikëqyrjes. Në këtë kontekst, Gjykata vë në pah se bazuar në paragrafin 2 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ. Këtë funksion, Kuvendi e ushtron bazuar në kompetencat e përcaktuara në nenin 65 të Kushtetutës, përfshirë kompetencën (i) për të miratuar ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni; dhe (ii) për të mbikëqyrur punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit, siç është përcaktuar në paragrafin 9 të këtij neni. Që të dyja këto kompetenca të Kuvendit përbëjnë thelbin e funksionit kushtetues të tij.
112. Thënë këtë, në ushtrimin e këtyre kompetencave, Kuvendi është i kufizuar në respektimin e dispozitave kushtetuese, duke përfshirë nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, bazuar në të cilin deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të vendit dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit. Për më tepër, në kontekst të ushtrimit të kompetencës së mbikëqyrjes, Kuvendi është i kufizuar, ndër të tjera, në dispozitat themelore të Kushtetutës, me theks në (i) parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, siç është saktësuar në nenin 4 të Kushtetutës; dhe (ii) vlerat themelore të Republikës së Kosovës, siç janë të saktësuara në nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës, respektivisht. Për më tepër, në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes, Kuvendi është gjithashtu i kufizuar në respektimin e ligjit të aplikueshëm të cilin e miraton vet, sipas paragrafit 1 të nenit 65 të Kushtetutës. Detyrimi për të vepruar në përputhje me ligjin e aplikueshëm është saktësisht i përcaktuar në (i) paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës; dhe (ii) nenin 74 të Kushtetutës. Çdo tejkalim i autorizimeve kushtetuese dhe ligjore në ushtrimin e kompetencës mbikëqyrëse të Kuvendit, mund të rezultojë në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve siç është saktësuar në nenin 4 të Kushtetutës, por edhe të neneve 3 dhe 7 të Kushtetutës, respektivisht, dhe gjithashtu në cenim të pavarësisë kushtetuese dhe/ose ligjore të institucionit përkatës, mbi të cilën ushtrohet kjo mbikëqyrje nga Kuvendi.
113. Gjykata thekson që roli mbikëqyrës i Kuvendit mbi RTK-në si transmetues publik, në kuadër të kufizimeve që ka përcaktuar vet Ligji për RTK-në, nuk është kontestues. Një mekanizëm i tillë mbikëqyrës, është gjithashtu në përputhje me standardet e shtjelluara nëpërmjet Komisionit të Venecias, sigurisht me kushtëzime të saktësuara në vet raportet e Komisionit të Venecias dhe parimet e që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare të shtjelluara si më lart në këtë Aktgjykim.
114. Thënë këtë, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, ushtrimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit është i rëndësishëm të posaçme veçanërisht në fushën e lirisë së medias marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e saj në një shoqëri demokratike. Kjo gjithashtu, sepse liria dhe pluralizmi i medias, janë saktësisht të përcaktuara me Kushtetutë, përkatësisht në nenin 42 [Liria e Medieve] të saj. Kjo e drejtë është po ashtu

ngushtë e ndërlidhur me lirinë e shprehjes të garantuar përmes nenit 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës dhe nenit 10 (Liria e Shprehjes) të KEDNJ-së, instrument ndërkombëtar ky drejtpërdrejtë i aplikueshëm në rendin juridik të Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata rikujton se GjEDNJ-ja e interpreton këtë Konventë, ndërsa në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, Gjykata dhe jo vetëm, është e detyruar ta zbatojë interpretimin e Konventës sipas jurisprudencës së GjEDNJ-së. Praktika gjyqësore e GjEDNJ-së përcakton jo vetëm detyrimin e shtetit për të mos ndërhyrë në vlerat e lirisë dhe pluralizmit të mediave dhe në lirinë e shprehjes, por edhe detyrimet pozitive të shtetit që në rastet kur krijojnë transmetues publikë, siç është RTK-ja në Republikën e Kosovës, të garantojë ofrimin e shërbimit pluralist dhe mbrojtje të mjaftueshme ndaj ndërhyrjeve politike dhe të tjera (shih, ndër tjerash, rastin e GjEDNJ-së [*Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*](#), nr. 13936/02, Aktgjykimi i 13 shtatorit 2009, paragrafët 99, 100 dhe 101).

115. Më saktësisht, Gjykata vë theks në faktin që bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, kategoria e pavarësisë së transmetuesve publikë është ngritur në nivel të parimeve të të drejtave dhe lirive themelore të mbrojtura me nenin 10 të KEDNJ-së (shih, rastin [*Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*](#) dhe paragrafin 81 të Opinionit të Komisionit të Venecias [*CDL-AD\(2015\)015-e*](#), mbi Legjislacionin për media të Hungarisë të publikuar më 22 qershor 2015). Për më tepër, bazuar në të njëjtën praktikë gjyqësore, një transmetues publik i cili nuk i ka sigurinë e nevojshme në kontekst të pavarësisë dhe pluralizmit, nuk mund të jetë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 10 të KEDNJ-së (shih, ndër tjerash, Raportin e [*Unionit Evropian të Transmetuesve*](#), “Fokusi juridik: Parimet e qeverisjes së shërbimit publik të medias”, publikuar në dhjetor 2021).
116. Gjykata, gjithashtu vë theks në faktin që bazuar në këtë praktikë gjyqësore të GjEDNJ-së, përfshirë standardet ndërkombëtare të shtjelluara në këtë Aktgjykim, përderisa shtetet nuk kanë detyrimin e themelimit të transmetuesve publikë, në rast se të njëjtit themelohen, në kuadër të fushëveprimit të nenit 10 të KEDNJ-së, shteti ka detyrimin që të garantojë pavarësinë e tyre ligjore, duke përfshirë mbrojtjen nga veprimet arbitrare dhe/ose disproporcionale të vet shtetit, në përputhje me qëllimin legjitim përkatës, gjithnjë me theks në rolin dhe kontributin thelbësor të transmetuesve publikë dhe medias në shoqëritë demokratike. Sipas GjEDNJ-së dhe ndër tjerash, “*e drejta në lirinë e shprehjes e mishëruar në nenin 10 të KEDNJ-së, është një e drejtë shumëdimensionale e cila përfshin të drejtën për të pasur dhe shprehur opinionin, për të marrë dhe përcjellë informacion dhe ide, pa ndërhyrje nga autoritetet publike. Kjo e drejtë gjithashtu përfshin lirinë e medias, duke përfshirë pavarësinë përkatëse, pluralizmin dhe diversitetin e medias, dhe sigurinë e gazetarëve dhe akterëve tjerë ndërlidhur me medien*” (Raporti IRIS Plus i Observatorit Audiovizual Evropian “Qeverisja dhe pavarësia e shërbimit publik të medias”, publikuar më 22 shkurt 2022, fq. 102, citon fjalimin e Robert Spanos, President i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Konferencën Vjetore ERA të Ligjit Evropian të Medias, të 18 qershorit 2021).
117. Bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata në vijim, do të (i) shtjellojë parimet e përgjithshme që burojnë nga dispozitat kushtetuese dhe instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare lidhur me transmetuesit publikë dhe për aq sa janë relevante në rrethanat e rastit konkret; dhe më pas (ii) do të aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit, përgjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar të Kuvendit.

I. Parimet relevante që burojnë nga praktika gjyqësore e GjEDNJ-së dhe instrumentet relevante ndërkombëtare

118. Gjykata fillimisht, do t'i referohet në mënyrë të përmblëdhur parimeve të përgjithshme përkitazi me statusin dhe rolin e transmetuesve publikë dhe me mbikëqyrjen përkatëse

të Kuvendit, duke përfshirë detyrimet dhe kufizimet përkatëse, bazuar në: (i) Opinionet relevante të Komisionit të Venecias; (ii) Rekomandimet e Komitetit të Ministrave; (iii) Raportet dhe aktet e organizatave/asociacioneve profesionale ndërkombëtare; (iv) praktikën relevante gjyqësore të GjEDNj-së; dhe (v) kontributin e Gjykatave Kushtetuese dhe/ose ekuivalentëve të tyre përmes Forumit të Komisionit të Venecias.

(i) *Opinionet relevante të Komisionit të Venecias*

119. Në këtë kontekst, Gjykata vë theks në Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, e të shtjelluara në pjesën e Dispozitave relevante të këtij Aktgjykimi, dhe të cilat, ndër të tjera, kanë shtjelluar çështje që ndërlidhen me mbikëqyrjen e transmetuesve publikë, përfshirë Opinionin (nr. 309/2004 - [CDL-AD \(2005\)017](#)) mbi përputhshmërinë e ligjeve “Gasparri” dhe “Frattini” të Italisë me standardet e Këshillit të Evropës në fushën e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit të medias, miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e tij të 63-të plenare (Venecia, 10-11 qershor 2005) (në tekstin e mëtejshëm: Opinioni për Italinë), nëpërmjet të cilit Komisioni i Venecias, mes tjerash, qartëson se, transmetuesi publik është shërbim publik i cili ka detyrime që variojnë nga ofrimi i një shërbimi universal, tek një formë e përfaqësimit social, tek ofrimi i një game të gjerë programesh cilësore. Në këmbim, ato gëzojnë një qasje të privilegjuar në burime dhe objekte (paragrafi 52). Tutje në opinion theksohet: *“Prandaj, transmetuesi i shërbimeve publike, pritet t'i shërbejë interesit publik, të kujdeset për të gjithë popullsinë në baza universale dhe jofitimprurëse; është detyrë publike dhe duhet t'i shërbejë nevojave demokratike të shoqërive bashkëkohore. Shërbimi publik i transmetimit duhet të jetë i lirë nga forcat shtrënguese të shtetit dhe, nga ana tjetër, të gëzojë autonomi dhe varësi nga tregu. Detyra e tij specifike është në thelb të veprojë në mënyrë të pavarur nga ata që mbajnë pushtetin ekonomik dhe politik”* (shih, Opinioni nr. 309/2004 - [CDL-AD\(2005\)017](#) për Italinë, cituar më lart, paragrafët 53 dhe 54).
120. Për më tepër, në aspektin e mbikëqyrjes së punës së transmetuesit publik, Komisioni i Venecias, gjithashtu thekson: *“[...] se një rol mbikëqyrës i parlamentit në transmetuesin kombëtar është sigurisht i pranueshëm dhe i pajtueshëm me funksionet demokratike të parlamentit. Shpesh pasqyron kulturën politike që mbizotëron në shtetet në fjalë. [...] Megjithatë, ky rol parlamentar duhet të shërbejë kryesisht me vendosjen e udhëzimeve dhe zgjidhjen e problemeve të caktuara të opinionit publik dhe nuk duhet të shtrihet për të ndërhyrë në punën redaksionale të transmetuesit apo edhe me emërimin dhe shkarkimin e gazetarëve”* (shih, Opinioni për Italinë, paragrafët 151 dhe 153). Ky opinion nënvizon se një nga cilësitë më tipike të një transmetuesi publik është se duhet të veprojë i pavarur nga ata që kanë fuqi ekonomike dhe politike. Pavarësia e transmetuesit publik është themelore që ai me të vërtetë të mund të sigurojë pluralizëm të brendshëm (shih, Opinioni nr. 309/2004 - [CDL-AD\(2005\)017](#) për Italinë, cituar më lart, paragrafi 162).
121. Për më tepër, në Opinionin (nr.798/2015 - [CDL-AD\(2015\)015-e](#)) mbi Legjislacionin e Medias mbi Shërbimet e Medias dhe Masmedian, Akti CIV për Lirinë e Shtypit dhe Legjislacioni për Tatimin e të Ardhurave nga Reklamata e Masmedias i Hungarisë, miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e tij të 103-të plenare (Venecia, 19-20 qershor 2015) (në tekstin e mëtejshëm: Opinioni për Hungarinë), Komisioni i Venecias, ndër tjerash, thekson: *“[...] se kërkesa e pavarësisë, e cila është e zbatueshme për organet rregullatore të medias në përgjithësi është gjithashtu e zbatueshme për organet që mbikëqyrin sektorin publik të medias. Kështu, Shtojca e Rekomandimit të Komitetit të Ministrave, Rekomandimit nr. R (96) 10, rekomandon që anëtarët e organeve mbikëqyrëse të transmetuesve të shërbimeve publike, të emërohen në mënyrë të hapur dhe pluraliste dhe të përfaqësojnë kolektivisht interesat e shoqërisë në përgjithësi. Pavarësia e transmetuesve publikë është ngritur në statusin e një*

parimi të ligjit evropian për të drejtat e njeriut” (paragrafët 80 dhe 81). Ky opinion vëren se nuk ka një model të përbashkët evropian të qeverisjes së mediave publike. Prandaj, u takon autoriteteve shtetërore të zhvillojnë një kuadër ligjor që siguron pluralizëm brenda trupave mbikëqyrës të mediave publike dhe pavarësi të mjaftueshme. Opinioni për Hungarinë vëren se ndikimi i shumicës parlamentare në emërimin e anëtarëve të trupit mbikëqyrës të mediave publike dhe nivelit ekzekutiv të tyre duhet të zvogëlohet dhe se duhet të sigurohet se në atë trup, përfaqësohen drejt të gjitha grupet e rëndësishme politike, shoqërore dhe relevante profesionale (shih, Opinioni nr.798/2015 -[CDL-AD\(2015\)015-e](#), për Hungarinë, cituar më lart, paragrafët 86 dhe 88).

(ii) *Rekomandimet e Komitetit të Ministrave*

122. Në kontekst të mbikëqyrjes parlamentare të transmetuesve publikë, Gjykata gjithashtu i referohet Rekomandimit nr. R (96) 10 të Komitetit të Ministrave i 11 shtatorit 1996, mbi *“Garantimin e pavarësisë së shërbimit të transmetimit publikë”* (në tekstin e mëtejshëm: Rekomandimit nr. R (96) 10), në të cilin është referuar edhe GjEDNj-ja edhe Komisioni i Venecias. Rekomandimi i lartcekur, detajon disa udhëzime që shtetet anëtare duhet të përfshijnë në ligjin e tyre të brendshëm, ashtu që të garantojnë pavarësinë e transmetuesve publikë, si një parakusht për funksionimin e një shoqërie demokratike. Komiteti i Ministrave të KE-së, kur flet për kompetencat e organeve mbikëqyrëse të transmetuesve publikë, thekson se korniza ligjore e cila e rregullon shërbimin e transmetimit publik, duhet të përcaktojë qartë dhe saktë kompetencat e organeve të tyre mbikëqyrëse. Tutje, përkritazi me statusin e organeve mbikëqyrëse të transmetuesve publikë, rekomandimi thekson se anëtarët e këtyre organeve: *“[...] nuk mund të shkarkohen, pezullohen ose zëvendësohen, gjatë mandatit të tyre nga ndonjë person ose organ tjetër përveç atij që i ka emëruar ata, përveç në raste kur organi mbikëqyrës rregullisht ka vërtetuar se ata janë të paaftë ose janë penguar në ushtrimin e funksionit të tyre”* (shih, pjesën III, pikën 2. “Statusi” të [Rekomandimit nr. R \(96\) 10](#), cituar më lart, fq. 3).
123. Ndërkaq, Rekomandimi CM/Rec (2012) 1, i Komitetit të Ministrave i 15 shkurtit 2012, mbi *“Qeverisjen e mediave publike”* (në tekstin e mëtejshëm: Rekomandimi CM/Rec (2012) 1.) thekson se mediat publike duhet të veprojnë dhe të zhvillohen brenda një kornize të qëndrueshme qeverisëse që ju mundëson si pavarësinë e nevojshme redaktoriale, ashtu edhe llogaridhënien publike. Ky rekomandim thekson se një kuadër për qeverisjen e mediave publike duhet të përmbajë dy karakteristika themelore: pavarësinë dhe llogaridhënien. Sa i përket pavarësisë, ajo duhet të jetë qëllimi parësor i secilit kuadër për qeverisjen e mediave publike, sepse pa pavarësi, mediat publike nuk mund të veprojnë efektivisht e as t’i shërbejnë interesit publik. Në anën tjetër, qeverisja e mediave publike duhet t’i përmbahet edhe parimit të llogaridhënies dhe të ketë mekanizmat e nevojshëm për të identifikuar hisedarët dhe për të qenë llogaridhënëse. Këto dy aspekte baraspeshojnë njëra-tjetrën, ashtu që pavarësia që u njihet mediave publike, të jetë në shërbim të mbrojtjes së tyre nga ndikimet e papërshtatshme nga shteti ose palët tjera dhe të baraspeshohet nga obligimi i këtyre mediave për të qenë plotësisht llogaridhënëse ndaj shtetit dhe hisedarëve tjerë (shih, [Rekomandimi CM/Rec \(2012\) 1](#), cituar më lart, paragrafi 18).
124. Gjykata gjithashtu vëren që sipas këtij rekomandimi, pavarësia është parakusht thelbësor për secilën organizatë të medias publike. Pa pavarësi në veprim dhe në iniciativë, si nga qeveria, ashtu edhe nga interesat apo institucionet tjera, mediat publike nuk mund të ruajnë besueshmërinë. Prandaj, siguri dhe ruajtja e pavarësisë përbëjnë qëllimet parësore të kuadrit për qeverisjen e mediave publike dhe gjithashtu janë në thelb të standardeve relevante të Këshillit të Evropës (shih, [Rekomandimi CM/Rec \(2012\) 1](#), cituar më lart, paragrafët 21 dhe 22).

125. Rekomandimi gjithashtu thekson se është legjitime që shteti të jetë i përfshirë në emërimin e trupit më të lartë mbikëqyrës ose autoritetit vendimmarrës të mediave publike. Sidoqoftë, kjo përfshirje nuk do të duhej të shtrihej edhe në emërimet që kanë të bëjnë me nivelin ekzekutiv ose redaktorial. Proceset e emërimit duhet të dizajnohen në atë mënyrë që: (i) kriteret e emërimit të jenë të qarta, të kufizuara dhe të ndërlidhura me rolin dhe fushëveprimin e mediave publike; (ii) emërimet të mos përdoren me qëllim të ushtrimit të ndikimit politik ose tjetër në veprimtarinë e mediave publike; (iii) emërimet të bëhen për mandat të caktuar, i cili mandat mund të shkurtohet në rrethana të kufizuara dhe të saktësuara në ligj, e që nuk duhet të përfshijnë ndryshimet në pikëpamje sa i përket pozitave redaktoriale ose vendimmarrjes; dhe (iv) në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, duhet të ketë përfaqësim të burrave dhe grave në trupat e këtillë vendimmarrës (shih, [Rekomandimi CM/Rec \(2012\) 1](#), cituar më lart, paragrafi 27).
126. Për sa i përket llogaridhënies, rekomandimi shquan tre hisedarë ndaj të cilëve mediat publike duhet të jenë llogaridhënëse, e që varësisht nga rregullimet e shteteve përkatëse, janë (i) shteti, përmes qeverisë dhe/ose kuvendit dhe trupave tjerë rregullatorë; (ii) publiku i gjerë, pra qytetarët; si dhe (iii) shoqëria civile. Natyra e llogaridhënies është e ndryshme ndër shtete dhe ndër sisteme politike e shoqërore. Sidoqoftë, parimet qeverisëse duhet të saktësojnë se kujt duhet t'i japin llogari organizatat e mediave publike dhe se si duhet të bëjnë këtë. Sistemet e llogaridhënies duhet të qartësojnë qëllimin publik dhe përgjegjësitë për të cilat mediat publike duhet të japin llogari (shih, [Rekomandimi CM/Rec \(2012\) 1](#), cituar më lart, paragrafët 28 dhe 30).

(iii) Raporte dhe akte të organizatave/asociacioneve profesionale ndërkombëtare

127. Gjykata gjithashtu i referohet Raportit IRIS Plus, i Observatorit Audiovizual Evropian mbi “*Qeverisjen dhe pavarësinë e shërbimit të medias publike*”, publikuar më 22 shkurt 2022 (në tekstin e mëtejme: Raporti IRIS Plus), dhe i cili, analizon në hollësi rregullimin normativ dhe praktikën e ndryshme në kontinentin evropian për sa i përket mediave publike, si nga këndvështrimi i Këshillit të Evropës, ashtu edhe nga këndvështrimi i Bashkimit Evropian.
128. Për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, ky raport thekson se ekzistojnë modele të ndryshme sa i përket strukturës, financimit, fushëveprimit dhe qeverisjes së mediave publike. Megjithatë, si parime të përbashkëta të secilit prej këtyre modeleve, mund të shquhen pavarësia, llogaridhënia, transparencja dhe qëndrueshmëria (shih, [Raporti IRIS Plus](#), cituar më lart, fq. 4). Si mënyra për të garantuar pavarësinë e trupave mbikëqyrëse të mediave publike, raporti përmend: (i) emërimin e anëtarëve të këtyre trupave për mandat në kohëzgjatje të arsyeshme, nga katër (4) deri në gjashtë (6) vjet, me mundësi të rizgjedhjes, si zgjidhje ideale me mandate që nuk nisin dhe përfundojnë njëkohësisht për të gjithë; (ii) mbrojtjen nga shkarkimi përgjatë mandatit; dhe (iii) emërimet të hapura dhe transparente, përmes një shumice të cilësuar parlamentare, prej 3/5, 2/3 ose 3/4 të parlamentit përkatës (shih, [Raporti IRIS Plus](#), fq. 5). Ndërkaq, sa i përket llogaridhënies dhe transparencës, raporti thekson se rregullat e brendshme duhet të përcaktojnë se ndaj kujt dhe për çfarë mediat publike duhet të jenë llogaridhënëse. Transparenca arrihet përmes publikimit të raporteve vjetore dhe informatave të rëndësishme në ueb-faqe, si dhe përmes hartimit të standardeve të transparencës që identifikojnë dokumentet dhe informatat që media publike duhet t'i bëjë të qasshme në vazhdimësi (shih, [Raporti IRIS Plus](#), cituar më lart, fq. 6).
129. Gjykata gjithashtu thekson që edhe [Unioni Evropian i Transmetuesve](#) (EBU), në Raportin “*Fokusi Juridik: Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike*”, të

publikuar më 13 dhjetor 2021 (në tekstin e mëtejshëm: Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike), shquan pavarësinë, llogaridhënien, transparencën dhe qëndrueshmërinë, si parime themelore. EBU, këto katër elemente i cilëson si kërkesa bazike të qeverisjes së mediave publike, që burojnë nga roli dhe funksioni që këto media kanë në shoqëritë demokratike (shih, *Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike*, fq. 6). Për sa i përket pavarësisë si parim themelor, ky raport vëren se shërbimet e mediave publike mund të përmbushin rolin e tyre vetëm nëse perceptohen të jenë me të vërtetë të pavarura nga qeveria dhe forcat tjera politike e ekonomike. Duke qenë se këto media janë në njëfarë mënyre të varura nga vendimet politike dhe financimi, ato janë çdoherë të ndjeshme ndaj presioneve të jashtme politike. Prandaj, pavarësia e tyre nuk duhet të merret asnjëherë si e mirëqenë (shih, *Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike*, fq. 8).

130. Raporti më tej analizon strukturën organizative të shërbimeve të mediave publike, duke theksuar se shërbimet e mediave publike duhet të jenë institucione të pavarura, të përkushtuara në vlerat e shërbimit publik. Mungesa e masave që mbrojnë pavarësinë dhe pluralizmin e transmetuesve publikë, rezultojnë në mospërputhje me kërkesat e nenit 10 të KEDNj-së (shih, *Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike*, fq. 10). Trupat mbikëqyrëse kanë rol kyç në respektimin dhe sigurimin e pavarësisë së mediave publike; një trup mbikëqyrës që nuk është vet i pavarur dhe pluralist, nuk mund të përmbushë rolin e garantuesit të pavarësisë për median publike (shih, *Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike*, fq. 11). Si mënyra për të siguruar pavarësinë e trupit mbikëqyrës të shërbimit të medias publike, Raporti numëron: (i) emërimin përmes një shumice të kualifikuar parlamentare (shumicë prej 3/4, 2/3 ose 3/4 të parlamentit përkatës); (ii) varësisht nga sistemi politik, bashkëpunimin e institucioneve të ndryshme shtetërore në procesin e emërimit; (iii) emërim të një numri anëtarësh të trupit mbikëqyrës nga shumica parlamentare dhe të anëtarëve të tjerë nga pakica parlamentare; dhe (iv) nominimin e anëtarëve nga shoqëria civile (shih, *Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike*, fq. 12). Si parakusht tjetër esencial për pavarësinë e këtyre trupave, Raporti përmend se anëtarët nuk duhet të marrin udhëzime e as të kenë frikën e revokimit nga ata që i kanë emëruar (nominuar) dhe se duhet të jenë të mbrojtur nga shkarkimi, në përjashtim të rasteve të arsyeshme objektivistike dhe të saktësuara në ligj, siç është paaftësia për të përmbushur funksionet (shih, *Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike*, fq. 13).
131. Gjykata gjithashtu thekson që ky raport analizon parakushtet lidhur me pavarësinë e nivelit ekzekutiv-menaxherial të mediave publike. I njëjti vëren se ekzistojnë sisteme në të cilat sipas ligjeve përkatëse, menaxhmenti i transmetuesit publik shkarkohet në rast të refuzimit të raportit vjetor nga ana e Kuvendit, pasi i njëjti t'i jetë prezantuar një komiteti parlamentar. EBU tërheq vërejtjen se këto sisteme hapin rrugë për ndërhyrje të papërshtatshme politike, nënvlerësojnë rolin e trupit mbikëqyrës dhe mund të çojnë në vet-censurim të përmbajtjes redaktoriale dhe të shkaktojnë jostabilitet të nivelit menaxherial (shih, *Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike*, fq. 16).
132. Për sa i përket llogaridhënies, Raporti vëren se në shoqëritë demokratike moderne, publiku duhet të ketë qasje të plotë në atë se si një media publike është e organizuar dhe menaxhohet, se si shpenzohet paraja dhe se si kryhet puna e gazetarisë. Raporti vëren se është e rëndësishme që mbikëqyrja e shërbimeve të mediave publike të mos bëhet nga institucione të zgjedhura në mënyrë demokratike, por nga trupa të pavarur mbikëqyrës. Roli i parlamentit dhe i qeverisë është vetëm që të vendosë kuadrin ligjor për shërbimet e mediave publike dhe asnjëherë të mos ndërhyjë në çështje operationale dhe të mbikëqyrjes. Në këtë kuptim, raporti vëren se është e rëndësishme që roli qendror i trupave mbikëqyrës të mos minohet nga mekanizma paralel ose të mbivendosur të llogaridhënies (shih, *Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike*, fq. 20).

(iv) *praktika relevante gjyqësore e GjEDNj-së*

133. Në fund, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, me theks në rastin [*Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*](#), dhe në të cilin, GjEDNj shqyrtoi pretendimet e parashtruesve për shkelje mes tjerash, edhe të lirisë së tyre të shprehjes, të garantuar me nenin 10 të KEDNj-së. Më saktësisht, parashtruesit, gazetarë të punësuar në “Teleradio-Moldova” (TRM), kompani në pronësi shtetërore dhe njëherësh televizioni dhe radioja e vetme në Moldavi, pretenduan para GjEDNj-së se përgjatë kohës sa kishin punuar si gazetarë në TRM, kishin qenë subjekte të një regjimi të censurës nga ata e shtetit të Moldavisë. Megjithëse rrethanat e rastit dallojnë nga rrethanat e rastit konkret, Gjykata sjell në vëmendje zbërthimin që GjEDNj i bën nenit 10 të KEDNj-së në kontekst të obligimeve pozitive të shtetit dhe të disa parimeve që ndërliken me transmetuesit publikë.
134. Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesve, për atë sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, GjEDNj fillimisht theksoi rëndësinë qenësore të lirisë së shprehjes të garantuar me nenin 10 të KEDNj-së, si një nga shtyllat e shoqërisë demokratike dhe një nga kushtet thelbësore për zhvillim të shoqërisë (paragrafi 96). Duke u referuar në praktikën e mëparshme, në rastet [*Özgür Gündem kundër Turqisë*](#), [*Fuentes Bobo kundër Spanjës*](#) dhe [*Appleby dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*](#), aktgjykimi në fjalë thekson se të ushtruarit e lirisë së shprehjes në mënyrë efektive dhe kuptimplotë, nuk kushtëzohet vetëm nga obligimi për mosndërhyrje nga ana e shtetit, por gjithashtu nga obligimi pozitiv i shtetit për të siguruar masa pozitive të mbrojtjes, përmes ligjit dhe praktikës (shih, për më tepër rastin e GjEDNj-së [*Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*](#), cituar më lart, paragrafi 99).
135. Për sa i përket fushës së transmetimit audio-vizual, obligimet e këtyra pozitive, sipas rastit përkatës të GjEDNj-së, nënkuptojnë detyrimin e shtetit që së pari t’i sigurojë publikut qasje përmes televizionit dhe radios në informacione të paanshme dhe të sakta, si dhe një varg mendimesh e komentesh që reflektojnë, ndër tjerash, këndvështrimet e ndryshme politike në vend. Së dyti, nënkupton obligimin e shtetit që të sigurojë se gazetarëve dhe profesionistëve tjerë që punojnë në media audio-vizuale, të mos u pamundësohet transmetimi i informacioneve dhe komenteve. Gjykata e Strasburgut më tej vërejtë se mënyrat e realizimit të këtyre qëllimeve varen gjerësisht nga rrethanat vendore, prandaj shtetet gëzojnë një kuadër të gjerë vlerësimi (shih, [*Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*](#), cituar më lart, paragrafi 100).
136. Thënë këtë, përderisa GjEDNj ka vërejtur se një sistem i shërbimit të transmetimit publik i kontribuon cilësisë dhe balancimit programor, neni 10 i KEDNj-së nuk obligon shtetet që të krijojnë transmetues publik, përderisa përdoren mënyra tjera drejt realizimit të obligimeve pozitive si më sipër (shih, [*Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*](#), cituar më lart, paragrafi 100). Megjithatë, në rastet kur shteti krijon një transmetues publik, në frymën e parimeve të përvijuara më sipër, ligji i brendshëm dhe praktika, duhet të garantojnë ofrimin e një shërbimi pluralist (shih, [*Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*](#), cituar më lart, paragrafët 101 dhe 107). Sidomos në rastet dhe në rrethanat kur stacionet private ende janë më pak të zhvilluara dhe si rrjedhojë, dominon transmetuesi publik është parakusht themelor i funksionimit të demokracisë që ky i fundit të transmetojë në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe të ofrojë një forum të diskutimit publik në të cilin mund të shprehet një spektër i gjerë i pikëvështrimeve dhe mendimeve (shih, [*Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*](#), cituar më lart, paragrafi 101).
137. Në këtë kontekst, Aktgjykimi në rastin *Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*, i referohet instrumenteve të ligjit të butë të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, paraqitur më sipër në këtë Aktgjykim, duke theksuar, ndër tjerash, se “Gjykata vëren se përmes *“Rezolutës nr. 1 mbi të Ardhmen e Shërbimit Publik të*

Transmetimit Radio Televiziv" (1994), Shtetet pjesëmarrëse morën përsipër detyrimin "për të garantuar pavarësinë e transmetuesve publikë ndaj ndërhyrjeve politike dhe ekonomike". Për më tepër, në Shtojcën e Rekomandimin nr. R(96) 10 mbi "Garantimin e pavarësisë së transmetuesve të shërbimit publik" (1996), Komiteti i Ministrave miratoi një numër udhëzimesh të hollësishme që synonin të siguronin pavarësinë e transmetuesit publik. Këto përfshinin rekomandimin se "kuadri ligjor që rregullon aktivitetin e kompanive që ofrojnë shërbimin publik të transmetimit duhet të përcaktojë qartësisht pavarësinë e tyre redaksionale dhe autonominë institucionale", (...) Udhëzimet theksonin gjithashtu se, dispozitat që rregullojnë statusin dhe emërimin e anëtarëve të bordeve të menaxhimit dhe të organeve mbikëqyrëse të transmetuesve të shërbimit publik duhet të përcaktohen në një mënyrë që shmangin rrezikun e ndërhyrjeve politike apo të llojeve të tjera." (par. 103). Aktgjykimi thekson se standardet e zhvilluara nga Komiteti i Ministrave, duhet të shërbejnë si udhëzues për qasjen që duhet ndjekur për të interpretuar nenin 10 të KEDNj-së në këtë fushë (shih, [Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë](#), cituar më lart, paragrafi 107).

138. Përfundimisht, GjEDNj kishte gjetur shkelje të nenit 10 të KEDNj-së, ndër tjerash, për shkak se autoritetet moldave kishin dështuar të përmbushin obligimet pozitive në dritën e nenit 10 të KEDNj-së, për shkak se kuadri ligjor nuk kishte ofruar mbrojtje të mjaftueshme ndaj ndërhyrjeve politike në menaxhmentin e lartë të TRM-së dhe rrjedhimisht, edhe në politikat redaktoriale të saj.

II. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar të Kuvendit

139. Bazuar në parimet shtjelluara më lart, Gjykata në vijim do të shtjellojë (i) ndërveprimin në mes Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe transmetuesit publik, përkatësisht RTK-së, bazuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës dhe dispozitave relevante të Ligjit për RTK-në; më pas do të vlerësojë (ii) nëse Kuvendi përmes Aktit të kontestuar ka tejkaluar kompetencën e mbikëqyrjes në shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së; dhe në fund do të sqarojë çështjet që ndërlidhen me (iii) pretendimet tjera të parashtruesve të kërkesës; (iv) kërkesën për masë të përkohshme; dhe (v) efektin e Aktgjykimit.

(i) ndërveprimi në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Transmetuesit Publik – RTK-së

140. Duke vënë theks në parimet kushtetuese dhe ato të përcaktuara përmes standardeve ndërkombëtare në fushën e lirisë dhe pluralizmit të mediave edhe në kontekst të transmetuesve publikë, dhe të cilat vënë theks, ndër tjerash, në rëndësinë e pavarësisë dhe ushtrimin e mbikëqyrjes, përfshirë parlamentare, bazuar në kritere të përcaktuara saktë përmes ligjeve përkatëse, por në të njëjtën kohë edhe rëndësinë dhe detyrimin e transmetuesve publikë për transparencë dhe llogaridhënie, Gjykata në vijim, do të shtjellojë ndërveprimin në mes të Kuvendit të Kosovës dhe transmetuesit publik, përkatësisht RTK-së, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës dhe Ligjit për RTK të miratuar nga vet Kuvendi, dhe në kuadër të të cilit, bazuar në paragrafin e lartcekur, Kuvendi ushtron funksionin e tij mbikëqyrës mbi RTK-në.
141. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht vë theks në faktin që bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës, Kuvendi ka miratuar Ligjin për RTK-në. Bazuar në të njëjtin Ligj, dhe marrë parasysh rëndësinë e lirisë së medias dhe pavarësinë e transmetuesit publik në Republikën e Kosovës, përkatësisht RTK-së, Kuvendi i Republikës së Kosovës, vet ka përcaktuar (i) parimet e kësaj pavarësie; dhe (ii) mënyrën e mbikëqyrjes së RTK-së, përfshirë kufizimet përkatëse.

142. Fillimisht dhe përkritazi me pavarësinë institucionale të RTK-së, Kuvendi, përmes Ligjit të lartcekur, ka përcaktuar dy dispozita të rëndësishme të veçantë, përkatësisht (i) në nenin 3 (Radiotelevizioni i Kosovës), ka përcaktuar që *“RTK është person juridik jo i profitabil me status të institucionit të pavarur publik me rëndësi të posaçme”*; dhe (ii) në nenin 4 (Themeluesi i Radiotelevizionit të Kosovës) të tij, ndër tjerash, ka përcaktuar që Kuvendi i Republikës së Kosovës është themelues i RTK-së dhe ka përgjegjësinë për *“të mbrojtur autonominë institucionale dhe siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-së të përcaktuar me këtë ligj”*.
143. Në anën tjetër, përkritazi me mbikëqyrjen e funksionimit të RTK-së, Kuvendi përmes neneve 37 (Mbikëqyrja e funksionimit të RTK-së) dhe 39 (Karakter i publik i veprimtarisë) të Ligjit për RTK-në, ka përcaktuar parimet e përgjithshme të mbikëqyrjes dhe transparencës së RTK-së. Fillimisht në nenin 37 të tij, ka përcaktuar, ndër tjerash, që mbikëqyrja e veprimtarisë së RTK-së, kryhet nga organet e autorizuar për një gjë të tillë nga ligji dhe Statuti. Për këtë qëllim, ka saktësuar që një trup i auditorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e rregullsisë dhe përputhshmërisë së veprimeve dhe auditimit e akteve dhe veprimeve të planifikuara të RTK-së në kuadër të kornizës së kompetencave që i ushtron mbi subjektet që kryejnë veprimtari publike. Më tej, dhe në saktësimin e rolit të vet Kuvendit, neni i lartcekur i Ligjit për RTK-në, ka saktësuar që përveç personave të autorizuar për të kërkuar përgjegjësi në emër të anëtarëve të organeve menaxhuese dhe mbikëqyrëse të përcaktuara nga ligji, edhe Kuvendi i Kosovës gjithashtu është i autorizuar të kërkojë një përgjegjësi të tillë.
144. Për më tepër, neni 38 (Karakter i publik i veprimtarisë) i Ligjit për RTK-në, përcakton veprimtarinë publike të RTK-së. Në këtë kontekst dhe me theks në Raportin Vjetor të RTK-së, relevant në rrethanat e rastit konkret sepse refuzimi i miratimit të tij nga Kuvendi ka rezultuar në procesin e shkarkimit të të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së, vet Ligji i miratuar nga Kuvendi thekson që (i) Raporti vjetor duhet të publikohet në mënyrën e përcaktuar me Statut dhe duhet të përmbajë një ndarje të shpenzimeve të ofrimit të shërbimeve, përmbajtjes ose kanaleve nga grupet individuale apo përmbajtjes programore dhe të raportit të Bordit të RTK-së; (ii) Raporti vjetor duhet të publikohet në faqen e internetit të RTK-së; (iii) RTK-ja, një herë në vit, organizon një debat publik mbi përmbajtjen e raportit vjetor dhe përpilon një raport mbi debatin, të cilin do t’ia dorëzojë Bordit të RTK-së; dhe (iv) RTK do t’ia dërgojë raportin vjetor, raportin mbi debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së në raportin e debatit publik për qëllime orientuese, Kuvendit të Republikës së Kosovës. Detyrimi për t’i dorëzuar Kuvendit Raportin vjetor në kontekst të burimeve të financimit, është i përcaktuar edhe me nenin 21 (Burimet e financimit) të Ligjit për RTK-në.
145. Roli i Kuvendit dhe ndërveprimi përkatës me Bordin e RTK-së është i përcaktuar edhe në (i) nenin 22 (Parapagimi) të Ligjit për RTK-në, ndër tjerash, në kontekst të tarifës së abonimit; (ii) nenin 29 (Kompetencat e Bordit të RTK-së) të Ligjit për RTK-në, në kontekst të miratimit të buxhetit vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe të personelit tjetër, gjithashtu me kompetencën për të siguruar që shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare dhe detyrimit që raportet financiare t’i dërgohen Kuvendit, *“për trajtim dhe veprim”*; dhe (iii) nenin 30 (Veprimtaria dhe mënyra e punës së Bordit të RTK-së) të Ligjit për RTK-në, në kontekst të detyrimit të Bordit të RTK-së për t’i raportuar themeluesit, përkatësisht Kuvendit, në mënyrë të rregullt dhe të jashtëzakonshme.
146. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata vëren që Kuvendi, si themelues i RTK-së bazuar në Ligjin për RTK-në, në miratimin e këtij të fundit, në fakt ka garantuar pavarësinë institucionale të RTK-së, duke marrë përsipër edhe mbrojtjen e autonomisë së saj, dhe duke e kufizuar rolin e tij mbikëqyrës, në parim, në rrethanat e përcaktuara në nenet 22, 29, 37 dhe 38 të Ligjit për RTK-në, përkatësisht (i) në kërkimin e përgjegjësisë së

“mbikëqyrjen e rregullsisë dhe përputhshmërisë së veprimeve dhe auditimin e akteve për veprimet dhe akteve për veprimet e planifikuara të RTK-së në kuadër të kornizës së kompetencave që i ushtron mbi subjektet që kryejnë veprimtari publike në kontekst të nenit 37 të Ligjit për RTK-në”; (ii) në pranimin e raportit vjetor, raportin mbi debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së në raportin e debatit publik “për qëllime orientuese”; (iii) miratimin e buxhetit të RTK-së; dhe (iv) miratimin e mekanizmit për mbledhjen e tarifës së abonimit, përfshirë nivelin e tarifës në mënyrën e saktësuar në këtë ligj.

147. Gjykata vëren që bazuar në dispozitat e Ligjit për RTK-në, përderisa ky i fundit, specifikisht përcakton kompetencën e Kuvendit për të miratuar buxhetin e RTK-së dhe *“mekanizmin për mbledhjen e tarifës së abonimit”*, kompetenca e miratimit nuk është e përcaktuar përkitazi me raportin vjetor të RTK-së, dhe i cili bazuar në nenin 38 të Ligjit, së bashku me raportin mbi debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së në raportin e debatit publik, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës *“për qëllime orientuese”*.
148. Përtej dispozitave të lartcekura, Ligji për RTK-në gjithashtu përcakton rolin e Kuvendit për përzgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së. Në këtë kontekst, janë relevante, nenet 26 (Zgjedhja e anëtarëve të Bordit) dhe 28 (Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit) të Ligjit për RTK-në. E para përcakton zgjedhjen e anëtarëve të Bordit, ndërsa e dyta shkarkimin dhe dorëheqjen e anëtarit të Bordit.
149. Përkitazi me zgjedhjen e anëtarëve të Bordit, neni 26 i Ligjit për RTK-në, përcakton ndër tjerash, mënyrën e shpalljes së vendeve të lira, shqyrtimin e aplikacioneve dhe intervistimin e kandidatëve dhe zgjedhjen e tyre nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Është më rëndësi të theksohet që neni 26 i Ligjit për RTK-në, përcakton mandate me kohëzgjatje të ndryshme të anëtarëve të Bordit, përkatësisht duke theksuar që katër (4) anëtarë të Bordit të RTK-së do të emërohen me mandat dy (2) vjeçar, katër (4) anëtarë me mandat tre (3) vjeçar dhe tre (3) anëtarë me mandat katër (4) vjeçar, dhe përcaktimi i kohëzgjatjes së mandatit nga secili grup do të bëhet me short. Qëllimi i kësaj norme dhe një rregullimi të tillë nga vet Kuvendi, ndërlidhet pikërisht me nenet 3 dhe 4 të Ligjit për RTK-në respektivisht, përkatësisht pavarësinë dhe autonominë e transmetuesit publik dhe rëndësinë që anëtarët e Bordit të RTK-së të reflektojnë pluralizëm në kontekst të shumicës së Kuvendit e cila i ka zgjedhur. Një qasje e tillë është në përputhje edhe me Raportin e EBU *“Fokusi juridik: Parimet e qeverisjes së shërbimit publik të medias”*, publikuar në dhjetor 2021, të shtjelluar më lart.
150. Për këtë qëllim janë të rëndësishme të theksohen edhe dy dispozita, përkatësisht neni 25 (Përbërja e Bordit) dhe neni 27 (Pamundësia për të qenë anëtarë i Bordit). Këto dy dispozita, ndër tjerash, përcaktojnë kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e Bordit dhe papajtueshmërinë e funksionit përkatës. I pari, ndër tjerash, përcakton se anëtarët e Bordit të RTK-së janë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme, duhet të jenë individë me kredibilitet dhe autoritet të lartë njerëzor, profesional dhe moral; emërohen dhe veprojnë në kapacitetin e tyre personal dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes jashtë RTK-së, përveç interesit të publikut dhe nuk lejohet të kërkojnë apo pranojnë asnjë instruksion në lidhje me aktivitetet e Bordit nga asnjë interes jashtë RTK-së. Ndërsa i dyti, përkatësisht pamundësia për të qenë anëtar i Bordit, ndër tjerash, përcakton rrethanat të cilat janë të papajtueshme me funksionin e anëtarit të Bordit të RTK-së.
151. Përkitazi me shkarkimin e anëtarëve të Bordit, neni 28 i Ligjit për RTK-në, përcakton (i) procedurën; dhe (ii) bazën e shkarkimit. Përkitazi me të parën, përkatësisht procedurën, neni i lartcekur saktëson që (i) propozimi për shkarkim vjen nga Bordi i RTK-së, me kërkesën e shumicës së thjeshtë të numrit të anëtarëve të Bordit ose të

ndonjë iniciative tjetër nga jashtë dhe se në raste të tilla, Kuvendi i Kosovës, me shumicë të thjeshtë, do të vendosë për shkarkimin ose jo të anëtarit të Bordit. Gjykata vëren që përderisa kompetenca e Kuvendit për të vendosur rreth propozimit për shkarkim ose jo është saktësisht e përcaktuar në ligj, ky nuk është rasti edhe me kompetencën për të iniciuar procedurën e shkarkimit, dhe të cilit ligji ia njeh vet Bordit të RTK-së dhe/ose “*ndonjë iniciative tjetër nga jashtë*”. Ndërsa, përkitazi me të dytën, përkatësisht bazat e shkarkimit, Ligji përcakton bazat për shkarkimin e anëtarit të RTK-së, përkatësisht (i) paaftësisë profesionale - nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t'i përmbushë detyrat e anëtarit të Bordit; (ii) paaftësisë mentale apo fizike për të kryer detyrat e anëtarit; (iii) nëse anëtari nuk i përmbush kushtet sipas nenit 26 të këtij ligji, nen ky i cili në fakt përcakton mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të RTK-së; (iv) ka dështuar në realizimin e detyrave të tij/saj për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se tre (3) muajve pa aprovim nga Bordi; (v) nëse anëtari është dënuar për veprë penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg; (v) nëse anëtari nuk i përmbush kushtet sipas nënparagrafëve 1.3, 1.4 dhe 1.5 të paragrafit 1 të nenit 27 të këtij ligji, nen ky që ndërlidhet me pamundësinë për të qenë anëtarë i Bordit përkatës, përkatësisht papajtueshmërinë me funksionin; (vi) mungesës në punë mbi një (1) muaj pa arsye; dhe (vii) pjesëmarrjen aktive në aktivitete politike pasi që është emëruar si anëtar i Bordit.

152. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, Bordi i transmetuesit publik është shkarkuar kolektivisht për “*paaftësi profesionale*” përkatësisht, sipas definicionit të vet Ligjit, sepse në “*mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi kanë dështuar t'i përmbushin detyrat e anëtarit të Bordit*” dhe siç është sqaruar më lart, procedura e propozimit për shkarkim është iniciuar në Kuvend, nga dy Komisione të Kuvendit, Komisioni për Administratë Publike dhe ai për Buxhet, respektivisht, pas shqyrtimit të Raportit Vjetor të RTK-së dhe rekomandimit që miratimi i të njëjtit të refuzohet. Në këtë kontekst, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata duhet të vlerësojë nëse Kuvendi ka tejkaluar autorizimet kushtetuese dhe ligjore në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes, të përcaktuar përmes paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës, duke shkarkuar në mënyrë kolektive Bordin e transmetuesit publik, përkatësisht RTK-së, përmes refuzimit të miratimit të raportit vjetor dhe konstatimit që ka vijuar se Bordi i RTK-së është në tërësinë e tij i “*paaftë profesionalisht*”.

(ii) nëse Kuvendi përmes Aktit të kontestuar ka tejkaluar kompetencën e mbikëqyrjes në shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së

153. Në këtë kontekst, Gjykata, rikujton paragrafin 2 të nenit 3 të Ligjit për RTK-në, sipas të cilit, RTK-ja, duke qenë transmetuesi publik i Republikës së Kosovës është “*institucion i pavarur publik me rëndësi të posaçme*”. Për më tepër, bazuar në paragrafin 2 të nenit 4 të Ligjit për RTK-në, Kuvendi i ka përcaktuar vetes detyrimin që të mbrojë autonominë e këtij institucioni. Siç është paraqitur më sipër, jurisprudenca e GjEDNj-së dhe një varg instrumentesh e aktesh të ligjit të butë të Komitetit të Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, raporte të Komisionit të Venecias dhe raporte të organizatave profesionale ndërkombëtare, shquajnë rolin e transmetuesit publik për t'i shërbyer interesit publik dhe vënë theksin në mbrojtjen e pavarësisë së transmetuesit publik, si parim primar dhe njëkohësisht si sfidë e vazhdueshme e transmetuesve publikë. Siç theksohet në Aktgjykimin e GjEDNj-së në rastin *Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*, përderisa sipas nenit 10 të KEDNj-së shtetet nuk janë të obliguara të krijojnë transmetues publikë, në rastet kur ato krijojnë transmetues publikë, siç është RTK-ja në Republikën e Kosovës, shteti ka obligim pozitiv që të garantojë ofrimin e shërbimit pluralist dhe mbrojtje të mjaftueshme ndaj ndërhyrjeve politike dhe të tjera (shih, *Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*, cituar më lart, paragrafët 100 dhe 101).

154. Për më tepër, Gjykata rikujton që çështja e kompetencës së pushtetit shtetëror për të emëruar dhe shkarkuar anëtarët e organit mbikëqyrës të transmetuesit publik është e lidhur ngushtë me çështjen e pavarësisë së këtij të fundit. Këtë e theksojnë edhe rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Më saktësisht, Rekomandimi mbi “*Garantimin e pavarësisë së shërbimit të transmetimit publik*”, thekson se anëtarët e këtyre organeve: “[...] nuk mund të shkarkohen, pezullohen ose zëvendësohen, gjatë mandatit të tyre nga ndonjë person ose organ tjetër përveç atij që i ka emëruar ata, përveç në raste kur organi mbikëqyrës rregullisht ka vërtetuar se ata janë të paafte ose janë penguar në ushtrimin e funksionit të tyre” (shih pjesën III, pikën 2. “Statusi” të Rekomandimit nr. R(96) 10, fq. 3). Ndërkaq, Rekomandimi mbi “*Qeverisjen e mediave publike*”, ndër tjerash, thekson se emërimet e anëtarëve të organit mbikëqyrës të transmetuesit publik duhet të bëhen për mandat të caktuar, i cili mund të shkurtohet në rrethana të kufizuara dhe të saktësuara në ligj, e që nuk duhet të përfshijnë ndryshimet në pikëpamje sa i përket pozitave redaksionale ose vendimmarrjes (shih, [Rekomandimi CM/Rec \(2012\) 1](#), cituar më lart, paragrafi 27).
155. Gjykata, gjithashtu rikujton që bazuar në përgjigjet e dorëzuara në Gjykatë nga Gjykatat Kushtetuese ose ekuivalentët përkatës, përkitazi me transmetuesit publikë dhe/ose bordet/strukturat mbikëqyrëse dhe menaxheriale përkatëse, ka rregullime të ndryshme. Me përjashtim të Lihtenshtajnit që reflekton rregullime më specifike, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, në parim, anëtarët e bordeve/strukturave mbikëqyrëse të transmetuesve publikë, mund të shkarkohen sipas përcaktimeve të ligjeve të aplikueshme. Emëruesi i përbashkët i bazave/mundësive ligjore për shkarkimin e anëtarëve të bordeve/strukturave mbikëqyrëse të transmetuesve publikë, në parim, por me përjashtime, siç është rasti i Austrisë, reflektojnë (i) baza të sakta ligjore, siç janë, ndër tjerash, mospjesëmarrja në bordet/strukturat mbikëqyrëse përkatëse për periudha të caktuara kohore, apo/edhe dënime për vepër penale; dhe (ii) kriterit të papajtueshmërisë me mbajtjen e funksionit përkatës, përfshirë anëtarësinë në parti politike. Kriteret e natyrës më të përgjithshme, janë të përfshira në rastin e Çekisë, sipas ligjit përkatës të së cilës, anëtari përkatës i Bordit të Transmetuesit Publik, mund të shkarkohet, ndër tjerash, (i) nëse ai/ajo nuk i plotëson më kërkesat për kryerjen e detyrave të një anëtari të Bordit të përcaktuara në nenin 5; dhe (ii) nëse ai/ajo ka cenuar rëndë dinjitetin e detyrës së një anëtari tjetër të Bordit ose nëse ai/ajo ka kryer sjellje që vë në pikëpyetje pavarësinë ose paanësinë e tij/saj në kryerjen e detyrave të tij/saj si anëtar/e i/e Bordit. Përderisa, baza ligjore të ngjashme me kriterin e “*paqftësisë profesionale*” ekzistojnë në disa nga ligjet e aplikueshme, përfshirë Kroacinë, të njëjtat sipas përgjigjeve përkatëse, aplikohen vetëm për shkarkime individuale.
156. Në anën tjetër, mundësia e shkarkimit të bordit/strukturës mbikëqyrëse në tërësinë e saj, është e mundur sipas përgjigjeve përkatëse atëherë kur është e përcaktuar saktësisht në ligjin e aplikueshëm përkatës. Ky është rasti, ndër tjerash, me Afrikën e Jugut, ku mundësia për shkarkimin e tërë Bordit përkatës, është saktësisht e përcaktuar me ligj. Gjithashtu, duhet vënë theks në dy përgjigje tjera të shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, dhe bazuar në ligjet e aplikueshme të të cilave, shkarkimit i tërësishëm i bordeve/strukturave mbikëqyrëse të Transmetuesve Publikë është i mundur, siç është rasti i Sllovakisë dhe Çekisë, respektivisht. Thënë këtë, në të dy rastet, edhe mundësia për shkarkimin e tërë bordit/strukturës mbikëqyrëse, edhe baza ligjore dhe rrethanat në të cilat ky mund të jetë rasti, janë të përcaktuara shprehimisht me ligjin e aplikueshëm. Më saktësisht, në rastin e Sllovakisë shkarkimi i Bordit si trup, mund të bëhet në dy raste, përkatësisht (i) kur Parlamenti Sllovak miraton dy (2) rezoluta brenda gjashtë (6) muajve, me të cilat shprehet se Bordi nuk është duke i ushtruar detyrat sipas ligjit; dhe (ii) kur Bordi refuzon tri (3) herë radhazi të miratojë projektbuxhetin për transmetuesin publik të prezantuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe ka iniciuar para komitetit përkatës parlamentar shkarkimin e Drejtorit, mirëpo

Parlamenti ka vendosur që të mos e shkarkojë atë. Ndërsa në rastin e Çekisë, shkarkimi kolektiv është i mundshëm, nëse bordet në mënyrë të përsëritur dështojnë në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas ligjit ose nëse Dhoma e Deputetëve nuk e miraton raportin vjetor mbi aktivitetet e Televizionit Çek ose Radios Çeke ose raportin vjetor mbi menaxhimin e Televizionit Çek ose Radios Çeke dy herë në një vit rresht në mënyrën e përcaktuar në ligjin përkatës.

157. Gjykata thekon që nuk është kontestuese që njëra nga kompetencat e Kuvendit, e përcaktuar me Ligjin e RTK-së, është edhe shkarkimi i anëtarëve të Bordit të RTK-së në rrethanat të cilat i përcakton neni 28 i Ligjit për RTK-në. Kompetenca për shkarkimin e anëtarëve të bordeve/strukturave mbikëqyrëse të transmetuesve publikë është e mundur edhe sipas parimeve ndërkombëtare të referuar në këtë Aktgjykim, e edhe sipas përgjigjeve të dorëzuara në Gjykatë përmes Forumit të Komisionit të Venecias, siguron për atë që është respektuar Kushtetuta dhe/ose ligji, dhe rrjedhimisht, edhe pavarësia e transmetuesit përkatës publik. Thënë këtë, në rrethanat e rastit konkret, çështje kontestuese është nëse Kuvendi, në ushtrimin e kompetencës së mbikëqyrjes, ka pasur autorizimin ligjor që vet të rekomandojë dhe shkarkojë njëkohësisht të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së, përmes refuzimit të miratimit të Raportit Vjetor për vitin 2020 dhe mbi bazën e “*paafhtësisë profesionale*”.
158. Në këtë kontekst, Gjykata vëren që, Komisionet përkatëse të Kuvendit që kanë rekomanduar shkarkimin kolektiv të anëtarëve të Bordit të transmetuesit publik, kanë argumentuar, ndër tjerash, përdorimin e shumës në formulimin e nenit 28 të Ligjit, ndërsa parashtruesit e kërkesës, kanë argumentuar të kundërtën, përkatësisht përdorimin e njëjës në formulimin e nenit 28 të Ligjit për RTK-në, për të argumentuar dhe kundërgjyqur nëse Kuvendi ka pasur kompetencën për të shkarkuar kolektivisht Bordin e RTK-së. Gjykata vëren se neni 28 i Ligjit për RTK-në, (i) përdorë njëjës në përcaktimin e inicimit të procedurës për shkarkimin e anëtarit të RTK-së, në paragrafin 1 dhe 2 të tij; ndërsa (ii) edhe njëjës edhe shumës, në përcaktimin e bazave për shkarkimin përkatës. Thënë këtë, Gjykata thekson që nëse Ligji për RTK-në mundëson shkarkimin individual apo kolektiv të anëtarëve të Bordit të RTK-së, duhet të vlerësohet në leximin e përbashkët të të gjitha dispozitave të Ligjit për RTK-në dhe standardeve të aplikueshme që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare dhe jo në interpretim i cili reduktohet dhe/ose në mënyrë tejet formaliste fokusohet në përdorimin gjuhësor të njëjës apo shumës në një nen të vetëm të Ligjit për RTK-në. Në këtë kontekst, Gjykata vë theks në faktin që në përputhje me standardet ndërkombëtare, çështja e përcaktimit të saktë të bazave për shkarkim të organit mbikëqyrës të transmetuesit publik, lidhet ngushtë me ruajtjen e pavarësisë së transmetuesve publikë, si parim dhe vlerë themelore e tyre. Siç përcakton Rekomandimi i Komitetit të Ministrave mbi “*Qeverisjen e mediave publike*”, bazat e shkarkimit të organit mbikëqyrës të transmetuesit publik duhet të përcaktohen saktësisht dhe në mënyrë të qartë në ligj (shih, *Rekomandimi nr. R (96) 10*, cituar më lart, paragrafi 27).
159. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton faktin që (i) bazuar në paragrafin 2 të nenit 3 dhe 4 të Ligjit për RTK-në, RTK-ja është “*institucion i pavarur publik me rëndësi të posaçme*”; dhe (ii) pavarësia e këtij institucioni, nënkupton detyrimisht edhe pavarësinë e anëtarëve të Bordit të tij, në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara, ndër tjerash, në nenet 29 dhe 30 të Ligjit për RTK-në, respektivisht. Pikërisht për këtë arsye, Ligji përcakton kritere të sakta për përzgjedhjen e anëtarëve të RTK-së, të përcaktuara në nenin 26 të Ligjit dhe papajtueshmërinë e funksionit, siç është përcaktuar në nenin 27 të Ligjit.
160. Më tej, Gjykata vë theks në paragrafin 5 të nenit 25 (Përbërja e Bordit) të Ligjit për RTK-në dhe i cili specifikisht përcakton se “*Anëtarët e Bordit emërohet dhe veprojnë në*

kapacitetin e tyre personal dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes jashtë RTK-së përveç interesit publik. (...)". Të ushtruarit e funksionit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet përkatëse, të anëtarëve të bordeve të tilla në kapacitetin personal/individual e thekson edhe Rekomandimit nr. R (96) 10 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Garantimin e Pavarësisë së Transmetuesve Publikë.

161. Përderisa, Ligji specifikisht vë theks në "*kapacitetin individual*" të secilit anëtar të Bordit të RTK-së, Gjykata gjithashtu vëren se përmes paragrafit 3 të nenit 26 të ligjit në fjalë, është përcaktuar një mënyrë e tillë e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit të RTK-së, me mandate me kohëzgjatje të ndryshme, ashtu që të sigurohet vazhdimësia e Bordit si organ mbikëqyrës i RTK-së, por edhe të zvogëlohet mundësia që të gjithë anëtarëve t'ju skadojë mandati njëkohësisht, dhe meqenëse anëtarësia zgjidhet nga një shumicë e thjeshtë parlamentare, të zvogëlohet mundësia e politizimit të Bordit, përmes zgjedhjes së tyre nga e njëjta shumicë parlamentare. Pra, përmes kësaj dispozite, ligjbërësi ka përcaktuar mekanizëm për të siguruar (i) vazhdimësinë e Bordit të RTK-së, si organ mbikëqyrës dhe me rëndësi esenciale për funksionimin e rregullt dhe mbarëvajtjen e punës së RTK-së, si transmetues publik; dhe për të siguruar (ii) pavarësinë e RTK-së, si parim primar për rregullimin dhe funksionimin e një transmetuesi publik. Një mënyrë e tillë e zgjedhjes, me mandate që parimisht mund të kenë kohëzgjatje të njëjtë, por që nuk fillojnë dhe përfundojnë në të njëjtën kohë, përmendet gjithashtu nga raportet e Observatorit Audiovizual Evropian dhe ato të Unionit Evropian të Transmetuesve (shih, *Raporti IRIS Plus*, citur më lart, fq. 5 dhe Raportin "Fokusi Juridik: Parimet e Qeverisjes së Shërbimit të Medias Publike", e *Unionit Evropian të Transmetuesve*, cituar më lart, fq. 13).
162. Si rrjedhojë, Ligji për RTK-në përcakton se anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen për të shërbyer në kapacitet individual dhe prandaj, edhe shkarkimi i tyre për cilëndo nga bazat sipas paragrafit 1 të nenit 28 të Ligjit për RTK-në, mund të bëhet pasi të jetë dëshmuar se ekziston përgjegjësia individuale e anëtarit të caktuar, duke u bazuar në njërën nga bazat e përcaktuara ligjore që e mundëson shkarkimin. Për më tepër, dhe siç është sqaruar në përgjigjet e pranuar nga Forumi i Komisionit të Venecias, në rrethanat në të cilat ligjet e aplikueshme të shteteve përkatëse kanë mundësuar shkarkimin kolektiv të bordeve/strukturave mbikëqyrëse përkatëse, kanë përcaktuar saktësisht procedurën dhe bazën ligjore mbi të cilën është i mundur shkarkimi kolektiv për dallim nga ai individual. Ky nuk është rasti me nenin 28 të Ligjit për RTK-në.
163. Për më tepër, Gjykata vë theks në faktin që shkarkimi kolektiv i anëtarëve të Bordit të RTK-së është arsyetuar mbi bazën e "*paaftësisë profesionale*" të të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së, dhe "*paaftësia profesionale*" është argumentuar nga Komisionet përkatëse të Kuvendit përmes shqyrtimit të Raportit Vjetor të RTK-së për vitin 2020.
164. Në këtë kontekst, Gjykata së pari, rikujton që çështja e Raportit Vjetor të RTK-së, është paraparë në nenin 38 (Karakter i veprimtarisë) të Ligjit për RTK-në. Ky nen saktësisht përcakton që (i) Raporti Vjetor duhet të publikohet në mënyrën e përcaktuar me statut dhe duhet të përmbajë një ndarje të shpenzimeve të ofrimit të shërbimeve, përmbajtjes ose kanaleve nga grupet individuale apo përmbajtjes programore dhe të raportit të Bordit të RTK-së; (ii) Raporti vjetor duhet të publikohet në faqen e internetit të RTK-së; (iii) RTK-ja, një herë në vit, organizon një debat publik mbi përmbajtjen e raportit vjetor dhe përpilon një raport mbi debatin, të cilin do t'ia dorëzojë Bordit të RTK-së; dhe (iv) RTK do t'ia dërgojë raportin vjetor, raportin mbi debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së në raportin e debatit publik për qëllime orientuese, Kuvendit të Republikës së Kosovës.
165. Gjykata, së pari vëren që bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit në fuqi në kohën kur janë shkarkuar të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së, përkatësisht nenit 72

(Procedurat e veçanta për raportet e organeve të pavarura) të saj, shqyrtimi i raportit vjetor të organit përkatës të pavarur, *“përmbillet me votimin për miratim”*. Thënë këtë, Gjykata thekson që në asnjë dispozitë të Ligjit për RTK-në, nuk përcaktohet kompetenca e Kuvendit për të refuzuar dhe/ose miratuar Raportin Vjetor të RTK-së. Kjo për dallim nga rastet, kur ligjvënësi, përkatësisht Kuvendi, përmes miratimit të Ligjit për RTK-në, ka saktësuar kompetencën e tij të miratimit, përkatësisht në rrethanat e (i) mekanizmit për mbledhjen e tarifës së abonimit menjëherë pas miratimit nga Kuvendi; dhe (ii) buxhetin e RTK-së.

166. Së dyti, Gjykata vëren që Raporti i EBU *“Fokusi juridik: Parimet e qeverisjes së shërbimit publik të medias”* vëren se ekzistojnë sisteme në të cilat menaxhmenti i transmetuesit publik shkarkohet në rast të refuzimit të raportit vjetor nga ana e Kuvendit, pasi i njëjti t’i jetë prezantuar një komiteti parlamentar. EBU përmes këtij raporti tërheq vërejtjen se këto sisteme hapin rrugë për ndërhyrje të papërshtatshme politike, nënvlerësojnë rolin e trupit mbikëqyrës dhe mund të çojnë në vet-censurim të përmbajtjes redaksionale dhe të shkarkojnë jostabilitet të nivelit menaxherial. Në këtë kontekst, EBU, ndër tjerash thekson që, *“disa vende parashikojnë që menaxhmenti shkarkohet nëse raporti vjetor refuzohet nga parlamenti, pas prezantimit të tij nga drejtuesit e shërbimit publik të medias në një komision parlamentar. Një sistem i tillë hap derën për ndërhyrje të panevojshme politike, minon rolin e organit mbikëqyrës, mund të çojë në autocensurë në lidhje me përmbajtjen redaksionale dhe të shkarkojë destabilitet në nivel të menaxhmentit”*. I njëjti, për më tepër thekson që *“Raportet vjetore janë shpesh baza për një debat më të gjerë politik mbi rolin, përgjegjësinë dhe financimin e shërbimit publik të medias, për shembull, në parlament. Megjithatë, nuk duhet të ketë nevojë për miratimin e raportit vjetor nga parlamenti; në mënyrë të ngjashme, çdo refuzim i raportit nuk duhet të çojë automatikisht në shkarkimin e menaxhmentit”*. (shih, Raporti i [Unionit European të Transmetuesve](#) *“Fokusi juridik: Parimet e qeverisjes së shërbimit publik të medias”*, publikuar në dhjetor 2021, fq. 25).
167. Së treti, Gjykata vëren që, bazuar në përgjigjet e pranuar nga Forumi i Komisionit të Venecias, rezulton që në ato raste kur refuzimi i Raportit Vjetor mund të përbëjë bazë për shkarkimin e anëtarëve të bordeve/strukturave mbikëqyrëse të transmetuesve publikë, ligjet përkatëse përcaktojnë një mundësi të tillë specifike. Ky është rasti i Çekisë, ku ligji përkatës përcakton që nëse Dhoma e Deputetëve nuk e miraton raportin vjetor mbi aktivitetet e Televizionit Çek ose Radios Çeke ose raportin vjetor mbi menaxhimin e Televizionit Çek ose Radios Çeke dy herë në një vit rresht në mënyrën e përcaktuar në ligjin përkatës, kjo mund të rezultojë në shkarkimin e tërësishëm të bordeve përkatëse.
168. Gjykata rithekson që në rrethanat e rastit konkret është shkarkuar kolektivisht i tërë Bordi i RTK-së, si rezultat i refuzimit të miratimit të Raportit Vjetor të RTK-së, dhe refuzimi i këtij raporti, ka rezultuar në konstatimin e Komisioneve përkatëse të Kuvendit, që Bordi i RTK-së në tërësinë e tij është *“i paqftë profesionalisht”*, si bazë e përcaktuar në nenin 28 të Ligjit për RTK-në për shkarkimin e anëtarit të Bordit të RTK-së, *“nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t’i përmbushë detyrat e anëtarit të Bordit”*.
169. Thënë këtë, Gjykata vë theks në faktin që të gjitha parimet që burojnë nga instrumentet dhe raportet relevante të shtjelluara në këtë Aktgjykim, bazuar në të cilat, marrë parasysh rëndësinë e pavarësisë së transmetuesve publikë, shkarkimi i anëtarëve të bordeve/strukturave mbikëqyrëse të tyre, duhet të jetë i bazuar në bazë të qartë ligjore. Gjykata vëren që në kontekst të Ligjit për RTK-në, nuk ka bazë ligjore të saktësuar (i) as për shkarkimin kolektiv të Bordit të RTK-së; dhe (ii) as për shkarkimin e një ose më shumë anëtarëve të Bordit të RTK-së si rezultat i refuzimit të Raportit Vjetor,

kompetenca për miratimin dhe/ose refuzimin e të cilit nga ana e Kuvendit, gjithashtu nuk është e përcaktuar në Ligjin për RTK-në.

170. Gjykata gjithashtu vë theks në faktin që (i) bazuar në Ligjin për RTK-në, anëtarët e Bordit emërohen dhe veprojnë në kapacitetin e tyre personal; dhe rrjedhimisht (ii) argumentimi që një anëtar Bordi “*në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t’i përmbushë detyrat e anëtarit të Bordit*”, dhe për pasojë kualifikohet si “*i paqftë profesionalisht*”, duhet të jetë e argumentuar në kapacitetin personal/individual të secilit anëtar të Bordit. Për më tepër, shkarkimi i tërë Bordit si rezultat i shqyrtimit të Raportit Vjetor, jo vetëm që nuk është i përcaktuar në ligj, por është, ndër tjerash, edhe në kundërshtim me standardet e përcaktuara/rekomanduara nga EBU në raportin e lartcekur të tij.
171. Gjykata edhe një herë vë theks në faktin që kompetenca e Kuvendit për të ushtruar mbikëqyrjen ndaj Qeverisë dhe institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve i raportojnë Kuvendit, është kompetencë thelbësore e Kuvendit të Republikës. Gjykata gjithashtu thekson që kjo kompetencë ushtrohet bazuar në kufizimet e përcaktuara në Kushtetutë dhe/ose ligjet të cilat i miraton po Kuvendi. Ky i fundit, përmes miratimit të ligjeve, duke përfshirë në fushën e transmetuesve publikë, siç është rasti i Ligjit për RTK-në, vet ka përcaktuar kufijtë e ushtrimit të kompetencës së tij mbikëqyrëse, përfshirë edhe rrethanat në të cilat mund të shkarkohen anëtarët e Bordit të RTK-së, si organi më i lartë i një institucioni, të cilin vet Kuvendi e përcakton si “*institucion i pavarur publik me rëndësi të posaçme*”, “*autonominë institucionale*” të të cilit, e merr përsipër të mbrojë. Në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes, Kuvendi nuk mund të tejkalojë kufijtë të cilët vet i ka përcaktuar përmes miratimit të ligjit përkatës.
172. Gjithashtu, përmes ushtrimit të funksionit të mbikëqyrjes, Kuvendi nuk mund të shkarkojë në tërësi Bordin e transmetuesit publik, në kundërshtim me qëllimin e nenit 25 të Ligjit për RTK-në, sipas të cilit mandatet e anëtarëve të Bordit të RTK-së, duhet të jenë mandate me kohëzgjatje të ndryshme fillimisht, në mënyrë që jo të gjithë anëtarët të jenë të zgjedhur në të njëjtën kohë dhe nga e njëjta shumicë parlamentare në Kuvend, pikërisht për të siguruar vazhdimësinë dhe pavarësinë e funksionimit të Bordit të RTK-së. Për më tepër, Kuvendi, nuk mund të shkarkojë njëkohësisht të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së, pa bazë të saktë ligjore. Ekzistenca e kësaj të fundit, sipas të gjitha raporteve dhe instrumenteve ndërkombëtare të shtjelluara në këtë Aktgjykim, është thelbësore për të garantuar pavarësinë e bordeve/strukturave mbikëqyrëse të transmetuesve publikë. Siç është sqaruar tashmë, Bordi i RTK-së është shkarkuar në tërësi me arsyetimin e “*paqftësisë profesionale*”, si rezultat i refuzimit të raportit vjetor, dhe i cili bazuar në vet Ligjin e miratuar nga Kuvendi, (i) i dorëzohet të njëjtit “*për qëllime orientuese*”; (ii) nuk përcakton kompetencën e Kuvendit për refuzimin dhe/ose miratimin e tij; dhe (iii) nuk përbën bazë për shkarkimin e një ose më shumë anëtarëve të Bordit të RTK-së.
173. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë që në shkarkimin kolektiv të Bordit të transmetuesit publik, përkatësisht të RTK-së, si rezultat i refuzimit të miratimit të Raportit Vjetor, Kuvendi ka tejkaluar kompetencat e përcaktuara në ligjin që vet e ka miratuar, përkatësisht Ligjin për RTK-në dhe për pasojë, ka tejkaluar kufijtë e ushtrimit të funksionit të mbikëqyrjes të përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës. Gjykata rikujton që në rastet kur Kuvendi ka ushtruar këtë funksion në kuadër të autorizimeve të përcaktuara në ligjin përkatës, siç është në rastin me Ligjin nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, anëtarët e Bordit të të cilit gjithashtu i kishte shkarkuar Kuvendi, Gjykata, nuk ka konstatuar shkelje të nenit të lartcekur të Kushtetutës, duke vënë theks në kompetencën e plotë të Kuvendit për të ushtruar kompetencën mbikëqyrëse në kuadër të autorizimeve kushtetuese dhe/ose ligjore (shih, [KO139/21](#)

me parashtrues *Fadil Nura dhe 9 deputetë tjerë*, Aktgjykimi i 5 prillit 2023, në të cilin kontestohet po ashtu Akti i Kuvendit nr. 08-V-036 i 21 korrikut 2021).

174. Gjykata po ashtu dëshiron të rikujtojë disa parime të përmendura nga GjEDNj-ja, në rastin *Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë*, të cilat ndërlidhen me garantimin e pavarësisë së transmetuesve të shërbimeve publike, përkatësisht transmetuesve publikë, nga ndërhyrjet e mundshme politike. Në paragrafin 102 të Aktgjykimit, theksohet: “Gjykata vëren se: “Rezoluta nr. 1 mbi të Ardhmen e Shërbimit Publik të Transmetimit Radio Televiziv” (1994), Shtetet pjesëmarrëse morën përsipër detyrimin “për të garantuar pavarësinë e transmetuesve publikë ndaj ndërhyrjeve politike dhe ekonomike”. Për më tepër, Gjykata rikujton se edhe GjEDNj-ja, në adresimin e çështjes para saj i është referuar pikërisht Rekomandimit nr. R (96) 10, që flet specifikisht për garantimin e pavarësisë së transmetuesve të shërbimit publik (1996), ku Komiteti i Ministrave miratoi një numër udhëzimesh të hollësishme që synonin të siguronin pavarësinë e transmetuesit publik. Këto përfshinin rekomandimin se “kuadri ligjor që rregullon aktivitetin e kompanive që ofrojnë shërbimin publik të transmetimit duhet të përcaktojë qartësisht pavarësinë e tyre redaksionale dhe autonominë institucionale (...)”. Udhëzimet theksonin gjithashtu se, “dispozitat që rregullojnë statusin dhe emërimin e anëtarëve të bordeve të menaxhimit dhe të organeve mbikëqyrëse të transmetuesve të shërbimit publik duhet të përcaktohen në një mënyrë që të shmangin rrezikun e ndërhyrjeve politike apo të llojeve të tjera”.
175. Në vazhdim, rekomandimi thekson se: “Për të garantuar pavarësinë e bordeve drejtuese të organizatave të shërbimit publik të transmetimit, është thelbësore që bordet të mos i nënshtrohen asnjë forme të ndërhyrjes politike ose tjetër në ushtrimin e funksioneve të tyre. (...) Është po aq thelbësore që këta përfaqësues të ushtrojnë funksionet e tyre në pavarësi të plotë, kundrejt pushteteve politike. Mund të përcaktohen, sipas rastit, dispozita më të rrepta - për shembull, që statusi i një anëtari të bordit drejtues të një organizate të shërbimit publik të transmetimit është i papajtueshëm me ushtrimin e një mandati politik në nivelin kombëtar dhe/ose evropian, rajonal ose lokal” (shih, *Rekomandimit nr. R (96) 10*, cituar më lart, paragrafin 24).
176. Tutje, Gjykata rikujton Opinioni nr. 309/2004- *CDL-AD(2005)017*, të Komisionit të Venecias mbi përputhshmërinë e ligjeve “Gasparri” dhe “Frattini” të Italisë me standardet e Këshillit të Evropës, në fushën e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit të medias, miratuar në seancën e tij të 63-të plenare më 10-11 qershor 2005. Në këtë opinion theksohet mes tjerash se, “transmetuesi i shërbimeve publike, pritet t’i shërbejë interesit publik, të kujdeset për të gjithë popullsinë në baza universale dhe jofitimprurëse ... Shërbimi publik i transmetimit duhet të jetë i lirë nga forcat shtrënguese të shtetit dhe, nga ana tjetër, të gëzojë autonomi dhe pavarësi nga tregu. Detyra e tij specifike është në thelb të veprojë në mënyrë të pavarur nga ata që mbajnë pushtetin ekonomik dhe politik” (shih, Opinioni nr. 309/2004 - *CDL-AD(2005)017*, cituar më lart, paragrafët 53 dhe 54).
177. Gjykata përmes këtij Aktgjykimi vë theks në rëndësinë e pavarësisë së transmetuesit publik, por edhe detyrimet pozitive të shtetit, përkatësisht Republikës së Kosovës, për të mbrojtur dhe garantuar lirinë dhe pluralizmin e mediave dhe të gjitha garancitë që burojnë nga të drejtat kushtetuese të përcaktuara në kontekst të lirisë së shprehjes dhe të mediave, përfshirë siç është interpretuar nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përcaktuar nga instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.
178. Megjithatë, Gjykata gjithashtu thekson që parimi i pavarësisë dhe autonomisë së transmetuesve publikë dhe rrjedhimisht, detyrimi i autoritetit mbikëqyrës për të

respektuar të njëjtin, është në baraspeshë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies të transmetuesit publik dhe rrjedhimisht, detyrimin përkatës ndaj autoritetit mbikëqyrës, përkatësisht Kuvendit dhe publikut. Anëtarët e bordit të transmetuesit publik, përkatësisht anëtarët e Bordit të RTK-së, i nënshtrohen detyrimeve të Ligjit për RTK-në dhe të gjitha ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe parimeve të llogaridhënies dhe transparencës së plotë ndaj autoritetit mbikëqyrës, në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe instrumente të aplikueshme ndërkombëtare.

179. Gjykata gjithashtu thekson që konstatimi i lartcekur i Gjykatës që Akti i kontestuar i Kuvendit është nxjerrë në tejkalim të autorizimeve të Kuvendit të përcaktuara përmes paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës, në asnjë mënyrë nuk nënkupton që institucionet që i nënshtrohet mbikëqyrjes së Kuvendit, përfshirë transmetuesin publik, nuk i nënshtrohen parimeve të balancimit dhe të kontrollit dhe përgjegjësisë së plotë për të ushtruar funksionet e tyre në përputhje me detyrimet që burojnë nga ligji i aplikueshëm. Parimet e llogaridhënies dhe transparencës janë në baraspeshë me parimin e pavarësisë dhe autonomisë së transmetueseve publikë edhe bazuar në të gjitha parimet që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare të shtjelluara në këtë Aktgjykim. Ndër tjerash, sipas [Rekomandimi CM/Rec \(2012\) 1](#), *“pavarësia që u njihet mediave publike, duhet të jetë në shërbim të mbrojtjes së tyre nga ndikimet e papërshtatshme nga shteti ose palët tjera dhe të baraspeshohet nga obligimi i këtyre mediave për të qenë plotësisht llogaridhëse ndaj shtetit dhe hisedarëve tjerë”*.
180. Në këtë kontekst dhe përkitazi me RTK-në, Gjykata thekson që për aq sa Kuvendi është i kufizuar në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse të tij bazuar në autorizimet e ligjit të aplikueshëm, po aq janë të detyruar anëtarët e Bordit të transmetuesit publik që të ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje të plotë me ligjin e aplikueshëm. Gjykata vë theks në faktin që transmetuesi publik, posaçërisht marrë parasysh pavarësinë e tij, dhe funksionin e rëndësishëm në fushën e informimit publik, i nënshtrohet me saktësi detyrimeve të ligjit dhe atyre që burojnë nga parimet ndërkombëtare, përfshirë detyrimin për transparencë dhe llogaridhënie të plotë. Mospërmbushja e detyrimeve të anëtarëve të Bordit të RTK-së, siç janë përcaktuar në Ligjin për RTK-në, medoemos mund të rezultojë në pasoje individuale të shkarkimit, gjithnjë sipas procedurës dhe bazave të sakta ligjore të përcaktuara në Ligjin për RTK-në si dhe parimeve që burojnë nga instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare.

III. Përkitazi me pretendimet tjera

181. Gjykata rikujton se përveç pretendimeve për jokushtetutshmërinë e Aktit të kontestuar dhe mospërputhshmërisë së tij me nenin 4, paragrafin 1 të nenit 7 dhe paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës kanë ngritur dhe pretendime tjera nga kapitulli II i Kushtetutës. Megjithatë, pasi tashmë Gjykata sa më sipër, ka konstatuar se Akti i kontestuar i Kuvendit nuk është në përputhshmëri me kërkesat e paragrafit 9 të nenit 65 dhe paragrafit 1 të nenit 7 të Kushtetutës dhe të Ligjit për RTK-në, dhe rrjedhimisht shpalljes së Aktit të kontestuar të pavlefshëm nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi, nuk e konsideron të nevojshme të adresojë dhe shqyrtojë veçmas pretendimet e tjera të ngritura në kërkesë.

IV. Përkitazi me kërkesën për masë të përkohshme

182. Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e zbatimit të Aktit të kontestuar, deri në vendosjen përfundimtare të kërkesës. Megjithatë, Gjykata vlerëson se çështjet e ngritura në kërkesë, tashmë kanë marrë epilog me faktin e vendosjes për meritat e kërkesës. Thënë

këtë, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme t'i trajtojë veçmas pretendimet e parashtruesve të kërkesës për caktimin e masës së përkohshme.

183. Rrjedhimisht, kërkesa për caktimin e masës së përkohshme refuzohet, në pajtueshmëri me nenin 44 dhe 45 të Rregullores së punës.

V. Përkitazi me efektin e Aktgjykimit

184. Gjykata rikujton që në praktikën e saj gjyqësore, çështjet e efektit të Aktgjykimit, janë shtruar në disa raste të ndryshme, përfshirë edhe në raste të çështjeve zgjedhore (shih në këtë aspekt, rastin e Gjykatës [KI207/19](#), me parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim i 5 janarit 2021, paragrafi 240; shih gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KI193/18](#), me parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020, paragrafët 149-151 ku, në mes referencave të tjera, citohet edhe rasti i GJEDNJ-së, *Kingsley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 28 majit 2002, paragrafi 40; [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deqani*, Aktgjykim i 8 tetorit 2019, paragrafët 116-120; [KI108/18](#), parashtrues *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 tetorit 2019, paragrafi 196).
185. Për sa i takon efektin të këtij Aktgjykimi, Gjykata sqaron se i njëjti prodhon të paktën dy efekte të rëndësishme. Së pari, përmes këtij Aktgjykimi, Gjykata vë theks në rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe lirisë e pluralizmit të mediave dhe rolin thelbësorë të tyre në një shoqëri demokratike, duke sqaruar që të njëjtat, përfshirë sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, shtrijnë mbrojtjen e tyre edhe në kontekst të pavarësisë dhe autonomisë së transmetuesve publikë, garanci këto të cilat shteti ka detyrim pozitiv t' i mbrojë dhe respektojë. Aktgjykimi gjithashtu vë theks në faktin që kompetenca mbikëqyrëse e Kuvendit e përcaktuar përmes paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës, është ndër kompetencat më thelbësore të Kuvendit. Thënë këtë, e njëjta i nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara me Kushtetutë dhe vet ligjet të cilat i miraton Kuvendi.
186. Së dyti, Aktgjykimi sqaron që shpallja e pavlefshme e Vendimit [nr. 08-V-036] të 8 korrikut 2021 të Kuvendit, për arsye objektive dhe në interes të sigurisë juridike, nuk mund të prodhojë efekt juridik prapaveprues në lidhje me mandatet e anëtarëve të rinj të Bordit të RTK-së. Në këtë aspekt, Gjykata sqaron që në bazë të parimit të sigurisë juridike, ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe nuk prek të drejtat e palëve të treta të fituara, para shpalljes në kundërshtim me Kushtetutën të aktit të kontestuar të Kuvendit me këtë Aktgjykim. Gjykata përsëritë edhe kësaj here faktin se ndonëse ajo nuk ka autorizime ligjore për të caktuar ndonjë kompensim të dëmit për rastet kur konstaton shkelje të dispozitave respektive kushtetuese, një aspekt i tillë nuk nënkupton që palët e afektuara nuk kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre bazuar në Kushtetutë dhe ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës (shih, ngjashëm rastet e bashkuar të Gjykatës, [KI45/20 dhe KI46/20](#), me parashtrues *Tinka Kurti dhe Drita Millaku*, Aktgjykimi i 26 marsit 2021, paragrafët 148-153).


PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenet 113.5 dhe 116 të Kushtetutës, me nenet 20, 27, 42 dhe 43 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 44, 45, 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 1 gusht 2023:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË njëzëri kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me pesë (5) vota “për” dhe dy (2) “kundër” që Vendimi [nr. 08-V-036] i 8 korrikut 2021 i Kuvendit nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] dhe paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës;
- III. TË REFUZOJË njëzëri kërkesën e parashtruesve të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme;
- IV. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe nuk afekton të drejtat e fituara të palëve të treta;
- V. T’UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VI. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 20. 5 të Ligjit.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani